# PLANI LOKAL
# I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE
# ( 2024-2029)

KRYETAR

Benet Beci

*Përgatitur nga: Bashkia Shkodër*

*Ing.Ina Xhakoni, Ing. Ormira Domnori, Ing. Erkam Borici*

Dhjetor 2023-Mars 2024

Falenderimi shkon për stafin e Bashkisë Shkodër,për ndihmën e dhënë për hartimin e Planit, Drejtorinë e Financës, Drejtorinë e Buxhetit,Drejtorinë e të Ardhurave dhe ekspertin e GIS në Dr.e Bujqësisë Z. Adi Garuci. Një falenderim i vecantë shkon për stafin e Projektit Bashki të Forta Z.Arben Kopliku, Z.Elvin Hoxha, stafin e asistencës teknike të EcoDES Studio Z. Konalsi Gjoka dhe Znj. Teida Shehi që kontribuan në hartimin e planit lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve për Bashkinë Shkodër.

## SHKURTIME

| | |
|---|---|
| AKBN | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore |
| AKM | Agjensia Kombëtare e Mjedisit |
| ARM | Agjensia Rajonale e Mjedisit |
| AT | Asistencë Teknike |
| BE | Bashkimi Evropian |
| IK | Investime Kapitale |
| INSTAT | Instituti i Statistikave |
| IPA | Instrumenti i Paraaderimit |
| ISHMP | Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve |
| KE | Këshilli i Evropës |
| MF | Ministria e Financave |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MIE | Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MIM | Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve |
| MM | Ministria e Mjedisit |
| MNB | Mbetje të Ngurta Bashkiake |
| MNP | Mbetjet nga Ndërtimi dhe Prishjet |
| MPEE | Mbetjet nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike |
| MTM | Ministria Turizimit dhe Mjedisit |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asocijimit |
| NJQV | Njësitë e Qeverisjes Vendore |
| O & M | Operimi dhe Mirëmbajtje |
| PCB | Difileni poliklorur |
| PE | Parlamenti Evropian |
| PEE | Pajisjet Elektrike dhe Elektronike |
| PK | Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve |
| PKIE | Plani Kombëtar për Integrimin Evropian |
| PV | Pushteti Vendor |
| RIOT | Rrjeti i Integruar i Objekteve të Trajtimit |
| QQ | Qeveria Qendrore |
| QSH | Qeveria Shqiptare |
| QV | Qeverisja Vendore |
| SMMAI | Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

## PËRMBAJTJA


SHKURTIME ........ 2

PËRMBAJTJA ........ 3

1. HYRJE ........ 7

1.1 RISHIKIMI I PLMIMNU NË BASHKINË SHKODËR ........ 7

2. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR, ASPEKTET LIGJOR DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE. ........ 9

2.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE ........ 9
2.2 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE SIPAS STRATEGJISË 2020-2035 ........ 9
2.3 HIERARKIA E MBETJEVE DHE PARIMET E TJERA TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE ........ 10
2.4 PARIMET BAZË TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE ........ 10
2.5 KUADRI INSTITUCIONAL LIGJOR DHE FINANCIAR ........ 12
*2.5.1 Organizimi në nivel Qëndror* ........ 12
*2.5.2 Organizimi në nivel lokal* ........ 13
*2.5.3 Kuadri Ligjor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve* ........ 15
2.6 INSTRUMENTAT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË NIVEL VENDOR ........ 17
2.7 PLANI LOKAL I MIMNU PËR BASHKINË SHKODËR ........ 19
2.8 KUADRI LIGJOR PËR STANDARDIN MINIMAL PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE ........ 21
2.9 RRYMA E MBETJEVE, OBJEKTI I PLANIT ........ 22

3. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME ........ 24

3.1 TË DHËNAT GJEOGRAFIKE DHE DEMOGRAFIKE ........ 24
3.2 TË DHËNA EKONOMIKE ........ 27
3.3 ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË SHKODËR ........ 28
3.4 ASPEKTE TEKNIKE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKINË SHKODËR ........ 30
*3.4.1 Përbërja mercologjike e mbetjeve* ........ 30
*3.4.2. Efekti i turizmit në menaxhimin e mbetjeve* ........ 31

4. SHËRBIME TË PASTRIMIT ME MJETE DHE PUNËTORI ........ ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

4.1 SHËRBIMI I PASTRIMIT TË RRUGËVE ME KRAHË ........ ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.2 SHËRBIMI I PASTRIMIT TË RRUGËVE ME MAKINERI TEKNOLOGJIKE ........ 79
4.3 MJETET DHE PAJISJET NË SHËRBIMIN E GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE ........ 82
4.4 RREGULLA TË TJERA PËR MJETET DHE PAJISJET: ........ 84
4.5 PROCESE TË TJERA PUNË NË FUNKSION TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT ........ 86
*4.5.1 Dezifektimi i PGM* ........ 86
*4.5.2 Menaxhim dhe mirembajtje kontanierësh* ........ 86

5. INDIKATORËT E PERFORMANCËS ........ 32

5.1 GJENERIMI I MBETJEVE ........ 35
5.2 TRAJTIMI I MBETJEVE ........ 35

6. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE ........ 36

6.1 ANALIZA FINANCIARE E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE ........ 36
6.2 KOSTO E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE SIPAS ZONAVE FUNKSIONALE ........ 39

7. ZONAT FUNKSIONALE TË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE (ZFAM) ........ 40

.....40
7.1 Skemat e ofrimit të shërbimit të pastrimit në Bashkinë Shkodër .....40
7.1. I. ZONA FUNKSIONALE PERËNDIMORE .....56
7.1. II. ZONA FUNKSIONALE LINDORE .....Error! Bookmark not defined.
9 Fshirja e manuale e rrugëve në zonën perëndimore
10. SKENARËT E PROPOZUARA PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE DHE SHËRBIMIN E PASTRIMIT NË ZONËN QENDRORE/BASHKIA SHKODËR .....Error! Bookmark not defined.
.....Error! Bookmark not defined.
10.3 Mjetet dhe pajisjet .....Error! Bookmark not defined.
10.4 Pajisje të tjera në shërbim të pastrimit dhe menaxhimit ët mbetjeve .....81
Larje e pedonaleve me solucion dhe me presion .....Error! Bookmark not defined.
Specifikime .....Error! Bookmark not defined.
10.6 Personeli .....70
10.7 Skenaret e levizjes se mjeteve per grumbullimin e mbetjeve urbane .....ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
10.8 SHËRBIME TË TJERA .....Error! Bookmark not defined.
10.8.1 Pastrimi dhe mirmbajtja e rrugëve kryesore dhe PGM've gjatë ditës .....Error! Bookmark not defined.
Volumi i punimeve .....90
11. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT .....90
11.1. OFRIMI I SHËRBIMIT NË ZONAT TURISTIKE 12 MUAJ .....90
11.1.1. Zona Velipojë Plazh .....91
11.1.2. Zona Theth- Ndërlysaj .....91
11.2. SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT DERË MË DERË, ZONA E SHIROKËS .....91
11.1.1 HAPAT QË DUHET TË NDIQEN PËR SHËRBIMIN DERË MË DERË. .....92
11.1.2 TË DHËNA PËR SHIROKËN .....93
11.1.3. KËRKESAT PËR SHËRBIMIN E RI DERË MË DERË .....96
11.1.4. Llogaritja e Kostos .....99
12. TRAJTIMI I MBETJEVE .....100
13. MINIMIZIMI I MBETJEVE .....103
14. NDARJA E MBETJEVE NË BURIM .....105
14.1. Riciklimi dhe kompostimi .....107
15. KOMPOSTIMI I MBETJEVE .....108
15. RICIKLIMI I MBETJEVE .....108
15.1 Metodologjia dhe opsionet e ndarjes në burim .....110
15.1.1. OPSIONI 1. MBETJET E GJENERUARA NGA TURISTËT NË HOTELE DHE RESTORANTE .....111
15.1.2. OPSIONI 2. MBETJET E GJENERUARA NGA RESTORANTET DHE TREGJET .....112
15.1.3. OPSIONI 3. MBETJET E GJENERUARA NGA TË GJITHA BURIMET .....114
16. SKEMAT E PROPOZUARA PËR PILOTIMIN E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME .....115
16.1. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË NJA VELIPOJË .....117
16.2. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË ZONËN QËNDRORE – PEDONALE .....118
16.3. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË ZONËN E SHIROKËS

16.4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME ........ 118

**17. QENDRA E GRUMBULLIMIT TË MATERIALEVE TË RICIKLUESHME ........ 123**

17.1 KOSTO INVESTIMI ........ 123

*17.1.1. KOSTO SHTESË E INVESTIMIT ........ 124*

17.2. KOSTO OPERIMI ........ 124

17.3. PËRMBLEDHJA E KOSTOVE ........ 125

**18. POLITIKAT E MBULIMIT TË KOSTOS NGA TË ARDHURAT DHE TARIFAT E PASTRIMIT ........ 126**

18.1. FINANCIMI ........ 128

**19. MENAXHIMI I MBETJEVE VOLUMINOZE DHE NDËRTIMORE ........ 128**

**20. MENAXHIMI I MBETJEVE TË TJERA ........ 129**

**21. EDUKIMI PUBLIK MJEDISOR. ........ 131**

21.1 ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I FUSHATËS NDËRGJEGJËSUESE NË NJA VELIPOJË ........ 132

21.2. FUSHATA E NDËRGJEGJËSIMIT ........ 133

ANEKSI II - PYETËSORI ........ 134

ANEKSI III - PËRMBAJTJA E FLETPALOSJES ........ 135

21.3. MODELI PËR HARTIMIN E FUSHATËS SË INFORMIMIT PËR ZBATIMIN E SKEMAVE TË MINIMIZIMIT TË MBETJEVE DHE NDARJEN NË BURIM ........ 136

**22. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE ........ 138**

22.1. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT ........ 138

*22.1.1. VIZIONI ........ 139*

*22.1.2. OBJEKTIVAT ........ 139*

**23. PLANI I VEPRIMIT ........ 143**

23.1.KOMPONENTI: QËNDRUESHMËRIA INSTITUCIONALE 4 ........ 143

23.2 KOMPONENTI : CILËSIA E SHËRBIMIT ........ 147

23.3. KOMPONENTI QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE ........ 151

23.4. KOMPONENTI: QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE ........ 154

**24. RISHIKIMI I PLANIT ........ 158**

24.1. MONITORIMI ........ 158

FIGURE

Figure 1Figure .1 Hierarkia e mbetjeve ........

Figure 2 Pozicioni gjeografik Bashkia Shkodër

TABELA

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve

# 1. HYRJE

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2024-2029 është një dokument planifikimi strategjik, i cili vjen për Bashkinë Shkodër mbas përfundimit të afatit të Planit paraardhës 2017-2022. Plani i përfunduar ka kaluar procesin e rishikimit dhe monitorimit të realizimit ë objektivave të planeve të veprimit të planit pararadhës. Në mënyrë të përmbledhur do të jetë kapitull I këtij plani për tju paraqitur publikut në dëgjesat publike të miratimit të planit të ardhshëm , të gjithë grupeve të interesit komisioneve të Këshillit Bashkiak para miratimit etj.

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2024-2029 , është instrument që mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Shkodër.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Duke u orientuar nga zbatimi i PLMIMNU bashkia ka për qëllim ofrimin e shërimit të menaxhimti të mbetjeve në të gjithë territorin, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia sot ka një system shumë të mirë të konsliduar të monitorimitdhe raportimit të shërbimit të pastrimit duke ngritur kapacitetet brënda Bashkisë me miratimin e Procedurës standarte të veprimit. Plani ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmërinë me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjesimin) final të mbetjeve;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standarded e menaxhimit të mbetjeve;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

## 1.1 RISHIKIMI I PLMIMNU NË BASHKINË SHKODËR

Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisje vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga **Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"**, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin*

*kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*

PLMIMNU u hartua në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër Nr.1379 Datë 10.11.2023. Bashkia Shkodër u asistua që në nisje të planit nga Projekti "Bashki të Forta" komponenti i menaxhimit të mbetjeve, me asistencën teknike të EcoDES Studio. Grupi i punës u trajnua nga projekti në të gjitha elementët e planit, duke studiuar situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër, skenarët e mundshëm për Zonën funksionale qendrore dhe skenarët e mbledhjes derë më derë në në territoret me destinacion turizmin. Ata ishin pjesë e zhvillimit të Planit që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që janë ekonomikisht të mundshme me buxhetin që ka në dispozicion Bashkia, dhe të pranueshme nga ana mjedisore me ndikimet minimale në mjedis dhe në përputhje me politikat dhe legjislacionin mjedisor në fuqi. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e bashkisë,vizionin objektivat opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan gjatë takimeve dhe trajnimeve të grupit të punës.



*Foto nr.1: Takimet me ekspertët e konsulentë organizuar nga Bashki të Forta*

Burimi : Bashki të Forta

Bashkia Shkodër ka një eksperiencë të gjatë në fushën e planifikimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, në sajë të mbështetjes të vazhdueshme teknike dhe asistencës që ka marrë nga program i dldp-së dhe projektit Bashki të Forta. Bashkia Shkodër ka qënë një nga bashkitë e para që me ndihmën e asitencës të ndërkombëtarëve ka hartuar në vitin 2017 PLMIMNU, në vitin 2020 ka miratuar Procedurën standarte të Veprimit për Administrimin e ofrimti të shërbimti të pastrimit, e ka rishikuar atë në vitin 2023 dhe ka miratuar Rregulloren e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane në nëntor të vitit 2023.Bashkia Shkodër u asistua nga nisja e procesit,nga projekti Bashki të Forta me konsulencën e Ecodes, stafi I Bashkisë mori pjesë në ciklin e ëorkshopeve mbi prezantimine gjendjeve ekzistuese të shërbimti hartimin e objektivave dhe skenarëve specifikë.

Në hapa të ndryshëm të hartimit të planit, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të bashkisë. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten bashkisë, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme.

# 2. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR. ASPEKTET LIGJOR DHE INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE.

## 2.1 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE

Dokumenti i Politikave Strategjike është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jo-bashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri dhe mbulon periudhën kohore 2020-2035.

Ky dokument strategjik merr parasysh zhvillimet planifikuese dhe infrastrukturore në sektorin e mbetjeve prej vitit 2011, në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen e madhe të biznesit privat dhe investimet e shumta të kryera në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe veçanërisht të trajtimit të mbetjeve. Dokumenti i Politikave Strategjike e rishikuar e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve zhvillohet mbi vizionin ose perceptimin e konceptit "zero mbetje", që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.Dokumenti i Politikave Strategjike ka si qëllim kryesor të japë drejtimet strategjike dhe të përcaktojë një sërë masash që ndihmojnë vendin për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian duke përmbushur detyrimet që rrjedhin prej Kapitullit 27 për mjedisin.

Objektivat specifike të Dokumentit të Politikave Strategjike synojnë të japin zgjidhje praktike për:

1. adresimin e problematikave në sistemin e deritanishëm të menaxhimit;
2. zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi;
3. përgatitjet e nevojshme për të përmbushur detyrimet nga ndryshimet në Direktivat e BE-së, përfshirë edhe objektivat ambicioze të Paketës së Ekonomisë Qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave, përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke i dhënë impuls shtesë zhvillimit ekonomik

## 2.2 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE SIPAS STRATEGJISË 2020-2035.

Në Shqipëri gjatë viteve të fundit, sasia e gjenerimit të mbetjeve është rritur, ndërsa mënyra e menaxhimit të tyre ka vend për përmirësim.

Zbatimi i Dokumentit të Politikave Strategjike do të kërkojë një riorganizim thelbësor institucional, për të qartësuar strukturat përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si dhe detyrat institucionale, për të arritur objektivat e zvogëlimit, ripërdorimit dhe të riciklimit.

Menaxhimi i mbetjeve kryhet në të gjitha zonat urbane dhe më pak në zonat rurale. Mbetjet hidhen kryesisht në vendepozitime të caktuara nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore por ka sasi që hidhen dhe në vende të paautorizuara, përgjatë rrugëve dhe afër vendbanimeve. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet përmes kontraktimit nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore të ndërmarrjeve private apo dhe përmes kompanive të tyre dhe këto kontrata janë zakonisht me një kohëzgjatje 3-5 vjet. Infrastruktura e mbledhjes është e dobët, pasi shpesh numri i kontenierëve është i pamjaftueshëm. Pajisjet e grumbullimit (kontenierë dhe kamiona) nuk janë sipas standardeve evropiane dhe kanë nevojë për rinovim në mënyrë të vazhdueshme. Industria e riciklimit është një nga aktorët më të rëndësishëm në menaxhimin e mbetjeve. Riciklimi në vetvete është ndoshta elementi më thelbësor dhe forma më e njohur për zvogëlimin e mbetjeve që zhvillohet nëpërmjet një zinxhiri procesesh duke

përfshirë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin, që çon në zvogëlimin e një sasie të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në lendfill. Riciklimi ka progres krahasuar me disa vite më parë, pasi janë ngritur kompani që grumbullojnë metalet, plastikën, letrën dhe qelqin dhe i riciklojnë ato. Edhe për rryma të tjera mbetjesh ka filluar grumbullimi dhe menaxhimi i tyre. Për t'u përmendur janë mbetjet spitalore, të baterive, të vajrave, të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Përpjekjet për ndarjen në burim të mbetjeve, kanë qenë të shpeshta por pa rezultat pozitiv. Kjo për shkak të mungesës së plotë të infrastrukturës por edhe të ndërgjegjësimit publik. Sa i takon përgatitjes së kuadrit ligjor në fushën e mbetjeve vihet re nje përputhshmëri me direktivat dhe rregulloret e BE-së, por sfidë mbetet ende zbatueshmëria e plotë e tij. Gjithashtu, menaxhimi i integruar i mbetjeve kërkon dhe instrumenta financiarë që do të bëjnë të mundur arritjen e objektivave të dokumentit strategjik. Instrumentat financiarë përfshijnë: Planifikimin e buxhetit afatmesëm në nivel qendror. Dhënia e një fondi dedikuar për mjedisin, bazuar në numrin e popullsisë që I jepet çdo vit Njësive të Vetqeverisjes Vendore. Zbatimi i Strategjisë do të kërkojë një impenjim të madh financiar të qeverisjes në nivel kombëtar dhe vendor për ta trajtuar menaxhimin e mbetjeve si një sektor strategjik. Rol të rëndësishëm luan edhe sektori privat që do të jetë mbështëtetës kryesorë lidhur me financimet për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

## 2.3 HIERARKIA E MBETJEVE DHE PARIMET E TJERA TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

**Hierarkia e mbetjeve:** Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në menaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në menaxhimin e mbetjeve duke vendosur "parandalimin dhe ripërdorimin" në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.

Figure nr.1 Hierarkia e mbetjeve




## 2.4 PARIMET BAZË TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Menaxhimit të Mbetjeve 2008/98/EC, që është transpozuar në Ligjin nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar si dhe në ligjin 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", janë:

- Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, siç paraqitet në figurën 1.
- Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.

Dokumenti i Politikave Strategjike parashtron nevojën për kalimin gradual nga ekonomia lineare në atë qarkulluese, duke synuar ndër të tjera zgjatjen e jetës, grumbullimin përmes ndarjes në burim dhe riciklimin në shkallë të gjerë. Kalimi në ekonominë qarkulluese, në të cilën mbetja trajtohet si burim lëndësh përmes rikthimit në ekonomi si lëndë të para, do të sjellë përfitime për mjedisin dhe ekonominë e vendit.

**Parimi "Ndotësi Paguan"**, lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen tek ndotësit dhe konsumatorët përgjegjës për të. Kostot e ndotjes kanë të bëjnë me parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve në mënyrë miqësore ndaj mjedisit;

**Parimi i "Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit"**; janë përgjegjësitë që duhet të ketë një prodhues apo importues gjatë gjithe ciklit të jetës së produkteve të tyre që prej krijimit deri në shkallën e post konsumit. Prodhuesi/importuesi duhet të ketë si qëllim marrjen pas të produkteve që janë në fund të jetës së tyre, riciklimin dhe depozitimin e tyre. Përparësi i duhet dhënë ndarjes së diferencuar të produkteve dhe materialeve që paraqesin një rrezik më të lartë ndaj mjedisit dhe/ose për ato produkte që ka treg përpunimi për qëllime riciklimi ose rikuperimi. Mbetjet që riciklohen

konsiderohen si lëndë

parësore dhe objektet vendore për ndarjen dhe përpunimin e mbetjeve furnizojnë industrinë.

- **Parimi i parandalimit** nënkupton që kur ka të dhëna mbi praninë e rrezikut mjedisor, duhen marrë masa të përshtatshme parandaluese edhe në rastet kur mungojnë prova të qarta të shkaqeve për atë rrezik.
- **Parimi integrues** nënkupton që mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit të politikave.
- **Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelltë dhe bashkëpunimit** nënkupton që të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e kësaj Strategjie.
- **Parimi i vetë-qëndrueshmërisë** nënkupton që vendi të zhvillojë një rrjet pajisjesh dhe impiantesh të integruar dhe të përshtatshëm për menaxhimin e mbetjeve.
- **Parimi i afërsisë** nënkupton që mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve.
- **Parimi i përballueshmërisë** nënkupton që niveli i tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë i përballueshëm dhe i pranuar nga komuniteti.
- **Parimi i së drejtës për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut** nënkupton që çdo qytetar ka të drejtë të marrë informacion rreth menaxhimit të mbetjeve lehtësisht nga të gjitha

institucionet përgjegjëse. E drejta për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje nënkupton që publikut duhet të jetë i informuar për të gjitha projektet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe duhet t'i jepet mundësia të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

- **Parimi i eliminimit të mangësive** që ndeshen në politikat mjedisore shqiptare nënkupton zbatimin e praktikave aktuale evropiane që lidhen me fushën e menaxhimit të mbetjeve. Vënia në zbatim e këtyre praktikave, do të mundësojë që të kontrollohen dhe përmirësohen ligjet, rregulloret dhe të gjitha procedurat në respekt të standardeve evropiane.

## 2.5 KUADRI INSTITUCIONAL LIGJOR DHE FINANCIAR

### 2.5.1 Organizimi në nivel Qëndror

Aktorët kryesorë përgjegjës në vitin aktual 2021, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë:

- Ministria e Turizimit dhe Mjedisit,
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, Ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të institucionit që ajo ka në varësi AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe 4 Agjencitë/Drejtoritë Rajonale të Mjedisit në nivel rajonal). Sipas VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", AKM është institucioni nën varësi të Minsitrisë së Turizmit dhe Mjedisit që ka si objektiv mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Sipas këtij riorganizimi të ri, AKM ka këto katër funksione që duhet t'i ushtrojë:

i) Sigurimin e performancës mjedisore në territorin e vendit;
ii) ii) Kërkimin dhe dijen mjedisore;
iii) iii) Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licensimin;
iv) iv) Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

Ky organizim i ri i AKM së parashikon edhe nivelin rajonal, me 4 ARM-të të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, të cilat zbatojnë funksionet përkatëse në territorin ku ato operojnë dhe më pas raportojnë tek Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e menaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së landfill-eve etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe groposja etj.

Gjithashtu, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për, mbetjet industriale, mbetjet minerale dhe rehabilitimin e venddepozitimeve në përputhje me specifikat. AKUM (Agjensia Kombëtare për Ujësjellës Kanalizimet dhe Infrastrukturën e Mbetjeve) – sipas përcaktimit në VKM nr. 431, datë 11.07.2018 "Për Krijimin dhe organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", AKUM është institucioni i ri në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", i cili është përgjegjës për infrastrukturën e mbetjeve, në kuadër të zbatimit të master planit të mbetjeve.

Këshilli Kombëtar i Territorit, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për menaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së menaxhimit të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007).

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjoba për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshme dhe bëhen të rrezikshme për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve.

Spitalet dhe të gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të menaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural (në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin) është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

Ministria përgjegjëse për financat (në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

### 2.5.2 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;
ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret "tip" të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;
iv. Harton planet e menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

(i) Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
(ii) Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
(iii) Të monitorojnë dhe inspektojë të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualet lokale;
(iv) Të inspektojnë "zotëruesin e mbetjeve" për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
(v) Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve;
(vi) Të bashkëpunojë me ISHMPU, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
(vii) Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

**Këshilli Bashkiak:** është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

**Policia e bashkiake** është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

### 2.5.3 Kuadri Ligjor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptar në fushën e Menaxhimit të mbetjeve:

Tabela Nr.1 Kuadri Ligjor për Menaxhimin e Mbetjeve

| | |
|---|---|
| Ligjet | Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; |
| | Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, |
| | Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013 |
| | Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme" |
| | Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". |
| | Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" |
| | Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 " Për largimin publik të mbeturinave"; |
| | Ligji Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar; |
| | Ligji Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative"; |
| | Ligji Nr.89/2022 "Për policinë Bashkiake" |
| | Ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta" |
| | VKM nr. 428, datë 08.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane" |
| | VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve" |
| | VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" |
| | VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjesimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjesimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjesimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura " |
| | VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura" |
| | VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte " |
| | VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre" |
| | VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve" |
| | VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" |
| | VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" |
| | VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezkshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit" |

VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje"

VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"

VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"

VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"

VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"

VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"

VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"

VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"

VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"

VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"

VKM Nr.452, datë 26.07.2023"Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake";

VKM Nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte";

VKM Nr.660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kerkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve";

VKM Nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", i ndryshuar ;

VKM Nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura";

VKM Nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim";

VKM Nr.117, datë 13.02.21013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", i ndryshuar ;

VKM Nr.957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";

VKM Nr.866, datë 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";

VKM Nr.765, datë 07.11.2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura";

VKM Nr.705, datë 10.10.2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës";

VKM Nr.452, datë 11.07.2012 "Për lendfill-et e mbetjeve", të ndryshuar ;

VKM Nr.177, datë 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", të ndryshuar ;

VKM Nr.178, datë 06.03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve";

VKM Nr.319, datë 31.05.2018 "Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve";

| | |
|---|---|
| | VKM Nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035"; |
| | VKM Nr.447, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"; |
| | VKM Nr.652 datë 14.09.2016 " Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura. |
| Udhëzime | Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabiilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane" |
| | VKB per miratimin e Rregullores të MMNU |
| | Urdhëri Nr994, datë 30.08.2023 " Mbi miratimin dhe zbatimin e PSV për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për Bashkinë Shkodër". |

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve

[Burimi: Punuar nga autori]

## 2.6 INSTRUMENTAT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË NIVEL VENDOR

Bazuar në ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i miratuar në vitin 2011 dhe i amenduar përsëri në vitin 2013, NJQV-të (bashkitë) duhet të hartojnë instrumentat vendorë për planfikimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimit të mbetjeve, si:

- **Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane**, si instrumenti kryesor i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifikë, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisorë, në lidhje me drejtimet që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifikë duhet ët reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifikë të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të kostos. Ai për përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashiak.
- **Rregulloret bashkiake për menaxhimin e mbetjeve** për çdo rrymë specifike: është përgjegjësi e Bashkisë Shkodër të hartojë këto rregullore (duke zbatuar specifikat e ndarjes së re territorale-administrative), e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbetjeve për të gjitha rrymat specifike të mbetjeve, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke hartuar procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve në rast të mos zbatimit të rregullores nga aktorë të ndryshëm. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak për të marrë fuqi të plotë ligjore. Nëse Bashkia shkodër merr përsipër të zbatojë skemën e ndarjes në burim dhe grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme, me qëllim riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve, duhet të përcaktohen ditët dhe oraret e ndryshme të mbledhjes të mbeturinave te riciklueshme.

Për këtë qëllim, Bashksië Shkodër i del një detyrë për të rishikuar Rregulloren e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane, ose të hartojë Rregullore të rë për rrymat e mbetjeve të ricikluara, duke informuar qytetarët ose bizneset që preken nga kjo skemë sipas strategjisë të komunikimit.

- [1] **Rregulloret për llogaritjen e kostos dhe tarifave mbetjet**: në sajë të asistecës teknike nga programi DLDP, Bashkia Shkodër ka qënë pjesë e shumë trajnimeve për aplikimin e modelit të llogaritjes së kostos dhe tarifave të prezantuar nga programi Bashki të Forta. Në këtë kuadër, nisur edhe nga fakti që shumë shpejt këto metodologji do të miratohen edhe në nivel kombëtar, për t'u përdorur zyrtarisht nga të 61 bashkitë vendit, bashkia duhet të hartojë rregulloret përkatëse në lidhje me rregullat dhe procedurat për llogaritjen e kostos vjetore të shërbimit dhe nivelit të tarifave për konsumatorë të ndryshëm që janë pjesë e skemës, sipas modeleve të paraqitura nga DLDP. Këto rregullore do të qartësojmë punën e stafit të financës dhe tarifave, të cilët në bashkëpunim me stafin teknik të menaxhimit të shërbimit, duhet të llogarisin koston vjetore dhe të përcaktojnë politikën fiskale, e cila i përshtatet më mirë nevojave të bashkisë bazuar në konceptin e përballueshmërisë nga konsumatori, por edhe në drejtim të mbulimit të plotë të kostos nga tarifat e pastrimit. Këto rregullore duhet të miratohen në Këshill Bashkiak.
- **Modeli i Sistemit të Monitorimit**: Ky është një instrument të cilin bashkia e ka ngritur dhe e zbaton për qytetin e Shkodrës, ku çdo ditë kryetarët e rajoneve, inspektorët e terrenit, përgjegjësit e shërbimitt dhe përfaqësuesit e firmës private, raportojnë në lidhje me gjendjen e PGM (a janë evaduar rregullisht apo jo, a është realizuar dezinfektimi, larjet, riparimet, etj.) sipas formateve tashmë të hartuara dhe konsoliduar për NJA Shkodër. Bashkia Shkodër të njëjtin model monitorimi e zbaton edhe në njësitë e tjera administrative, duke angazhuar monitoruesit e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Monitorimit, të cilët janë pjesë e procesit dhe kryejnë raportimet ditore, javore dhe mujore tek Ndërmarrja e Shërbimeve e Punëve Publike. Bashkia ka të miratuar Procedurën Standarte të Veprimit për cdo element të procesit të ndjekjes së kontratave. Bashkia Shkodër në këtë faze duhet të punojë për të dixhitalizuar sistemin e monitorimit, duke ngritur një sistem online monitorimi, i cili plotësohet me të dhëna në kohë reale nga personat e ngarkuar për monitorim, dhe i jep të dhëna në kohë reale personave përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Monitorimit për situatën e pastrimit në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Në këtë mënyrë, Bashkia do ketë në kontroll situatën e territorit në cdo moment, do të kuptojë më mirë nivelin e ofrimit të shërbimit, elementet ku ajo duhet të ndërhyjë për të përmirësuar situatën, apo edhe të rishikojë objektivat specifikë për zona, apo kategori të ndryshme të konsumatorëve.
- **Strategjia e informimit:** një instrument tjetër mjaft i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane. Bashkia duhet të sigurojë angazhimin e plotë të komunitetit duke i informuar ata në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që po zbaton në territorin e bashkisë dhe me politikën fiskale që ajo po aplikon. Bashkia duhet të hartojë një strategji informimi, që në hapat e parë të hartimit të planit, duke informuar komunitetin në lidhje me iniciativën që ajo ka ndërmarrë, objektivat e përcaktuar, skenarët që kërkon të aplikojë dhe politikën fiskale që Bashkia kërkon të ndjekë. Kjo strategji duhet të përcaktojë edhe etapa të tjera që duhet të përsëritën vit pas viti, ku synimi kryesor duhet
- të jetë informimi i komunitetit në lidhje me proceset që zhvillon bashkia dhe marrja e opinionit të tyre në lidhje me performancën e shërbimit dhe sugjerimeve që ata mund të kenë. Zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, apo i dëgjesave publike në periudha të ndryshme gjatë

zbatimit të planit, janë disa nga elementet që strategjia e informimit duhet të parashikojë, për të matur opinionin qytetar, i cili duhet të reflektohet si në përmirësimin e shërbimit ashtu edhe të strategjisë së informimit.

## 2.7 PLANI LOKAL I MIMNU PËR BASHKINË SHKODËR

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Shkodër.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal.

Qëllimi i PLMIMNU konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të brenda bashkisë për zbatimin e planit

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave dhe Strategjine Kombetare të Menaxhimit të Integruar të Mbetejve) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me skemën rajonale dhe teknologjitë më të mira të munddëëshme duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjesimin) final të mbetjeve;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standarded e menaxhimit të mbetjeve;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Për të arritur dhe ndjekur standartet ligjore për menaxhimin dhe reduktimin e mbetjeve urbane, për optimizimin e tarifes për mbulimin e kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në përputhje me pritshmëritë e qytetarëveështë e nevojshme analiza e gjendjes fillestare të shërbimit që ne ofrojmë si bazë për përcaktimin të hapave tëmëtejshën në konkretizimin e këytre qëllimeve.

Bazuar në reformën e re administrative dhe territoriale, të miratuar në Korrik 2015, Bashkia e madhe Shkodër përbëhët nga 11 NJA (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë), ku kryeqendra e bashkisë është qyteti i Shkodrës. Shërbimi i pastrimit të mbetjeve ofrohet në të gjitha njesitë me përjashtim të njesive të thella malore Shale (me përjashtim te fshatit Theth gjate sezonit turistik), Shosh dhe Pult.

Bashkia Shkodër me vendimin nr.38 prot. date 26.12.2017 ka miratuar "Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane"per vitet 2017-2022. Ky plan ka shërbyer si bazë për hartimin e dokumentacionit për lidhjen me Kontratat e reja me afat 5- vjeçar.

Plani i rishikuar ka për subjekt menaxhinin e Mbetjeve të Ngurta Bashkia (MNB) përfshirë ato shtëpiake dhe të ngashme që gjenerohen nga subjekte të tjera të cilat mbliidhen nga bashkia dhe/ose në emer të bashkisë, përfshirë edhe ato mbetje të cilat mund të mblidhen nga subjekte private për qëllimine rikuperimit1. (Shtojca 2).Plani i Menaxhimit të Mbetjeve do të mbulojë hapsirën kohore 2024-2029.

**Këshilli Bashkiak**: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të menaxhimit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme (Ligjit 9537).

**Policia e bashkiake** është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër, në të gjitha Nj.A. ofrohet nga kompani private të kontraktuara nga bashkia dhe monitororohet dhe kontrollohet rregullisht nga stafi i bashkisë. Në diagramën më poshtë tregohet se si funksionon struktura në bashki për menaxhimin e mbetjeve:

Kompanitë private ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë, bazuar në kushtet e përcaktuara në kontratën e nëshkruar me bashkinë. Në Nj.A. Shkodër për të 5 lagjet e qytetit bashkia ka inspektorin përkatës, i cili monitoron ofrimin e shërbimit dhe raporton tek superviori i zonës veriore ose jugore i cili më pas raporton tek përgjegjësi i sektorit. Përgjegjësi i sektorit së bashku me specialistin e sektorit, nën varësi të Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të Shërbimeve të Infrastrukturës, koordinojnë sistemin e menaxhimit të mbetjeve që nga hartimi i preventivave për kontratat, evidentimin e gjendjes ekzsituese të infrastrukturës dhe hartimin e raporteve përfundimtare të gjendjes së shërbimit. Bashkia në landfillin e Bushatit ka caktuar një supërvizor i cili kryen raportime të rregullta mujore në lidhje me ngarkesat e mbetjeve që vijnë në landfill nga i gjithë territori i bashkisë. Përgjegjësi i sektorit është personi kryesor në menaxhimin e sistemit, jo vetëm për Nj.A. Shkodër por edhe për njësitë e tjera, ku të gjithë administratorët raportojnë tek përgjegjësi në lidhje me situatën e ofrimit të shërbimit në territorin e tyre. Përgjegjësi i sektorit raporton tek Drejtori i Shërbimeve Publike për situatën e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë, i cili më pas raporton në instancat vendim-marrëse të bashkisë (zv.Kryetari dhe Kryetari).

---

[2] Ky trajtim harmonizon mënyrën se si mbetjet subjekt i planeve vendore janë përkufizuar respektivisht në ligjin 139/2015 dhe 10 463/2011 duke marrë në konsideratë konceptin e mbetjeve të ngurta bashkiake nga EUROSTAT/OSBE dhe Direktiva Kuader 2008/98/KE dhe Direktivën për Landfill-et (1999 EU)

## 2.8 KUADRI LIGJOR PËR STANDARDIN MINIMAL PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, në nenin 23, pika 10, një ndër funksionet e bashkisë (fusha e saj e veprimtarisë, ku ajo është përgjegjëse dhe ka autoritetin ligjor për ta ushtruar atë lirisht, tërësisht apo pjesërisht neni 2, pika 3), në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, u përcaktua ai i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake. Nisur nga përcaktimi që bën ky ligj për shërbimet publike (neni 2, pika 13), ***shërbimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta është ai shërbim me interes të përgjithshëm publik, i cili duhet t'i ofrohet të gjithë komunitetit në territorin e bashkisë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmim të përballueshëm, bazuar në standardet minimale kombëtare.*** Ky ligj, përveç tre proceseve kryesore të përcaktuar edhe në ligjin bazë për menaxhimin e integruar të mbetjeve për ofrimin e shërbimit, sjell për herë të parë disa nocione apo principe (të pranuara de facto) që duhet të plotësojnë njësitë e qeverisjes vendore në proceset e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e tyre, siç janë:

1. *Gjithëpërfshirja e komunitetit* dhe territorit që merr shërbim;

2. *Vazhdimësia* e ofrimit të shërbimit;

3. *Përballueshmëria financiare* për ofrimin e shërbimit;

4. *Plotësimi i standardeve kombëtare* të përcaktuara nga ligjet sektoriale.

Ligji vazhdon me përcaktimin e 5 formave të lejuara për mënyrën e organizimit të shërbimit publik, në këtë rast menaxhimi i mbetjeve, nga ana e pushtetit vendor me anë të: i) Njësive organizative, si pjesë

e strukturës administrative të bashkive; ii) Ndërmarrjet e shërbimeve publike; iii) Kontraktimi i palëve të treta; iv) PPP; v) Shoqëritë tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësive vendore.

Pavarësisht formës të administrimit që zgjedhin njësitë vendore për ofrimin e shërbimit të mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake, ato kanë përgjegjësi për vendosjen e sistemit të administrimit të performancës së shërbimit (neni 33, pika 2), dhe krijimin e një strukture të posaçme në njësinë e qeverisjes vendore për prezantimin, mbikqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit publik. Ligji vazhdon me përcaktime të reja në lidhje me proceset e ciklit të ofrimit të shërbimeve publike (menaxhimin e mbetjeve në këtë rast), ku njësitë vendore duhet të bëjnë transparente shërbimet e menaxhimit të mbetjeve për komunitetin (neni 15, pika 1), nga koordinatori i transparencës (neni 15, pika 3), dhe njëkohësisht çdo qytetar i njësisë vendore ka të drejtë të bëjë kërkesa, ankesa apo vërejtje pranë njësisë vendore në lidhje me shërbimet publike që ofrohen në njësinë vendore (neni 19).

Në përfundim mund të themi që ligji për vetëqeverisjen vendore sjell në vemendje të njësive vendore disa elemente[3] shumë të rëndësishme në lidhje me standardin për ofrimin e shërbimeve publike, duke prezantuar për herë të parë konceptin e vlerësimit të shërbimit publik sipas indikatorëve të performancës dhe detyrimin e ofrimit të shërbimit bazuar në standardin minimal.

Në vitin 2015, kur ligji hyri në fuqi, për njësitë vendore ishte ende e paqartë se kur një shërbim publik (menaxhimi i mbetjeve në këtë rast) do të konsiderohej se përmbushte apo jo standardin minimal. Në

këtë kontekst, ***Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035*** bëri përpjekje për përcaktimin e standardit minimal të ofrimit të shërbimit nga njësitë vendore (në rastin konkret atë të menaxhimit të mbetjeve nga njësitë vendore), i cili përkufizohet

si: "Shtrirja e shërbimit dhe mbledhja e mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të bashkisë, duke siguruar mjetet e nevojshme dhe të mjaftueshme të grumbullimit, transportit dhe depozitimin në një vend të kontrolluar." Nisur nga ky përkufizim për standardin minimal, strategjia ka shkuar përtej duke përcaktuar aktivitetet dhe prioritarizmin e tyre, të cilat bashkitë duhet t'i përqafojnë në kohë, në përmbushje edhe të detyrimeve ligjore sipas ligjit vendor për të ofruar një shërbim sipas standardit minimal. Konkretisht strategjia përcakton si prioritet fillestar për bashkinë, shtrirjen e shërbimit në 100% të territorit urban dhe depozitimin i mbetjeve në një vend-depozitim të kontrolluar dhe të pajisur me leje. Prioriteti i dytë është shtrirja e shërbimit në 90% të territorit rural dhe prioriteti i fundit është ai i ndarjes së mbetjeve për riciklim të mëtejshëm. Për të përfunduar të gjitha kërkesat ligjore që njësitë vendore duhet të përmbushin për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve sipas standardit të kërkuar kombëtar, ku përfshihen të gjitha proceset e shërbimit (grumbullimi, transportimi, riciklimi, trajtimi, monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit sipas indikatorëve të performancës, raportimi dhe informimi i komunitetit), hallka e fundit është detyrimi i raportimit nga palët e treta dhe krijimi i databazës së mbetjeve dhe raportimi më tej, nga njësitë vendore. Që nga viti 2011, kur ligji i ri "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar hyri në fuqi, statistikat e mbetjeve iu kaluan Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si një nga detyrat për ta zhvilluar më tej. Bazuar në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, neni 60 "Për statistikat e mbetjeve",është aprovuar VKM nr. 687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mirëmbajtjen, rifreskimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", ku jep të drejtën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të mbajë të dhënat e mbetjeve nga njësitë vendore dhe autoritetet e tjera kombëtare përmes mbledhjes së listave të kontrollit të përcaktuara nga VKM.

[3] Principet bazë në lidhje me domethënien e ofrimit të një shërbimi publik (gjithëpërfshirja, vazhdimësia, përballueshmëria financiare dhe plotësimi i standardit minimal të përcaktuar me ligj) Format e mundshme ligjore të organizimit dhe administrimit të shërbimit nga njësitë vendore Krijimi i strtrukturës së posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimit sipas sistemit të indikatorëve të performancës Krijimi i strukturës së posaçme dhe procedurave për transparencën me komunitetin në lidhje me shërbimin e mbetjeve dhe aksesibiliteti i vazhdueshëm i komunitetit për të qënë pjesë e sistemit të kontrollit të shërbimit (ankesa, vërejte, sugjerime, etj.,)

Në këtë pikë, të gjitha njësitë vendore (61 bashki) duhet të plotësojnë listën e kontrollit për 11 rrymat e mbetjeve që gjenerohen në territorin e tyre dhe duhet t'ia dorëzojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo vit, si dhe institucioneve të tjera kombëtare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pas hyrjes në fuqi të ligjit bazë për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të gjitha VKM-të e tjera në vazhdim për rrymat specifike të mbetjeve përcaktuan qartë se të gjithë prodhuesit, përdoruesit, shpërndarësit dhe palët e treta të rrymave specifike duhet të raportojnë çdo vit në njësinë vendore ku ato operojnë, në lidhje me sasinë e mbetjeve që gjenerojnë dhe trajtojnë gjatë vitit.

## 2.9 RRYMA E MBETJEVE, OBJEKTI I PLANIT

Sipas legjislacionit në fuqi2, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Shkodër është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuara, etj .), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bisneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta' për të cilat njësia vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

[2] Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, amenduar me ligjin nr.156, datë 10.10 2013

VKM nr. 48, datë 25.06.2017 "Për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim"

# 3. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

## 3.1 TË DHËNAT GJEOGRAFIKE DHE DEMOGRAFIKE

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 211'117 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (115'765 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 28,448 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 12,166 banorë, Postriba me 11'705 banorë, Bërdica me 10'017 banorë, Velipoja me 9'922 banorë dhe Dajçi me 9,098 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 6'130 banorë, Pulti me 2'919 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 4'947 banorë.




*Figure nr.2. Pozicioni gjeografik Bashkia Shkodër*




*Figure nr.3: Ndarja e re administrative Bashkia Shkodër*

Qendra e Bashkisë: Qyteti Shkodër

Popullsia (Regjistri Civil): 211'117 banorë

Popullsia CENCUS 2011: 135'612 banorë

Sipërfaqja: 873 km2

Dendësia 240'76 banorë/km²

- 11 Njësi Adminsitrative
- 1 Qytet
- 93 Fshatra

Numri i familjeve total: 65'117

Tabela 2 :Të dhëna demografike sipas njësive administrative

| Emri i Njësisë | Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre | Sip. m² | Nr. i Banorëve 2022 | Nr. i Banorëve 2019 |
|---|---|---|---|---|
| Shkodër | Qyteti Shkodër | 1'646 | 115'765 | 115'215 |
| Ana e Malit | Fshatrat; Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh,Oblikë e siperme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar | 4'400 | 6'130 | 6'094 |
| Bërdicë | Fshatrat; Bërdice e Madhe, Bërdice e mesme, Bërdice e siperme, Trush, Beltoje, Mali Hebaj | 3'102 | 10'017 | 9'811 |
| Dajç | Fshatrat; Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Siperm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq | 3'652 | 9'098 | 9'047 |
| Guri I Zi | Fshatrat; Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor | 8'170 | 12'166 | 12'003 |
| Postribë | Fshatrat; Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz | 11',090 | 11'705 | 11'666 |
| Pult | Fshatrat; Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull | 12'290 | 2'919 | 3'064 |
| Rrethinat | Fshatrat; Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i vjeter, Zues, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj | 4'705 | 28'448 | 26'399 |
| Shalë | Fshatrat; Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënmavriq, Lotaj | 21'505 | | |
| Shosh | Fshatrat; Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë | 9'524 | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Velipojë** | Fshatrat; Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj | 7'240 | 9'922 | 9'715 |

Struktura e popullsisë

- 21.2% - grupmosha 0-14 vjeç
- 66.4% - grupmosha 15-64 vjeç
- 12.4 % - grupmosha +65 vjeç

## 3.2 TË DHËNA EKONOMIKE

Bashkia Shkodër dhe rajoni i Veriut me të gjithë tërësinë e vlerave dhe resurseve natyrore dhe ekonomike, kontribuon në mënyre thelbësore, direkt dhe indirekt në vlerat e përgjithshme ekonomike dhe sociale kombëtare, si në ekonomi, tregëti, bujqësi, në promovimin e imazhit ndërkombëtar të vlerave me të mira natyrore, kulturore dhe atyre shpirtërore. Bashkia Shkodër me resurset dhe vlerat e saj kontribuon ne GDP kombëtare nëpërmjet sistemit hidrik në prodhimin e energjisë elektrike, në prodhimin mineral, si dhe kontributin e saj nga të ardhurat doganore dhe tatimore etj. Aktualisht sipërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme janë burimi kryesor i të ardhurave ekonomike dhe kanë një strukturë si më poshtë:

*Tabela Nr.3 Struktura e Bizneseve në Bashkië Shkodër*

| Nr | Njësia Administrative | Nr. i Bizneseve të Mesme | Nr. Bizneseve të Vogla | Institucione | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkodër | 1,172 | 3279 | 53 | 4504 |
| 2 | Velipojë | 48 | 201 | 0 | 249 |
| 3 | Rrethina | 114 | 225 | 4 | 343 |
| 4 | Postriba | 17 | 72 | 0 | 89 |
| 5 | Guri Zi | 24 | 91 | 1 | 116 |
| 6 | Dajç | 16 | 38 | 0 | 54 |
| 7 | Bërdicë | 53 | 79 | 0 | 132 |
| 8 | Ana Malit | 19 | 47 | 0 | 66 |
| 9 | Shala | 3 | 22 | 0 | 25 |
| 10 | Shoshi | 0 | 4 | 0 | 4 |
| 11 | Pult | 0 | 1 | 0 | 1 |
| Total | | 1,466 | 4,059 | 58 | 5,583 |

Ndër aktivitet kryesore ekonomike në Bashkinë Shkodër përmendim zhvillimin e bujqësisë, kryesisht në Njësitë Administrative në zonën e nën Shkodrës si dhe blegtorinë e cila është e zhvilluar në të gjithë territorin e bashkisë. Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkisë Shkodër. Numri i fermave bujqësore është rreth 11,200 dhe me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe

frutikulturë (për tregun lokal), me një madhësi mesatare prej 1.1 ha/fermë e ndarë kjo në 2-3 parcela. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,054 ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë, tokës argjilore e mesme (SAM) dhe me bonitet mesatar III-IV.

Vlen të përmendet, edhe pse në ritme jo të larta, në zonat periferike të qytetit të Shkodrës ka një sërë stabilimetesh të cilat zhvillojnë industrinë e fasonerisë.

Turizmi, gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në bashkinë e Shkodrës në të ilin është i zhvilluar si turizmi malor kryesisht në fshatin Theth si dhe atë veror ku Nj.A e Velipojës ka një fluks të madh turistësh vendas e të huaj gjatë sezonit të verës. Ndër të tjera mund të përmendim edhe zhvillimin e turizmit kulturor në këtë bashki ku ndër më të spikaturat janë Kalaja e Rozafës, Pedonalja e Shkodrës si dhe Muzeu i Fotografisë 'Marubi". Turizmi luan një rol të madh në zhvillimin e kësaj zone pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës si dhe zhvillimin e zonave rurale pasi shton kërkesën për të mira si pasojë e rritjes së popullsisë.

Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehtë prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile si dhe tregti e biznese shërbimesh. Si një zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale kemi prani të bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Gjithashtu edhe prania e bizneseve të artizanatit, të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Shkodrës, vazhdon akoma sot duke luajtur rol të veçantë në ekonominë vendore. Industria përpunuese përbën një nga potencialet më të mëdha të zhvillimint në Shkodër. Prania e zonës industriale në Shkodër, në të cilën janë përqëndruar biznese të mëdha përpunuese është një tjetër element me rëndësi në zhvillimin ekonomik, duke ofruar punësim dhe të ardhura për popullsinë.

## 3.3 ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË SHKODËR

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit realizohet nga pale të treta, kompani private, të kontratuara nga Autoriteti Kontraktor i Bashkisë Shkodër. Njëkohësisht, bashkia ka ngritur një sistem monitorimi dhe e ka standartizuar atë me anë te miratimit të procedurës standarde të administrimit dhe ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Në organogramën e mëposhtme është paraqitur sistemi i monitorimit dhe raportimit të shërbimit të pastrimit:

Shërbimi i pastrimit në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër ndahet në tre zona funksionale, Qëndrore, Perëndimore, Lindore.

Tabela Nr.4: Shërbimet e ofruara për pastrimin nga bashkia, në bazë të zonës funksionale.

| Shërbimi/ Zona | Qëndrore | Perëndimore | Lindore |
|---|---|---|---|
| Afati kontraktual | 30.04.2024 | 28.06.2026 | 18.10.2026 |
| Burimet njerëzore | 80 punonjës | 40 punonjës,<br>10 përgjatë gjithë vitit e 30 punonjës sezonal, | 13 punonjës |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Mjetet** | 8 mjete plus nje mjet rezervë | 2 mjete nga 10 ton përgjatë gjithe vitit dhe nje 1 mjet 10 ton e 1 mjet 5 ton rezerve. | 2 mjete 10 ton, 1 mjet 7 ton dhe 1 mjet 10 ton rezervë. |
| **Frekuenca e pastrimit** | Cdo ditë, qëndra dy herë në ditë. | Dy herë në javë, përgjatë sezonit turistik, në Velipoje-Plazh është dy herë në ditë. | Tre herë në jave, Zona Theth dy herë në javë. |




*Figure nr.4: Struktura bashkiake për menaxhimin e mbetjeve*

Bashkia Shkodër ka pasur një plan të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për periudhën 2017-2022. Bashkia Shkodër ka miratuar Rregulloren për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta urbane me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.35 datë 26.10.2023. Drejtoria e shërbimeve publike ka të miratuar Procedurën standarde të administrimti të ofrimit të shërbimti të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, e cila funksionon si rregullore e

brëndshme e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

## 3.4 ASPEKTE TEKNIKE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE NË BASHKINË SHKODËR

### 3.4.1 Përbërja mercologjike e mbetjeve

Gjatë hartimit të Startegjisë dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve në vitin 2010, Bashkia Shkodër (vetëm NJA Shkodër), ishte një ndër qytetet, të cilat u morën si qytete kampion për përcaktimin e përbërjes mercologjike të mbetjeve. Në tabelën më poshtë tregohet përbërja mercologjike e qytetit të Shkodrës për 16 rrymat e mbetjeve të përzgjedhura gjatë fazës së kampionimit:

Tabela 4: Përbërja mercologjike e mbetjeve në nivel kombëtar

| Nr. | Kategoria e mbetjeve | % |
|---|---|---|
| 1 | Organike | 45.4% |
| 2 | Druri | 1.5% |
| 3 | Letër | 5.1% |
| 4 | Karton | 8.3% |
| 5 | LD- plastike | 10.7% |
| 6 | HD-plastike | 3.5% |
| 7 | Qelqi | 5.4% |
| 8 | Tekstile | 5.1% |
| 9 | Metale-ferrore | 0.5% |
| 10 | Metale me ngjyra | 0.5% |
| 11 | Mbetje spitalore | 4.5% |
| 12 | Produkte Kauçuku | 0.3% |
| 13 | Inerte | 7.7% |
| 14 | MPEE | 0.5% |
| 15 | Bateritë | 0.03% |
| 16 | Prodhime të mbetjeve nga kafshët | 1.14% |

Në vitin 2021 në kuadër të projektit CirculaMare të drejtuar nga GIZ dhe raportit "Baseline assessment" raporti final e paraqet Bashkinë SHkodërm e të dhënat bazuar tabelës sa më poshtë :

Table Nr5: Përbërja merceologjike dhe fraksionet e mbetjeve sipas Studimit të vitit 2021.

| Kategoritë e mbetjeve shtëpiake | Shkodra |
|---|---|
| Mbetje organike | 58.60% |
| Të gjelbërta | 3.91% |
| Letër dhe karton | 8.46% |
| Plastic film | 5.36% |
| Plastic dense | 7.56% |
| Metal | 1.60% |
| qelq | 5.55% |
| Textile& këpucë | 3.57% |
| dru | 1.12% |
| Mbetje speciale (duke përfshirë ato elektronike, akumulatorë,kabull dhe të tjera të rrezikshme por urbane) | 1.11% |
| Mbetje të tjera | 3.16% |

[Burimi: projektit CirculaMare]

Siç mund të shihet nga grafiku, mbetjet organike përbëjnë përqindjen më të madhe të mbetjeve në qytetin e Shkodrës, të ndjekura nga plastika, letra&kartoni dhe mbetjet inerte. 72% e sasisë të mbetjeve në qytetin e Shkodrës është e biodegradueshme (organike, lëndë drusorë, letër dhe karton), ndërsa 20.07% të sasisë të mbetjeve të qytetit e përbëjnë mbetjet e riciklueshme (plastikë, qelq, metale, tekstile), ku vetëm mbetjet plastikë përbëjnë 12.92% të sasisë së mbetjeve. Rreth 7.84 e sasisë janë mbetje të tjera.

### 3.4.2. Efekti i turizmit në menaxhimin e mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve është i lidhur direkt me demografine, dhe komponenti kryesor ne analizën e menaxhimin të mbetjeve është numri i popullsisë e cila merr shërbim nga Bashkia. Përvec të dhënave nga Gjendja Civile, dhe Census 2011, Bashkia duhet të mbledhë të dhëna të detajuara mbi numrin e rezidenteve në territorin e saj, duke përfshirë këtu edhe numrin e vizitorëve të huaj apo vendas.

Në zonat me fokus turistik si Velipojë Plazh dhe Theth-Nderlysaj, analiza e detajuar e numrit të vizitorëve në ditë, merr vlerë të shtuar. Numri i popullsisë rezidente vendase në këto zona është i papërfillshëm, dhe shërbimi i pastrimit fokusohet praktikisht vetëm tek turistët. Shqipëria është një vend me turizëm sezonal, dhe kurba e ndryshimimt të numrit të personave që cilët marrin shërbim është elementi kryesor për një planifkim të mirë të mbarëvajtjes së sezonit turistik. Për komponentin e menaxhimit të mbetjeve, Bashkia Shkodër përdor të dhënat si më poshtë:

Tabela nr. 6. Popullsia rezidente Theth- Nderlysaj




[Burimi: Punuar nga Autori]

Tabela nr. 7. Popullsia rezidente Velipojë Plazh




[Burimi: Punuar nga Autori]

# 4. INDIKATORËT E PERFORMANCËS

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistues të shërbimit në Bashkinë Shkodër, u bë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët: i) Cilësia e shërbimit; ii) Qendrueshmëria mjedisore; iii) Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare. Secili nga tre indikatorët ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

**Cilësia e shërbimit - Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.**

*a.* C1 Mbulimi i zonës më shërbim: ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA nga firma private e autorizuar ose nga njësia vetë (nëse e kryen ajo shërbimin) kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në njësi:

$$C1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen në zonë } (\frac{ton}{vit})}{\text{Sasia e mbetjeve që gjenerohen në zonë } (\frac{ton}{vit})} x\ 100$$

*b.* C2: Pastërtia e bashkisë: ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga tre kritere vlerësimi:

i. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuara rreth PGM);
j. Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë);
k. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve në zonat e largëta (prezenca e mbetjeve të akumuluara/pika ilegale/ djegie të mbetjeve në rrugë).

c. **C3:** Shkalla e kënaqësisë publike: ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetsorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme: **A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?**

Për vlerësimin e këtij indikatori kanë shërbyer fushatat e pyetësorëve dhe dëgjesta publike të zhvilluara nga bashkia

**Qendrueshmëria mjedisore – Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.**

a. **D1:** Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara. Formula për llogaritjen e këtij inidikatori jepet si më poshtë:

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen të ndara në zonë } \left(\frac{ton}{vit}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total në zonë } \left(\frac{ton}{vit}\right)} \times 100$$

b. **D2:** Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave: ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuara. Formula për llogaritjen e këtoj indikatori jepet si më poshtë:

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që trajtohen në impiante } \left(\frac{ton}{vit}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total } \left(\frac{ton}{vit}\right)} \times 100$$

**Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare: Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.**

a. **E1** – Mbulimi i Kostos: ky indikator mat sa kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave. Formula më poshtë tregon se llogaritet ky indikator:

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve } \left(\frac{lek}{vit}\right)}{\text{Kosto totale e shërbimit } \left(\frac{lek}{vit}\right)} \times 100$$

b. **E2** – Shkalla e mbledhjes së tarifës: ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën. Formula për llogaritjen e këtij indikatori jepet në formulën më poshtë:

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit } \left(\frac{lek}{vit}\right)}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara } \left(\frac{lek}{vit}\right)} \times 100$$

c. **E3** – Transparenca në systemin e faturimit: ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:

i. I ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit
ii. Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë
iii. I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritur dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komunitetin

Më poshte jepen rezultat e vlerësimit të gjendjes ekzistuese sipas indikatorëve të performancës në Bashkinë Shkodër:

*INDIKATORI 1:* Niveli I mbulimit të popullsise me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve




*INDIKATORI 2:* Shkalla e grumbullimit të ndarë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta

Bashkia Shkodër ***nuk kryen grumbullim*** të ndarë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta

INDIKATORI 3: Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave *(në impiante sanitare ose vend depozitime të kontrolluara)*

*Bashkia Shkodër depoziton 100% të mbetjeve të grumbulluara në landfillin e Bushatit*

*INDIKATORI 4:* Mbulimi i kostos së shërbimit nga realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit

Vëmendje: Bashkia ka grumbulluar më shumë të ardhura nga tarifa e pastrimit sesa ka shpenzuar për ofrimin e shërbimit. Shifrat e buxhetit faktik dhe të ardhurat e grumbulluara duhet të përkojnë me vitin përkatës dhe borxhet nuk duhet të jenë pjesë e këtyre shifrave pasi krijojnë përshtypjen e gabuar për performancën financiare të bashkisë.




*INDIKATORI 5:* Niveli I grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit kundrejt planiffikimit të të ardhurave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve

Vëmendje: Sipas të dhënave të bashkisë, të ardhurat e mbledhura nga tarifa kanë tejkaluar shpenzimet faktike për shërbimin dhe bashkia në dukje tregon se performon mjaft 34ire nga ana financiare. Kujdes në të dhënat për të ardhurat nga tarifa e pastrimit nuk duhet të përfshihen borxhet apo tarifa të tjera për të kuptuar qartë performancën fiskale.




**Tabela Nr.6: Indikatorët e performanës 2020-2023**

| | Qarku Shkodër | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Shkodër | | | |
| Indikatorët e performancës | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Cilësia e shërbimit | C1 Mbulimi i zonës me shërbim (të dhënat e bashkisë) | 99% | 97% | 95% | 95% |
| | C2 Pastërtia e bashkisë | 68% | 84% | 84% | 84% |
| | C3 Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat | 100% | 100% | 100% | 100% |
| | D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| | D2-Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave | 100% | 100% | 100% | 100% |
| | E1 Mbulimi i kostos (shpenzimet faktike) | 113% | 130% | 100% | 99% |
| | E1' Mbulimi i kostos (buxheti plan) | 73% | 54% | [illegible] | 63% |
| | E2 Niveli i grumbullimit të të ardhurave | 99% | 98% | 107% | 107% |
| | E2.1 Kosto njësi (lek/ton) | 5,554 | 8,694 | 11,678 | 8,556 |
| | E2.2 Kosto për banorë (lek/banorë) | 1,299 | 1,842 | 2,424 | 1,833 |
| | E3 Transparenca në sistemin e faturimit | 60% | 80% | 80% | 80% |
| Qëndrueshmëria | F1 Transparenca në aspektet institucionale | 92% | 92% | 92% | 92% |

## 4.1 GJENERIMI I MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur sasite e mbetjeve totale te gjeneruara nga Bashkia Shkodër:




Figure nr.5: Gjenerimi i mbetjeve në Bashkinë Shkodër

## 4.2 TRAJTIMI I MBETJEVE

Bashkia Shkodër dorëzon mbetjet urbane të të gjithë territorit në lendfillin rajonal të Bushatit në Bashkinë e Vau dejës. Tarifa e depozitimit është 1,695 lekë pa tvsh / 2,034 lekë me tvsh. Distanca

mesatare që është edhe përllogaritur kosto e shërbimit për qytetin qendër është 17 km, për zonën perëndimore është 25 km dhe për zonën lindore është 3 km.
Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur depozitimet në Landfillin e Bushatit për vitin 2022:

| MUAJI | | FIRMA SIPERMARRESE ALKO-IMPEX | | | | | FIRMA SIPERMARRESE LEKA 2007 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | QYTETI | Rrethina | Postrib | Shale | Guri-Zi | Berdice | Ana Malit | Velipoje | Dajc | SASIA |
| Janari | Ton | 1,924.64 | 211 | 33.44 | 0 | 31.46 | 27.72 | 64.76 | 74.26 | 42.5 | 2,409.78 |
| Shkurti | Ton | 1,644.12 | 498.5 | 62.94 | 0 | 29.78 | 19.24 | 34.02 | 100 | 29.32 | 2,417.92 |
| Marsi | Ton | 1,753.88 | 275.1 | 6 | 5.9 | 45.32 | 30.72 | 32.34 | 51.78 | 46.36 | 2,303.68 |
| Prilli | Ton | 1,957.9 | 298.82 | 0 | 4.84 | 32.34 | 22.88 | 55.74 | 97.66 | 26.02 | 2,496.2 |
| Maji | Ton | 2,045.22 | 354.24 | 8.36 | 13.7 | 15.34 | 32.48 | 73.86 | 178.08 | 41.22 | 2,762.5 |
| Qershor | Ton | 2,019.6 | 260.44 | 56.74 | 25.28 | 32.94 | 17.8 | 53.28 | 407.74 | 26.5 | 2,900.32 |
| Korriku | Ton | 2,201.26 | 181.74 | 105.82 | 35.86 | 63.04 | 22.62 | 45.32 | 628.86 | 50.46 | 3,334.98 |
| Gushti | Ton | 2,289.2 | 251.18 | 109.96 | 31.88 | 47.7 | 26.6 | 39.34 | 807.94 | 63.64 | 3,667.44 |
| Shtatori | Ton | 2,122.56 | 239.14 | 65,380 | 36.22 | 41.42 | 22.64 | 44.96 | 198.72 | 53 | 2,824.04 |
| Tetori | Ton | 2,127.48 | 211.32 | 108.72 | 19.16 | 40.28 | 23.6 | 58.74 | 60.32 | 52.74 | 2,702.36 |
| Nentori | Ton | 1,983.46 | 184 | 75.7 | 4.68 | 36.44 | 37.32 | 78.62 | 51.9 | 72.32 | 2,524.44 |
| Dhjetori | Ton | 1,985.86 | 267.4 | 52 | 7.4 | 25.9 | 52.76 | 99.3 | 18.5 | 77.66 | 2,586.78 |
| Totali | Ton | 24,055.2 | 3,232.9 | 741.36 | 184.9 | 441.96 | 336.38 | 680.28 | 2,675.8 | 581.74 | 32,930.4 |

Table 7: Sasia e mbetjeve të depozituara në lnadfillin e Bushatit nga bashkia Shkodër – viti 2022

# 5. ASPEKTET FINANCIARE NË MENAXHIMIN E MBETJURINAVE

## 5.1 ANALIZA FINANCIARE E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur aspektet financiare të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Shkodër:

| Aspektet financiare | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| **Buxheti (fakt) total i të gjithë Bashkisë Shkodër** | 2'774'973'734 | 2'792'779'414 | 2'950'182'509 |
| **Buxheti (PLAN) për shërbimet publike (menaxhimin e mbetjeve - i miratuar në këshill bashkiak) (lek/vit)** | 205'000'000 | 197'340'000 | 257'348'000 |
| **Buxheti (fakt) I shërbimeve publike(Prog.06260+06440)** | 185'586'427 | 171'028'847 | 203'365'661 |
| **Buxheti (fakt) për menaxhimin e mbetjeve** | 131'593'277 | 121'313'366 | 183'173'473 |
| **Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit (lek/vit)** | 150'952'000 | 169'711'000 | 171'363'000 Lekë |
| **Planifikimi i të ardhurave nga familjet (lek/vit)** | 68'790'000 | 73'699'000 | 75'328'000 Lekë |
| **Planfikimi i të ardhurave nga bizneset dhe institucionet (lek/vit)** | 82'162'000 | 96'012'000 | 95'571'000 Lekë |
| **Realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit (lek/vit)** | 149'117'000 | 157'588'000 | 183'337'000 |
| **Realizimi i të ardhurave nga familjet (lek/vit)** | 72'661'000 | 62'011'000 | 72'621'000 |
| **Realizimi i të ardhurave nga bizneset dhe institucionet (lek/vit)** | 76'456'000 | 95'577'000 | 110'716'000 |

**Tabela 8: Realizim i buxhetit nga grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit**

Në grafikun më poshtë paraqitet realizimi të ardhurave nga secila kategori e konsumatorëve:



| VITI | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |
|---|---|---|---|---|
| Grumbullim I mbetjeve & pastrim | 44,022,518.61 | 51,625,319.65 | 40,503,399.51 | 74,943,954.54 |
| Transporti I mbetjeve | 36,018,424.32 | 42,238,897.89 | 33,139,145.06 | 61,317,780.99 |
| Depozitimi ne landfill | 34,260,830.40 | 27,449,149 | 91,794,436 | 49,872,597 |
| Investime | 7,635,000.00 | 0 | 10,092,000 | 1,183,680 |
| Te tjera | 9,656,504.00 | 0 | 7,644,493 | 341,074 |
| TOTAL | 131,593,277.33 | 121,313,367 | 183,173,473 | 187,659,087 |




Figure nr.6: Realizimi i të ardhurave nga kategoritë e konsumatorëve

Bashkia Shkodër aplikon këto tarifa pastrimi për familjet në njësitë administrative:

| Njësia Administrative | Tarifa e pastrimit (lek/familje/vit) |
|---|---|
| Rrethina, Postriba, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë | 1,950 |
| Shalë, Pult, Shosh | 1,450 |
| Shkodër | 3,450 |

Tabela 9: Tarifa e pastrimit për familjet në Bashkinë Shkodër

Tabela 10. Ndarja e zerave ne grumbullim&pastrim dhe Transport

Bashkia Shkodër ka si agjent tatimor për tarifën e pastrimit për familjarët Ujësjellësin sha Shkodër.

Siç mund ta shohim, buxheti për menaxhimin e mbetjeve mbetet në të njëjtat shifra që nga viti 2017 deri më sot, nga buxheti i përgjithshëm i bashkisë fakt buxheti për menaxhimin e mbetjeve përbën 5% deri në 7% në vitin 2022. Ndërsa në vitin 2017 buxheti fakt i menaxhimit të mbetjeve zinte 50% të buxhetit të shërbimeve publike në 2020 dhe 2021 përbën 71% të buxhetit të shërbimeve publike ndërsa në vitin 2022 rreth 90% të vlerës totale të këtij zëri buxhetor .

## 5.2 KOSTO E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE SIPAS ZONAVE FUNKSIONALE

Referuar kontratave të shërbimit të pastrimit, territori i bashkisë është i ndarë në tre zona shërbimi: zona qëndrore, zona lindore dhe zona perëndimore. Llogaria e kostos per sherbimin e Pastrimit është bërë në zbatim të **VKM Nr. 319 datë 31.05.2018 "Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve" sipas modelit të miratuar nga kjo VKM.** Ketu perfshihen te gjitha elementet e ketij sherbimi sipas specifikimeve teknike. Cdo zë shërbimi i bazohet analizave përkatëse. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve parashikohet program buxhetor më vete programi 5100 "Menaxhimi i mbetjeve urbane". Në tabelën më poshtë tregohen më qartë zërat e buxhetit të parashikuar për Bashkinë Shkodër për shërbimin e pastrimit në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër në të trija zonat funksionale:

Tabela 11. Kosto e shërbimit për cdo zonë funksionale

| | **ZONA PERËNDIMORE** | |
|---|---|---|
| **Analizë** | Lloji i Sherbimit | Vlera / pa TVSH |
| A | Zona 1 (Njësitë administrative) | 16,768,835.85 |
| B | Zona 2 (plazh velipjë) | 5,312,903.27 |
| C | Zona 3 (mbeldhje derë më derë Velipojë plazh) | 4,748,345.92 |
| D | Procese te tjera ne sherbim te pastrimit | 5,590,210.00 |
| | TOTALI PA TVSH 12 MUAJ | 32,420,295.05 |
| | TOTALI ME TVSH 12 MUAJ | 38,904,354.06 |

| | **ZONA LINDORE** | |
|---|---|---|
| **Analizë** | Lloji i Sherbimit | Vlera / pa TVSH |
| A | Zona 1/ (Nj.a Rrethina, Postribe, Gur i Zi) | 26,210,164 |
| B | Zona 2/ ( Nj.a Shalë ) | 2,873,815 |
| C | Procese te tjera ne sherbim te pastrimit pa TVSH | 590,640 |
| | TOTALI PA TVSH 12 MUAJ | 29,674,619 |
| | TOTALI ME TVSH 12 MUAJ | 35,609,542.8 |

| | **ZONA QËNDRORE** | |
|---|---|---|
| **Analizë** | Lloji i Sherbimit | Vlera / pa TVSH |
| A | Zona 1 / Qyteti | 57,617,915.00 |
| B | Zona 2 (Pedonalet, mbledhje dere ne dere) | 6,158,473.45 |
| C | Procese te tjera Fshirje -larje-mirembajtje | 44,946,047 |

| | |
|---|---|
| TOTALI PA TVSH 12 MUAJ | 108,722,435 |
| TOTALI ME TVSH 12 MUAJ | 130,466,922 |

# 6. ZONAT FUNKSIONALE TË ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE (ZFAM)

## 6.1 SKEMAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT NË BASHKINË SHKODËR

Bashkia Shkodër ka në prioritetet të punës të përditshme dhe detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore përkatëse, ofrimin e shërbimit të pastrimit, me standarte dhe performancë sa më të lartë, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit. Për realizimin e këtyre objektivave, Institucioni i Bashkisë Shkodër ka mundur të realizojë procedurat e prokurimit për tre zonat e shërbimit atë perëndimore dhe lindore, ndërsa për qytetin po propozon një skemë shërbimi me skemën e mbledhjes derë më derë në zona me destinacion turizmin. Referuar kontratave të shërbimit të pastrimit, territori i bashkisë është i ndarë në tre zona shërbimi: zona qëndrore, zona lindore dhe zona perëndimore. Zonat perëndimore dhe lindore kanë kontratë me sipërmarrës të ofrimit të shërbimit të pastrimit me një afat tre vjecare. Llogaria e kostos per sherbimin e pastrimit është realizuar sipas modelit " Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve " miratuar me *VKM nr.319 date 31.05.2018*. Ketu përfshihen të gjitha elementet e këtij sherbimi sipas specifikimeve përkatëse të shërbimit. Të gjitha proceset e punës janë kostuar sipas një analize të thelluar të shërbimit, sic mund të përmendim këtu analizat për zonën perëndimore, mirmbajtja e zonës të plazhit/rërës para dhe mbas sezonit turistik, dezinfektimi i PGM, fshirja manuale , mirëmbajtja e plazhit me punëtorë,mirëmbajtja e PGM've, për zonën lindore mirmbajtja e kontenierëve në njësinë shalë fshatrat turistike, në zonën qendrore mirmbajtja e pikave të grubullimti pastrimi i rrugëve fshirja manuale dhe mekanike larja e pedonaleve,fshirja e rrugëve etj. Burimet njerëzorë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve nga ana e nënkontraktorit janë të shpërndara ndërmjet veprimtarisë së mbledhjes - punëtorët, transportit - shoferët, mirëmbajtjes së PGM-ve dhe supervizorëve.

I. ZONA FUNKSIONALE PERËNDIMORE , territori që mbulon Njësitë Administrative Ana Malit – Bërdicë – Dajc - Velipojë
II. ZONA FUNKSIONALE LINDORE, territori që mbulon Njësitë Administrative Rrethina, Gur i Zi, Postribë, Shalë
III. ZONA FUNKSIONALE QENDRORE , territori që mbulon Nj.A Shkodër Qytet

## 6.1. I. ZONA FUNKSIONALE PERËNDIMORE

Zona funksionale Perëndimore ka të përfshirë njësitë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajc dhe Velipojë, dhe zonën e Plazhit Velipojë.

- Operatori sipërmarrës duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonen Perendimore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit;
- Eshtë parashikuar që në zonen Perendimore cdo ditë prodhohen për Njësitë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajc dhe Velipojë mesatarisht 8.5 ton mbetje/dite, ndërsa për zonën e plazhit Velipojë për 110 ditët e sezonit turistik, mesatarisht 16.9 ton mbetje në ditë;

Figure 7:Harta e ndarjes së zonave të shërbimit bashkia Shkodër




Në zonën Perëndimore ka një popullsi prej 21167 banorë (sipas të dhënave nga formula e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë) pa zonën e plazhit në Velipojë, e cila gjatë stinës së verës, ka mesatarisht 21085 turistë/ditë. Zonat NJA Bërdicë, Ana Malit, Dajç dhe Velipojë kanë karakter rural ndërsa zona e plazhit në NJA Velipojë, ka karakter Semi-Urban, nga ku është përcaktuar edhe koeficienti i gjenerimit të mbetjeve për banor. Në total në zonën rurale parashikohet të gjenerohen mesatarisht 8.5 ton/ditë mbetje të ngurta urbane, ose 3090 ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë vitit, ndërsa për Plazhin, parashikohet një normë gjenerimi prej 16.9 ton /dita në 110 diteshin e sezonit dhe 1856 ton në total gjatë gjithë sezonit. Mbetjet urbane duhet të grumbullohen dhe më pas transportohen në landfillin e Bushatit. Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në terren nga 359 kontenierë metalikë/plastikë me kapacitet 1,100 litra (1.1m3) të shtrirë në njësitë administrative Dajc, Berdicë, Ana Malit dhe Velipojë, Zona 1. Ndersa në zonën Velipojë- Plazh, zona 2 do te kemi të shërndarë 125 kontenierë, zona 3 është caktuar zonë pa kontenierë sepse do të aplikohet sistemi i mbledhjes derë më derë i mbetjeve urbane.

Këto kontenierë janë pronë e Bashkisë Shkodër, merren në dorëzim për administrim dhe mirëmbajtje nga operatori i ofrimit të shërbimit të pastrimit, nën vëmëndje nga administrata e njësive administrative monitorues të shërbimeve dhe administrator, bazuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë për zbatimin e Procedurës standarte të veprimit (rregullore e brëndshme e administratës).

Sipas planit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga 100-500m larg, kjo për të ofruar një shërbim sa më cilësor, duke shkuar sa më afër banorëve. Në zonat e qendrave të NJA-ve dhe në zonën e plazhit, ku gjenerimi i mbetjeve është shumë i madh, në disa raste, pikat e grumbullimit të mbetjeve janë edhe në distancën 50-100m larg. Grumbullimi i mbetjeve në njësitë administrative do bëhet sipas intinerarit të përshkuar më poshtë, që synon një proces sa më efikas dhe cilësor. Distanca totale e përshkuar nga mjetet vetëm për grumbullimin e mbetjeve në PGM në njësitë administrative përgjatë një frekuence është 187 km. Ne zonën Velipojë-Plazh, distanca e përshkuar për grumbullimin e mbetjeve ne PGM është 20 km, ndërsa për grumbullimin e mbetjeve derë më derë është 5 km.

## I.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve .

Shërbimi i grumbullimit (me kontenierë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- Zbrazjen e konteniereve me makinën e përshtatshme teknologjike të percaktuar;
- Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier;
- Pastrim të sipërfaqes prej 30 m$^2$ rreth çdo pike grumbullimi;
- Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike per mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur;
- Dezinfektimin e zonës së kazanëve (PGM), sipas normativave;
- Transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre, lendfillin e Bushatit;

Shërbimi i grumbullimit (derë- më-derë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- Mbledhjen e qeseve derë-më-derë me makinën e përshtatshme të percaktuar, mjet teknologjik 5 ton.
- Transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre, lendfillin e Bushatit.

Për mosrealizimin e kritereve përcaktuar në specifikimet teknike, përcaktohen penalitetet nga ana AK për punë të pa kryer nga operatori sipërmarrës.

## I.2 Skema e grumbullimit

Në zonën e plazhit Velipojë, shërbimi i pastrimit po realizohet me një skemë të re, duke zbatuar dy skenarë. Në zonën e qendër-Velipojë plazh do të realizohet shërbimi derë me derë (mjeti do ndalet në stop-e të parashikuara nga autoriteti kontraktor) në territorin e përcaktuar nga grupi i punës i Bashkisë Shkodër, ndërsa për pjesën tjetër të këtij territori do vazhdohet shërbimi me kontenierë 1100 litra. Në zonën e katër njësive administrative me territor rural, do vazhdohet gjithashtu shërbimi me kontenierë 1100 litra.

Pra, zona Perëndimore do ketë shërbim të ndarë në tre nën-zona:

- *Zona 1* – Përfshin të gjithë territorin e Njësive administrative përfshirë këtu nj.a Ana e Malit, Bërdicë, Dajc dhe Velipojë, ku shërbimi ofrohet gjatë gjithë vitit, 2 herë në javë për cdo njësi administrative, me kontenierë 1.1m$^3$ dhe me dy mjete teknologjike 10 ton.

- *Zona 2 , zona turistike e plazhit Velipojë (pa zonën 3)* - shërbimi ofrohet gjatë 110 ditëve të sezonit veror, 1 herë në ditë/ 7 ditë në javë me kontenierë 1.1m$^3$ dhe me 1 mjet teknologjik 10 ton.
- *Zona 3, zona e Kompleksit Fishta, Rruga 8, 9, dhe qendra e plazhit të Velipojës* – shërbimi ofrohet gjatë 110 ditëve të sezonit veror, 2 herë në ditë/ 7 ditë në javë, sipas modelit derë më derë me një mjet teknologjik 5 ton. Bizneseve muajin e parë operatori do ti furnizojë me qese për t'ua shpërndarë njësive të biznesit dhe atyre akomoduese. Më pas do të duhet ti sigurojnë vetë qeset bazuar në direktivat e Bashkisë zbatuar në muajin e parë të ndërgjegjësimit dhe rregullores përkatëse. Monitorimi i realizimit të fushatës ndërgjegjësuese dhe planit të punës nga ana operatorit, do të realizohet nga specialistët e monitoruesit e njësisë të monitorimit të shërbimevepublike pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike.

Në zonën Perendimore shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet sipas grafikëve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Oraret e grumbullimit do të jenë ditën nga ora 06.00 deri në orën 12.00, për Nj.A. Parashikohet që për Nj.A. të zonës Perëndimore të përdoren 2 mjete teknologjike 10 ton të cilat do të ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve 2 herë në javë për cdo njësi administrative, (bazuar në grafikun e rrugëtimeve si më poshtë me hartat përkatëse).

- Dy mjetet teknologjike 10 ton do të ofrojnë përkatësisht shërbimin në dy njësi administrative brenda ditës, rrugëtimi NJA Ana Malit dhe rrugëtimi NJA Bërdicë me dy mjete, (frekuenca e parë të hënën), vijojne me dy njësitë e tjera të martën po me dy mjetet 10 ton NJA Velipojë dhe NJA Dajç, dhe kështu vazhdon gjatë javës të enjten me të dyja njësitë Ana e Malit dhe Bërdicë, dhe të premten Nj.a Velipojë & Dajç;
- Per zonën e plazhit gjatë sezonit turistik të përcaktuar më 110 ditë kalendarike 01 qershor-18 shtator zona ndahet në zonën 2 dhe zonën 3 në sherbimin me kontenierë dhe shërbimin derë më derë.
- Në zonën 2 shërbimin me kontenierë frekuenca do jetë një herë në ditë, gjatë orarit të drekës apo mbasdites, 15:00-18:00. Per këtë periudhë do përdoret 1 mjet teknologjik 10 ton për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve me kontenierë.
- për zonën nr.3 Plazh Velipojë - sherbimi derë më derë, frekuenca do jetë dy herë në ditë, turni parë rreth orës 06.00-9.00 dhe turni dytë rreth orës 15.00-18.00.

Do të realizohet frekuenca dy herë në ditë në bazë të kërkesave të njësive tregëtare dhe për shkak të një sistemi të ri mbledhje që qytetaret do të duan kohë për tu ndërgjegjësuar vetëm me një orar grumbullimi. Do të lihen dy orare të ndryshme për të dorëzuar mbetjet tek punëtorët e shërbimit që shoqërojnë mjetin teknologjik 5 ton. Pra do jene ne dispozicion 2 frekuenca, por qytetaret/bizneset do zgjedhin vete njeren frekuence per te dorezuar qesen me mbetje tek punetoret e sherbimit. Totali i volumit ditor të gjeneruar përkon me totalin e volumit të përllogaritur për tu mbledur në dy oraret e caktuar për grumbullimin derë më derë (gjithsej 8.4 ton/dite). Oraret e turneve mund të ndryshohen me kërkesë dhe me miratim dypalësh, për t'ju përshtatur sa më mirë banorëve të cilëve do t'i ofrohet shërbimi. Koha qe i duhet mjetit për të kryer një grumbullim plotësisht derë më derë është 2 orë. Është shumë e rëndësishme që meqenëse ky system i ri i grumbullimit vjen si risi për zonën e plazhit të Velipojës, edhe mbas një fushate ndërgjegjësimi, mjetit teknologjik qe do te realizojë skemën e mbledhjes derë më derë i nevojitet një gramafon për njoftimin e ardhjes të mjetit për marrjen e mbetjeve në rrugët e caktuara nga Bashkia.

Iniciativa e grumbullimit të mbetjeve derë më derë, eshte nje pervoje që do sherbeje per ta shtrire kete menyre sherbimi në gjithë zonën e plazhit në të ardhmen. Kjo skemë shërbimi pasqyron një

kualitet te lartë pasi eliminon PGM-të në zonën turistike, PGM të cilat jo rradhë herë kthehen në hotspote shkaktuar nga mbetjet e hedhura pa kriter ose edhe nga ndërhyrjet e njerëzve ose të kafshëve. Eshte llogaritur qe njësitë të cilave do i ofrohet shërbimi do pajisen me qese plastike 120L, të parashikuara për cdo muaj të parë të nisjes të sezonit. Kjo do të shërbejë edhe si ndërgjegjësim për gjeneruesit e mbetjeve se si duhet të veprojnë me dorëzimin e mbetjeve në orar sipas një rregulli të caktuar. Në përllogaritjen e kostos është llogaritur një fond i vecantë për ndërgjegjësimin dhe stafin e operatorit që do të duhet të ndjekë me rigorozitet këtë proces. Një punonjës monitorues i zonës do të jetë përgjegjës për gjithcka ndodh në terren në këto 110 ditë sezoni turistik. Punonjësi do të duhet të japë kontaktet bashkisë Shkodër dhe administratës të njësisë administrative Velipojë në formën e nje shkrese sipas përcaktive në kontratën dy palëshe.

Tabela 12: Frekuencat e shërbimti në zonën perëndimore

| Frekuenca | 2 Mjete 10 ton | | | | | | 1 turn/ditë/mjet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Premte | E Shtunë | E dielë |
| | Ana Malit | Velipojë | pushim | Ana Malit | Velipojë | pushim | pushim |
| | Bërdicë | Dajç | | Bërdicë | Dajç | | |
| | | | | | | | |

| Përbërja | Infrastruktura | | Të dhënat teknike | |
|---|---|---|---|---|
| | Mjetet | Kontenierë | Norma e gjenerimit | Frekuenca |
| Njësitë e Zonës Perëndimore | | | | |
| Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç | 2 mjete teknologjike 10 ton. | Shtohen 105 (Total 359) | 0.4 kg/banorë/ditë | 2 herë/javë |
| Velipojë Plazh<br>Shërbim me kontenierë | 1 mjet teknologjik 10ton | Shtohen 53 (Total 125) | 0.8 kg/banorë/ditë | 7ditë/javë |
| Velipojë Plazh | 1 mjet teknologjik 5ton | Qese te njesive | 0.8 kg/banorë/ditë | 7ditë/javë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shërbim derë më derë | | | | |

- Grafiku i evadimit të mbetjeve mund të ndryshohet në bazë të nevojave, me miratimin e Autoritetit Kontraktues.

Shërbimi i pastrimit sezonal është zgjeruar në kohë, dhe do kryhet nga data 01 qershor deri me datën 18 shtator me 110 ditë shërbimi. Sic u përmend më lart, për plazhin e Velipojës është përllogaritur të ketë dy zona shërbimi: një zonë shërbimi me mbledhje derë më derë/stop-e (me qese) sipas intinerarit të përcaktuar më poshtë duke përfshirë bizneset, njësitë akomoduese, dhe njësitë e shërbimit për rrugët qëndrore 8, 9, dhe kompleksin Fishta. Kompleksi Fishta përfshin të gjitha njësitë e shërbimit në këtë territor, rrugët 8 dhe 9 po ashtu përfshijnë të gjitha ato njësitë akomoduese dhe bizneset që kanë akses në rrugë. Kjo vendimmarrje është marrë si pasojë e problematikës të hasur gjatë sezonit turistik me zonën qendrore të plazhit të velipojës , ku të gjitha bizneset,njësitë akomoduese të qendrës dhe kompleksi Fishta dorëzonin mbetjet në PGM, në cdo orar të ditës, në pikën kryesore të qendrës pranë lulishtes të Velipojës duke e kthyer atë në një hotspot mbetjesh.

Kjo vendimmarrje vjen nga testimi paraprak i realizimit të dy skenareve të grumbullimit të mbetjeve në sezonin turistik të vitit 2022. Gjatë sezonit turistik të vitit 2022 u testua skema e mbledhjes derë më derë dhe ndërgjegjësimi qytetar dhe të bizneseve për mbledhjen me orar të mbetjeve. Gjatë anketimeve në terren, bizneset dhe qytetarët ishin entuziast për këtë proces duke pasur parasysh reduktimin e ndotjes në qendrën e plazhit dhe uljen e volumit të pikave të grumbullimit në qendër. Me realizimin e këtij procesi risi për Bashkinë Shkodër, reduktohet numri i kontenierëve në plazhin e Velipojës dhe zvogelohet volumi i mbetjeve të pikave në qendër duke i dhënë zgjidhje ndotjes të gjithë zonës dhe , dhe të realizohet në zonën e qendrës mbledhja '"derë më derë".

Në territorin e mbetur do të vazhdoje të realizohet grumbullimi i mbetjeve me anë të kontenierëve sipas një orari të përcaktuar nga Bashkia duke marrë parasysh edhe kërkesat e banorëve, frekuentuesve të plazhit të Velipojës, njësive tregëtare dhe akomoduese.

Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zera te tjere sherbimi sipas preventivit, në shërbim të pastrimit sa më cilësor dhe efiçient.

### I.3. Rrugetimet e mjeteve në Zonën Perëndimore

**Skenaret e levizjes se mjeteve per grumbullimin e mbetjeve urbane në zonën perëndimore**

Zona Perëndimore (Zona 1)

Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Ana Malit - Landfilli Bushat) 70 km




Figure Nr.8: Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Bërdicë - Landfilli Bushat) 40 km


Rrugetimi per grumbullim e mbetjeve
- NJA Berdice -
BASHKIA SHKODER
JANAR 2023
Legjenda
Rrugetimi
Berdice
PGM Berdice
0 1 2 km

Figure Nr.9: Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Dajç - Landfilli Bushat)

1 mjet 10 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill për grumbullimin e mbetjeve (72 km)



Figure Nr.10: Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Velipojë - Landfilli Bushat)

1 mjet 10 ton – rruga e ërshkuar nga parku deri në landfill ër grumbullimin e mbetjeve (85 km)



Figure Nr.11: Përmbledhje e rrugëtimit në Zonën Perëndimore - Njësi Administrative




Përmbledhje e rrugëtimeve I, II, III, IV në Zonën Perëndimore - Njësi Administrative

Figure Nr.12: Zona Perëndimore - Velipojë Plazh.

Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - Velipojë Plazh (me konteniere)- Landfilli Bushat)

1 mjet 10 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill për grumbullimin e mbetjeve (54 km)







Zona Perëndimore - rrugëtimi V (Fshati Gomsiqe – Velipojë Plazh (me konteniere) – landfill Bushat)

Figure Nr.13: Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - Velipojë Plazh (derë-më-derë)- Landfilli Bushat)

2 mjete 5 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill ër grumbullimin e mbetjeve (39 km)




Zona Perëndimore - rrugëtimi VI (Fshati Gomsiqe – Velipojë Plazh (derë-më-derë) – landfill Bushat)

## I.4 Personeli për zonën perëndimore

**a.** Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet.

**b.** Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë. Gjithcka është e përllogaritur në koston e shërbimit .

Personeli i nevojshëm për shërbimin në zonën Perëndimore

Tabela Nr. 15: Kerkesa per puntori në zonën perëndimore

| Nr | Specialiteti | Njesi | Sasi |
|---|---|---|---|
| A | Puntore efektiv per gjithe vitin (zona 1) | persona | 13 |
| 1 | Shofere | persona | 2 |
| 2 | Puntor per mjetin teknologjik | persona | 4 |
| 3 | Drejtues teknik i kontratës | persona | 1 |
| 4 | Specialist , monitorues terreni | Persona | 1 |
| 5 | Punëtorë të përfshirë në pastrimin e plazhit/rërës (para hapjes të sezonit turistik dhe mbas përfundimit të sezonit) | Persona | 5 |
| B | Puntorë sezonal (110 ditë të sezonit turistik) | Persona | 18 |
| 1 | Specialist , monitorues terreni | Persona | 1 |
| 2 | Shofere | Persona | 2 |
| 3 | Puntor makine per grumbullim mbeturina sezonal | persona | 4 |
| 4 | Puntore per fshirje | persona | 2 |
| 5 | Puntore per mirembajtje ne zonen e reres (plazh Velipojë & Baks Rrjoll). | persona | 4 |
| 6 | Punëtorë për mirmbajtjen e PGM've | persona | 5 |

### I.5 Shërbime të tjera me mjete dhe puntori

Autoriteti kontraktor ka parashikuar për fshirjen manuale të rrugëve kryesore në qendër të plazhit përcaktuar në hartën si më poshte. Kjo përfshin Rrugën 9, rrugën përbri komplekstit fishta dhe rrugën përreth lulishtes kryesore.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjithë sipërfaqen e parashikuar në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 5200 m2/ditë. Këto janë parashikuar në grafikun e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes. Meqenëse norma për punëtor është 8000 m2 këtu përcaktohet një punëtor për zonën qendër Velipojë dhe një punëtor për fshirjen dhe mirëmbajtjen pastër të pedonales të plazhit.

Shërbimi i fshirjes së rrugëve do të aplikohet vetëm ne Velipojë, në zonën e plazhit në rrugët e paraqitura në skicën e mëposhtme (përfshihen rrugën hyrëse drejt qendrës nga të dyja korsitë me nga 1.5 metër nga kunetat, rrugët e përbri lulishtes kryesore të qëndrës si dhe rruga dytsore përgajtë qendrës.

Fshirja manuale e ketyre rrugëve nënkupton, largimin e mbeturinave, gjetheve si dhe të baltës dhe pluhurave. Të gjitha materialet e mbledhura duhet të depozitohen në pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave dhe jo të depozitohen në ndonjë vend tjeter. Kompania duhet të sigurojë që kjo rrymë mbetjesh nuk përfundon në kunetat dhe kanalet e ujrave të shiut.Punëorëve i është parashikuar në përllogaritjen e kostos pajisja me mjete pune. Zbatimi, do të monitorohen nga AK në cdo kohë.

Fshirja e rrugëve do të bëhet një herë në ditë në mëngjez nga ora 05.00-07.00. Frekuenca e fshirjes do të jetë një here në ditë herët në mëngjes dhe do të kryhet nga dy punëtorë sezonal me fshesë cdo ditë të javës nga e hëna deri të djelën. Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi dhe me uniforme, , në të kundërt, kontraktuesi penalizohet nga AK.

Figure 17 Rrugët që do të fshihen në NjA Velipojë



## 6.1. II. ZONA FUNKSIONALE LINDORE

Zona funksionale lindore ka të përfshirë njësitë administrative Rrethina, Gur i Zi, Postribe, dhe Shalë, zona turistike e Thethit.

- Operatori sipërmarrës duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonen Lindore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit;
- Eshtë parashikuar që në zonen Lindore cdo ditë prodhohen për Njësitë administrative Rrethina, Gur i Zi, Postribe, mesatarisht 14.5 ton mbetje/dite, ndërsa për fshatrat turistike te nja Shalë, gjatë periudhës Prill-Nentor mesatarisht 1,4 ton mbetje në ditë;

Në zonën Lindore marrin shërbimin e pastrimit NJA Rrethina, Postribe, Guri Zi, dhe fshatrat turistike të Thethit në NjA Shalë. NJA Rrethina, Postribe, Guri Zi kanë një popullsi rezidente prej 36,206 banorë (sipas të dhënave nga formula e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë). Zona ka karakter rural. Fshatrat turistike të Nj.a Shalë kanë mesatarisht 1,800 turiste/ ditë gjatë periudhë së shërbimit. Kjo zonë përcaktohet me karakter urban përsa i përket gjenerimit të mbetjeve gjatë muajve të shërbimit si zonë me destinacion turizmin. Në total në zonën rurale parashikohet të gjenerohen mesatarisht 14.5 ton/ditë mbetje të ngurta urbane, ose 5286 ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë vitit, ndërsa për nj.a Shalë, parashikohet mesatarisht një normë gjenerimi prej 1,4 ton /dita gjatë periudhës Prill- Nëntor, dhe 259 ton në total gjatë gjithë vitit. Mbetjet urbane duhet të grumbullohen dhe më pas transportohen në landfillin e Bushatit.

Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në terren nga 220 kontenierë metalikë me kapacitet 1,100 litra (1.1m$^3$) të shtrirë në njësitë administrative, dhe 57 kontenierë në fshatrat turistike të nj.a Shalë. Këto kontenierë janë pronë e bashkisë. Me kontratën e re, merren në dorëzim për administrim dhe mirëmbajtje nga operatori i ofrimit të shërbimit të pastrimit, nën vëmendje nga administrata e njësive administrative monitorues të shërbimeve dhe administrator, bazuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë për zbatimin e Procedurës standarte të veprimit (rregullore e brëndshme e administratës).

Sipas planit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga 100-500m larg, kjo për të ofruar një shërbim sa më cilësor, duke shkuar sa më afër banorëve, në zona te dendura apo të thella.

Grumbullimi i mbetjeve në njësitë administrative do bëhet sipas intinerarit të përshkuar më poshtë, që synon një proces sa më efikas dhe cilësor. Distanca e përshkuar nga një mjet 10 ton vetëm për grumbullimin e mbetjeve në PGM në njësitë administrative përgjatë një rrugetimi është: 37 km në NjA Gur I Zi, 42 km në NjA Postribe & Bardhaj, ndërsa NjA Rrethina shërbimi realizohet me dy rrugetime, me distance grumbullimi 26 km dhe 31 km. Për fshatrat turistike të nj.a Shalë, distanca e përshkuar për grumbullimin e mbetjeve ne PGM është 26 km.

### II.1. Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve

Shërbimi i grumbullimit (me kontenierë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- Zbrazjen e konteniereve me makinën e përshtatshme teknologjike të percaktuar;
- Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier;
- Pastrim të sipërfaqes prej 30 $m^2$ rreth çdo pike grumbullimi;
- Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike per mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur;
- Dezinfektimin e zonës së kazanëve (PGM), sipas normativave;
- Transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre, lendfillin e Bushatit;

Për mosrealizimin e kritereve përcaktuar në specifikimet teknike, përcaktohen penalitetet nga ana AK për punë të pa kryer nga operatori sipërmarrës.

### II.2. Skema e grumbullimit

Në zonën Lindore shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet sipas grafikëve të përcaktuar. Oraret e grumbullimit do të jenë ditën nga ora 06.00 deri në orën 12.00, dhe mund të ndryshohen me kërkesë dhe me miratim dypalësh, për t'ju përshtatur sa më mirë banorëve të cilëve do t'i ofrohet shërbimi.

- Për zonën lindore me karakter rural, parashikohen të përdoren 2 mjete teknologjike 10ton të cilët do të ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zonë gjatë gjithë vitit.
- 1 mjet teknologjik 10ton ofron shërbimin vetëm në NJA Rrethina deri në Landfillin e Bushatit. Rruga Nacionale do të marrë shërbimin cdo ditë të javës, dhe mjeti gjithashtu do bëjë grumbullimin dhe transportin të mbetjeve në zonat e tjera brenda NjA sipas planit : 4 herë/javë zonat Shtoj, Grude, Golem, Dobrac, dhe 3 herë/javë zonat Hot dhe Guci.
- 1 mjet tjetër teknologjik 10 ton ofron shërbimin në NJA Postribë & Bardhaj – NJA Guri i Zi deri në Landfillin e Bushatit. Mjeti do bëjë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në këto zona sipas planit : 3 herë/javë zona Gur i Zi, dhe 3 herë/javë zona Postribë & Bardhaj.

Dy mjetet teknologjike 10 ton do të ofrojnë shërbimin në dy Njësi Administrative njëkohësisht, respektivisht, njëri mjet do bëjë rrugëtimin në NjA Rrethina, dhe mjeti tjetër do bëjë udhëtimin në NjA Gur i Zi ose NjA Postribe, sipas grafikut.

Për zonën lindore, fshatrat turistike të nj.a Shalë, parashikohet të përdoret 1 mjet teknologjik 7 ton i cili do të ofrojë shërbimin vetëm në zonën Theth,Okol,Ndërlysaj, deri në Landfillin e Bushatit, gjithsej 48 herë gjatë gjithë vitit. Këto frekuenca do shperndahen me grafik të miratuar nga AK.

- Në periudhën e verës, shërbimi do realizohet me 2 rugëtime/javë, në periudhen pranverë-vjeshtë do bëhet 1 rugëtim/javë, ndërsa në periudhën e dimrit do ofrohet shërbim vetëm nëse e lejojnë kushtet infrastrukturës dhe motit. Mjeti teknologjik 7 ton që do përdoret për fshatrat turistike të nj.a Shalë, në ditët kur nuk ofrohet shërbimi në to, do shërbejë si mjet rezërvë për nevojat e shërbimit të pastrimit në zonën Lindore.

Tabela 13: Frekuencat e shërbimti në zonën lindore

| Përbërja | Infrastruktura | | Të dhënat teknike | |
|---|---|---|---|---|
| | Mjetet | PGM | Norma e gjenerimit | Frekuenca |
| Njësitë e Zonës Lindore | | | | |
| NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re | Mjeti teknologjik nr.1- 10 ton | Total 57 | 0.4 kg/banorë/ditë | 3 herë/javë |
| NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac | Mjeti teknologjik nr.1- 10 ton | Total 51 | 0.4 kg/banorë/ditë | 4 herë/javë |
| NjA Gur i Zi | Mjeti teknologjik nr.2- 10 ton | Total 44 | 0.4 kg/banorë/ditë | 3 herë/javë |
| NjA Postribe + Bardhaj | Mjeti teknologjik nr.2- 10 ton | Total 46 | 0.4 kg/banorë/ditë | 3 herë/javë |
| fshatrat turistike të nj.a Shalë | Mjeti teknologjik nr.3- 7ton | Total 23 | 0.8 kg/banorë/ditë | 1-2 herë/javë sipas grafikut<br>48 herë/vit |

Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

| Frekuenca | 2 Mjete 10 ton + 1 mjet 7 ton | | | | | | 1 turn/ditë/mjet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zona Lindore | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Premte | E Shtunë | E dielë |
| | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Hot – Hot i Ri – Guci – Guci e Re | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac | NjA Rrethina – Rr. Nacionale – Shtoj – Shtoj i Ri – Grude – Golem - Dobrac |
| | NjA Gur i Zi | NjA Postribe + Bardhaj | NjA Gur i Zi | NjA Postribe + Bardhaj | NjA Gur i Zi | NjA Postribe + Bardhaj | Ura e Mesit |
| | fshatrat turistike të nj.a Shalë | | | | fshatrat turistike të nj.a Shalë | | |

Për shërbimin në tre zonat funksionale,monitorimi nga ana e Bashkisë do të realizohet me anë të administratës të njësive administrative përkatëse me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, me detyrat përcaktuar në PSV e administrimit të shërbimit të pastrimit.

Në rast moszbatimi të frekuencave parashikohen penalitete, dhe shuma i mbahet situacionit të muajit respektiv. Do të vazhdohet të kërkohet nga Bashkia Shkodër grumbullimi i rrymave të mbeturinave (të riciklueshme) për tu realizuar në bashkëpunim me bizneset e zonës me një marrëveshje të drejtë për drejtë tri palëshe.

### II.3. Rrugëtimet e mjeteve në Zonën Lindore

Figure Nr.14: Zona Lindore (Varrezat Katolike – NJA Rrethina (4x/javë) - Landfilli Bushati)

1 mjet 10 ton - gjatësia e rrugës 48km




Figure Nr.15: Zona Lindore (Varrezat Katolike -- NJA Rrethina (3x/javë) - Landfilli Bushati)

1 mjet 10 ton - gjatësia e rrugës 53km


Rrugetim per Grumbullimin e Mbetjeve
- NjA Rrethina II -
BASHKIA SHKODER
Korrik 2023
PGM_Rrethina_2023
Rrugetime_2023
Rrethina_3x
0 1 2 km

Figure Nr.16: Zona Lindore (Varrezat Katolike – NJA Gur i Zi - Landfilli Bushati)

1 mjet 10 ton - gjatësia e rrugës 54km



Figure Nr.17: Zona Lindore (Varrezat Katolike – Bardhaj - NJA Postribe - Landfilli Bushati)

1 mjet 10 ton - gjatësia e rrugës 70km



Figure Nr.18: Zona Lindore (Varrezat Katolike – Theth - Landfilli Bushati)

1 mjet 7 ton – gjatësia e rrugës 200 km



### II.4 Personeli i nevojshëm për shërbimin në zonën Lindore

Tabela Nr. 16: Kerkesa per puntori në zonën lindore

| Nr | Specialiteti | Njesi | Sasi |
|---|---|---|---|
| A | Punëtorë efektiv për gjithë vitin | | |
| 1 | Shofere mjeti teknologjik | persona | 3 |
| 2 | Puntorë makine per grumbullim mbeturinash | persona | 6 |
| 3 | Drejtor teknik per kontraten | persona | 1 |
| 4 | Specialist , monitorues terreni | persona | 1 |
| B | Punëtor sezonal (8 muaj) | | |
| 1 | Punëtorë për mirmbajtjen e PGM've në Theth (+1 rezervë) | persona | 2 |
| | Shuma | | 13 |

## 6.1. III. ZONA FUNKSIONALE QENDRORE (PROPOZIM)

Zona Qëndrore përfshin shërbimin në 5 lagjet e qytetit të Shkodrës.

Operatori sipërmarrës duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në bashkinë Shkodër, Zona Qëndrore;

Eshtë parashikuar që në zonen Qëndrore cdo ditë të gjenerohen rreth 72 ton mbetje, ose rreth 26 mijë Ton/mbetje urbane në vit;

### III.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve

Shërbimi i grumbullimit (me kontenierë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- Zbrazjen e kontenierеve me makinën e përshtatshme teknologjike të percaktuar;
- Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier;
- Pastrim të sipërfaqes prej 30 $m^2$ rreth çdo pike grumbullimi;
- Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike per mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur;
- Dezinfektimin e zonës së kazanëve (PGM), sipas normativave;
- Transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre, lendfillin e Bushatit;

Shërbimi i grumbullimit (derë- më-derë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- Mbledhjen e qeseve derë-më-derë me makinën e përshtatshme të percaktuar, mjet kamioncine vetshkarkuese.
- Transportin e mbeturinave në mjet te madh teknologjik, dhe me pas depozitimin ne lendfillin e Bushatit.

Për mosrealizimin e kritereve përcaktuar në specifikimet teknike, përcaktohen penalitetet nga ana AK për punë të pa kryer nga operatori sipërmarrës.

### III.2 Skema e grumbullimit

Në zonën qendrore bën pjesë vetëm NJA Shkodër. Kjo zonë ka një popullsi rezidente prej 88,930 banorë (sipas të dhënave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë). Zona ka karakter urban.

Në total në zone gjenerohen rreth 72 ton/ditë mbetje të ngurta urbane, ose 25,968 ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë vitit, të cilat duhet të grumbullohen dhe transportohen në landfillin e Bushatit çdo ditë të javës. Kjo sasi mbetjesh do të mblidhet në frekuencat e përcaktuara dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktues, nga 830 kontenierë në ditë me kapacitet 1,100 litra (1.1m3).

Gjatësia mesatare e rrugës qe pershkon mjeti për grumbullimin e mbetjeve në territorin e qytetit të Shkodrës është rreth 13 km, e realizuar per rreth 5 ore. Ne total, mjetet gjate frekuences se nates, pershkojne rreth 85 km per te evaduar rreth 625 konteniere. Gjate frekuences se dites, mjetet pershkojne rreth 13 km per te evaduar rreth 205 konteniere. Rrugetimi mesatar qe realizon nje mjet per gjithe itinerarin nga Parku-Grumbullim-Depozitim kryhet per 5h 40'. Sipas planit të përcaktuar për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga 50-100m larg.

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

(i) **Mbledhja dhe Grumbullimi i mbetjeve me konteniere 1,100 L**

Në zonën Qendër shërbimi kryesor i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet cdo dite. Oraret e grumbullimit do të jenë kryesisht natën, nga ora 20:00 deri në orën 06:00. Sa më poshtë shpjegohen frekuencat e tjera për tu zbatuar nga Kontraktuesi në zbatim të grafikut të miratuar nga AK.

Volumi ditor i gjeneruar i mbetjeve ka nevojën e një numri të konsideruar kontenierësh rreth 830 për tu evaduar në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër zona qëndrore gjatë frekuencave të përcaktuar nga AK, pa përfshirë këtu zonën ku mbetjet mblidhen derë më derë. Bashkia Shkodër ka të miratuar një rregullore e cila mes të tjerave disiplinon edhe dorëzimin e mbetjeve në pikat e grumbullimit me orare të ndryshme për familjarë dhe biznese me qëllim eleminimin e ngarkesave të pa nevojshme të pikave të grumbullimit. Ngarkesë kjo që bën të duket e ndotur dhe e pa pastruar PGM'në. Me qëllim mbajtjen e pikave dhe hapësirave publike të pastra nga mbetjet urbane, evadimi i mbetjeve do të realizohet me frekuenca të ndara me fasha kohore në sinkron me dorëzimin e mbetjeve nga prodhuesi i mbetjeve. Frekuenca e natës do të jetë nga ora 20:00 deri në 06:00 të mëngjesit, frekuenca e paradites vetëm në akset kryesore të qytetit në ora 11:00 duke vazhduar më tej me zonat tregëtare në orët e mbasdites mbas orës 17:00. Është përllogaritur që i gjithë volumi i prodhuar ditor evadohet në këto frekuenca me një numër total kontenierësh 830 copë. Grafiku i evadimit të mbetjeve do të hartohet dhe miratohet nga Autoriteti Kontraktor për tu zbatuar nga ana e Operatorit sipërmarrës.

(ii) **Mbledhja dhe Grumbullimi i mbetjeve dere-me-dere**

Ne vijim te praktikave te sukseshme te realizuara nga Bashkia Shkoder per mbledhjen e mbetjeve dere-me-dere ne zonat qendrore/turistike ne zonen Qytet dhe zonen Perendimore (Velipoje-Plazh), kjo metode sherbimi do vazhdoje te perdoret ne zonat me fluks turistesh ne qytetin e Shkodres.

- Ne zonen qendrore te qytetit, ate me te dendur me numer me te larte turistesh dhe vizitoresh, sherbimi i mbledhjes se mbetjeve do realizohet dere-me-dere me kamioncine vetshkarkuese 3-5 ton, 1 here ne dite, per 365 dite ne vit.

- Mbledhja e mbetjeve do realizohet me kamioncinen e drejtuar nga 1 (nje) shofer dhe asistuar nga 2 (dy) punetore, te cilet do marrin qeset e cdo biznesi/familje qe ka akses ne zonen e caktuar. Eshte parashikuar qe mjeti kamioncin te jete ne levizje per 6 ore, duke ecur perpara me nje shpejtesi jo me te shume se 2km/h.

Figure Nr.18: Zonifikimi i skemës të mbledhjes së mbetjeve derë më derë



- Te gjithe bizneset dhe familjaret te cilet perfitojne nga ky sherbim jane te instruktuar nga Bashkia Shkoder per te lene qeset e lidhura mire para hyrjes se biznesit/shtepise. Keto qese do merren nga dy punetoret e sherbimit dhe hidhen ne kamioncine, pa ndalesa. Sherbimi i mbledhjes dere-me-dere do realizohet gjate oreve 10:00-18:00, duke variuar sipas stines. Pasi te jete kryer cikli i mbledhjes dere-me dere, kamioncini transporton sasine e grumbulluar deri ne nje pike periferike te qytetit, ku kjo sasi transferohet me vete-shkarkim ne mjetin teknologjik te pastrimit dhe behet transportimi per ne destinacionin final, Landfillin e Bushatit. Bizneset dhe banoret sigurojne vete qeset te cilat perdoren per mbledhjen e mbetjeve.

- Kjo menyre e mbledhjes se mbetjeve i sherben Bashkise Shkoder, si pikenisje per te nisur ne nje moment te dyte (me krijimin e qendres se multigrumbullimit, me ndarjen/mbledhjen ne burim te mbetjeve te ricikllueshme. Mbledhja e mbetjeve me qese dere-me-dere pasqyron nje performance te larte te menaxhimit te mbetjeve pasi reduktohen PGM-te e ndotura ne zonat qendrore dhe turistike te qytetit.

- Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë, minimalisht numrin e kërkuar të mjeteve dhe punetoreve.

- N.q.s gjatë mbledhjes apo transportit derdhen papastërti nga makinat e sherbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballet me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

MJETET DHE PAJISJET

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo me i vjeter se viti 2008 , 4 (katër) copë;

| Lloji i mjetit | Mjet teknologjik transportues (kompaktor) |
|---|---|
| Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit) | 10-11ton  |
| Raporti i Kompaktimit | 1:4 – 1:6 |
| Kapja e mjetit në pjesën fundore | Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m³)  |

| | |
|---|---|
| Rrotat e mjetit | Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore malore dhe të mbuluara me borë |
| Viti i Prodhimit | Jo më poshtë se viti 2008 |
| Nëse mjeti është i përdorur | Të këtë bërë jo më shumë se 150,000 km |
| Marshi | Manual |

Mjetet teknologjike duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. **Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete"**, i ndryshuar, sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

- Makinë vetshkarkues me , me kapacitet mbajtës 3-5 ton, për mbledhjen e mbetjeve nëpër pedonale derë më derë, viti i prodhimit jo me i vjeter se viti 2008 , **1 (një) cope.**



Mjeti vetshkarkues 3-5 ton, është kerkuar per grumbullimin e mbeturinave në zonën e pedonaleve sipas grumbullimit derë më derë. Këto janë zona me destinacion turizmin gjenerimi i mbetjeve shkon mesatarisht 3.1 ton sipas fluksit. **Sipas modelit " Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve " miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, nevojitet 1 mjet me kapacitet 3-5 ton ( 85% faktor mbushje)** qe do punoje për rreth 6 orë, per te realizuar plotesisht sherbimin.Ne llogaritjen e kostove operative ( per mjetet ) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre. ( siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirembajtje mekanike, parking dhe kosto e amortizimit).

| Nr | Emertimi I mjetit | Kapaciteti | Sasi (cope) |
|---|---|---|---|
| 1 | Mjete teknologjike pastrimi | 10-11 ton | 4 |
| 2 | Mjete vetshkarkues | 3-5 ton | 1 |
| 3 | Mjete teknologjike pastrimi rezerve | 10-11 ton | 1 |

### III.3. Rrugëtimet e mjeteve në Zonën Qendrore

FREKUENCA I – GRUMBULLIMI I MBETJEVE NE DARKE ME 6 RRUGETIME




Figure Nr.21: Frekuenca I - Rrugetimi 1 ( 26 km per grumbullim)

Figure Nr.22: Frekuenca I - Rrugetimi 2 ( 14 km per grumbullim)




Figure Nr.23: Frekuenca I - Rrugetimi 3 ( 15 km per grumbullim)




Figure Nr.24: Frekuenca I - Rrugetimi 4 ( 10 km per grumbullim)




Figure Nr.25: Frekuenca I - Rrugetimi 5 ( 11 km per grumbullim)



Figure Nr.26: Frekuenca I - Rrugetimi 6 ( 9 km per grumbullim)



## FREKUENCA II – GRUMBULLIMI I MBETJEVE GJATE DITES ME 2 RRUGETIME

Figure Nr.28: Frekuenca II - Rrugetimi 7 & 8 ( 11 km & 8 km per grumbullim)



Tabela Nr.20 : përmbledhëse për rrugëtimet me mjet teknologjik në Zonën Qëndrore

| ZONA QENDRORE | | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Premte | E Shtunë | E Dielë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Frekuenca I** | **Rrugëtimi 1** | | | | | | | |
| *Nisja* | **Park Shkoder** | | | | | | | |
| *Pika fundore* | **Landfill Bushatit** | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | **42 KM** | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | **6h 45'** | | | | | | | |
| *Mjeti - I* | **1 mjet 10ton** | | | | | | | |
| **Frekuenca I** | **Rrugëtimi 2** | | | | | | | |
| *Nisja* | **Park Shkoder** | | | | | | | |
| *Pika fundore* | **Landfill Bushatit** | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | **31 KM** | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | **6h 21'** | | | | | | | |
| *Mjeti-II* | **1 mjet 10ton** | | | | | | | |
| **Frekuenca I** | **Rrugëtimi 3** | | | | | | | |
| *Nisja* | **Park Shkoder** | | | | | | | |
| *Pika fundore* | **Landfill Bushatit** | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | **31 km** | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | **6h 41'** | | | | | | | |
| *Mjeti - III* | **1 mjet 10ton** | | | | | | | |
| **Frekuenca I** | **Rrugëtimi 4** | | | | | | | |
| *Nisja* | **Park Shkoder** | | | | | | | |
| *Pika fundore* | **Landfill Bushatit** | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | **26 KM** | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | **5h 03'** | | | | | | | |
| *Mjeti-IV* | **1 mjet 10ton** | | | | | | | |
| **Frekuenca I** | **Rrugëtimi 5** | | | | | | | |
| *Nisja* | **Park Shkoder** | | | | | | | |
| *Pika fundore* | **Landfill Bushatit** | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | **27 KM** | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | **5h 00'** | | | | | | | |
| *Mjeti-Iv* | **1 mjet 10ton** | | | | | | | |
| **Frekuenca I** | **Rrugëtimi 6** | | | | | | | |
| *Nisja* | **Park Shkoder** | | | | | | | |
| *Pika fundore* | **Landfill Bushatit** | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | **25** | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | **4h 39'** | | | | | | | |
| *Mjeti-Ii* | **1 mjet 10ton** | | | | | | | |

| ZONA QENDRORE | | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Premte | E Shtunë | E Dielë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Frekuenca II | Rrugëtimi 7 | | | | | | | |
| *Nisja* | Park Shkoder | | | | | | | |
| *Pika fundore* | Landfill Bushatit | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | 27 KM | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | 5h 54' | | | | | | | |
| *Mjeti - III* | 1 mjet 10ton | | | | | | | |
| Frekuenca II | Rrugëtimi 8 | | | | | | | |
| *Nisja* | Park Shkoder | | | | | | | |
| *Pika fundore* | Landfill Bushatit | | | | | | | |
| *Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)* | 24 KM | | | | | | | |
| *Kohëzgjatja* | 4h 49' | | | | | | | |
| *Mjeti-I* | 1 mjet 10ton | | | | | | | |

## III.4. Personeli i nevojshwem pwr zonwn Qendrore

Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është 1 (një) shofer dhe 3 (tre) puntorë për çdo makinë teknologjike që grumbullon dhe transporton mbetjet. Per mjetin vetshkarkues personeli i nevojshem eshte 1 (nje) shofer dhe 2 (dy) punetore.

Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë. Nuk lejohet për asnje lloj arsye që punonjesit të mos kene të veshur uniformën e përcaktuar, në të kundërt ,penalizohet.

Tabela Nr.20 : Kerkesa per puntori

| Nr | Specialiteti | Njesi | Sasi |
|---|---|---|---|
| 1 | Shofere per grumbullim mbeturina | persona | 8 |
| 2 | Puntor makine per grumbullim mbeturina | persona | 24 |
| 3 | Puntor per fshirje manuale | persona | 20 |
| 4 | Puntor per mirembajtje te rrugeve kryesore, koshave te vegjel, dhe mirmbajtjen e PGM've | persona | 20 |
| 5 | Shofer autoboti per larjen e pedonaleve /kontenierreve | persona | 1 |
| 6 | Punetor autoboti per larjen e pedonaleve/kontenierreve | persona | 2 |
| 7 | Shofer autofshese | persona | 1 |
| 8 | Drejtor teknik per kontraten | persona | 1 |
| 9 | Personi i zyres se kontaktit | Persona | 1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 10 | Monitorues terreni | Persona | 2 |
| 11 | Shuma | | 80 |

## III.5 Shërbime të tjera me mjete dhe puntori

- **Fshirja manuale e rrugeve**

Autoriteti kontraktor ka parashikuar për fshirjen manuale sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar, sipas hartës së rrugëve dhe grafikëve të miratuar nga autoriteti kontraktor. Llogaritja e kostos të këtij shërbimi është realizoaur sipas Analizës An-2.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët sheshet dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 160,000 m2/dite,volum pune që do të realizohet nga 20 fshesatarë me normativë 8000m2/ditë/për fshesar, për ditët normale të punës dhe 7 (shtatë) fshesar për zëvëndësim në ditë festash, fundjavë dhe pushimesh. Frekuencat e fshirjes janë parashikuar në grafikun e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën qendër, miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

a.Fshirjen me punëtorë me fshesë të rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të kategorive I, II, si edhe trotuarëve duke mbuluar sipërfaqet dhe gjatësisë lineare sipas garfikut përcaktuar me frekuencat dhe sipërfaqet të miratuara nga Autoriteti Kontraktor .
b. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknollogjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.
c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknollogjike.
d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga proçesi teknollogjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në proçesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.
e.Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.
f. Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen rrugët dhe trotuaret e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, me kalldrëm si dhe trotuaret e qytetit).
Plani i punës dhe grafikët e punimeve
a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-05.00.
b. Për pastrimin e rrugëve Autoriteti kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njërës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve per realizimin e shërbimit të pastrimit te zones, pergatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

Rregulla për t'u zbatuar:

- Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.
- Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.
- Për raste të veçanta Kontraktori është i detyruar të fshijë rrugët me shumë se një herë pa shpenzime.
- Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit,ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie, Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.
- Kontraktori duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimet Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:
- Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
- Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme.

Mjetet dhe pajisjet

Kontraktori duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- Për nevoja të vecanta për punëtorët do të vihen në dispozicion edhe 5 ( fshesa me fryrje/ vakum) foto1, për mbetjet dhe gjethet në rrugë dhe trotuarë.
- Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë.
- Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme.

Foto 1 (Fshesë me vakum)



- **Shërbimi i pastrimit të rrugëve me makineri teknologjike**

Autoriteti kontrator ka parashikuar paraprakisht fshirjen mekanike të sheshet dhe rrugëve në gjatësitë lineare në zonën e kontraktuar, sipas grafikeve perkates me frekuencat e percaktuara. Fshirja mekanike eshte ideuar si fillim per t'i sherbyer zonave te qytetit me pista ciklistike. Per kete arsye, mjeti i cili do perdoret per fshirjen mekanike duhet te jete i vogel, dhe me gjeresi jo me te madhe se 1.6 m. Gjithashtu, fshirja mekanike do realizohet ne te gjitha rruget e qytetit, ku makinat nuk parkojne ne ane te rruges, duke lejuar keshtu fshirjen e gjatesise se kunetave. Përllogaritja e kostos është realizuar sipas analizës An-1.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet, sipas nje grafiku javor, me një sipërfaqe prej 45,000 m2/dite, ose rreth 30 km vije sherbimi, për 365 ditë të vitit. Këto do të përcaktohen në grafikun e listën së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për zonën Qender.

Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

Fshirjen me makine teknollogjike fshesë, me gjeresi jo me shume se 1.6 m, të pistave te bicikletave, rrugëve, dhe sheshevе te percaktuara, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë sipas grafikut të percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.




Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 22.00-04.00.

b. Fshirja me makineri teknologjike fshirje do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktor, me qëllim që në orën 06:00 zona të jetë krejtësisht e pastër.

c. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

f. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike per fshirje, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

Rregulla për t'u zbatuar:

- Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë apo trotuare të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji. Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 2 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.
- Nuk lejohet fshirja e rrugës me makineri teknollogjike, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 6 km /orë.

- Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.
- Për raste të veçanta Kontraktuesi është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

Kontraktuesi duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 6-8 $m^3$, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës jo më pak se **1 (një) copë;**
- Makina teknologjike për fshirjen e trotuareve dhe pedonales, me kapacitet mbajtës 0,25 $m^3$, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) me gjerësi jo më pak se 85 cm, jo më pak se **1 (një) copë;**
- Makineritë teknollogjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes.

Të gjitha automjetet, të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontrator për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të intinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.

- **Larje e pedonaleve me solucion dhe me presion**

Shërbimi i larjes me presion, me autobot uji konsiston në:

- Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim per zonat e shtruara me kalldrem, 24 here gjate vitit, mesatarisht 2 here/muaj ose sipas shperndarjes se frekuencave te udhezuar nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht pedonalet dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion dhe solucion. Sherbimi do realizohet gjate nates, nga ora 00:00 deri ne 07:00 të mëngjesit sipas grafikut te percaktuar .

- Pedonale "13 Dhjetori" me sheshet dhe rrugicat qe kane te njejten tipologji,
- Pedonale "Kole Idromeno" me sheshet dhe rrugicat qe kane te njejten tipologji,
- Rruga "Gjuhadol" me sheshet dhe rrugicat qe kane te njejten tipologji,
- Rruga "Gjylbegaj",
- Rruga "Oso Kuka",
- Shetitorja Molos,
- Sheshi Shirokes.
- Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion dhe solucion (minimalisht 3ml/1L uje) të ketyre rrugeve e sheshеve me makinë teknollogjike, si shërbim 24 here ne vit. Sipërfaqja e përgjithshme e cila mund te realizohet per 1 cikel eshte **26,000** m2 . Larja e rrugëve, duhet te kryhet gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) se tyre.

Figure Nr.20 : harta e rrugëve që lahen me presion dhe solucion




- Gjate larjes, mjeti do shoqerohet dhe nga (2) dy punetore te pajisur me fshesa per te ndihmuar ne procesin e larjes me solucion.
- Grafikët e punimeve per realizimin e sherbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Autoriteti Kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në oren/diten e operimit shërbimit, sa herë lind e nevojshme, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë informuar Autoriteti kontraktor per këto ndryshime.
- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

## 6.2. MJETET DHE PAJISJET NË SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TW MBETJEVE

Në shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Shkodër për tre zonat funksionale të shërbimti të pastrimit, përfshihen mjete teknologjike transportuese me të dhënat sa më poshtë:

- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 9-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo me I vjeter se viti 2008 , 2 (dy) copë;

Mjetet teknologjike duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", i ndryshuar, sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 6-8ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, viti i prodhimit jo me i vjeter se viti 2008 ,

Mjeti teknologjik 6-8 ton, duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", i ndryshuar. sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

Ne llogaritjen e kostove operative ( per mjetet ) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre. ( siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirembajtje mekanike, parking) dhe kosto e amortizimit;

- Makinë vetshkarkuese, me kapacitet mbajtës 3-5 ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2008, 1 (nje) copë;

Per te realizuar sherbimin e fshirjes mekanike, larjes se pedonaleve dhe larjes se kontenierevе jane parashikuar te perdoren keto mjete:

| Nr | Emertimi I mjetit | Kapaciteti |
|---|---|---|
| 1 | Makine autofshese | 4-6 m3 |
| 2 | Mjet Autobot per larje me presion dhe solucion | 6-8 m3 |

Foto 3: MJET AUTOBOT 6-8 M³



Foto nr.4: (autofshesë)



Mjetet që do përdoren për shërbimin e fshirjes/larjes duhet të jenë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

### 6.2.1. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre;

Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve;

Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezifektohen çdo ditë pas përfundimit të punës;

Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor,numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet te prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat;

Autoriteti Kontraktor në plan ka parashikuar një grafik të lëvizjes së mjeteve, por Kontraktuesi duhet të mundësojë një hartë të rrugës më eficente që duhet të ndjek mjeti për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe kalendarin përkatës;

Kontraktuesi do të realizojë instalimin e sistemit të GPS në të gjitha mjetet teknologjike e jo teknologjike. Autoritet kontraktor do lidhet me këtë system nga kontraktuesi. Kontraktuesi do mundësojë nëpermjet serverit qëndror të sistemit GPS realizimin e sistemit të monitorimit nga Autoriteti Kontraktor. Kjo do të mundësojë një monitorim të hollësishëm të lëvizjes të të gjitha

mjeteve, që Autoriteti Kontraktor mund ta perdorë për qëllime të ndryshme(kontroll nga njësia e monitorimit) . Autoriteti Kontraktor do të monitorojë të gjitha lëvizjet e mjeteve teknologjike në zonat përkatëse dhe do të ketë mundësi kontrolli më të mirë në lidhje me rrugën e mjeteve, ndalesave të tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazjen e kontenierëve dhe

kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sistemi i GPS nuk duhet të shkëputet nga lidhja me Autoritetin Kontraktor për asnjë moment, si dhe nuk duhet të shkëputet nga lidhja me mjetin. Nëqoftëse rezulton sistemi i fikur tek Autoriteti Kontraktor ,apo dhe tek mjetet, kontraktuesi do penalizohet.

**Kushtet teknike për mjetet e transportit.**

Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave. Duhet të të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në NjA;

Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e nje cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash. Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrenë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.

Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë. Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10-11 dhe 5-6 ton)

Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situate nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjenik të mbetjeve.

Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenierëve të mbledhur.

Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasitë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.

Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

Me nënshkrin e Kontratës, respektimi i kritereve të specifikimeve teknike për mjetet teknologjike që vihen në dispozicion të shërbimit të pastrimit në zonën perëndimore realizohet nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

## 6.3. PROCESE TË TJERA PUNË NË FUNKSION TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT

### 6.3.1. Dezifektimi i PGM

Duhet të bëhet dezifektimi i zonës përreth kontenierëve, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

Frekuenca e dezinfektimit është një herë në javë për periudhën 110 ditë ( cdo ditë premte në zonën e plazhit), ndërsa njësitë administrative një herë në dy javë për sezonin e verës dhe një herë në muaj për periudhën tjetër të vitit.

### 6.3.2. Menaxhim dhe mirembajtje kontanierësh.

Pronësia e kontenierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen ,menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Inspektorët e monitorimit të shërbimit të pastrimit me detyrën e monitorimit të përditshëm të shërbimit të pastrimit, identifikojnë kontenierët që kanë nevojë për mirëmbajtje riparime nga dëmtime të ndryshme të kontenierit. Autoriteti Kontraktor i kërkon kontraktuesit të marrë masa sipas një grafiku të përcaktuar sipas nevojave dhe një grafiku respektiv. Operatori duhet të riparojë kontenierët brënda një afati të përcaktuar nga AK, me të gjitha sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme. Përsa kohë konteneirët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

- Grafikët e punimeve për riparimet e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi/monitoruesit dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.
- Zbatimi i detyrës të përcaktuar nga AK, monitorohet dhe raportohet nga inspektorët e njësive administrative caktuar si monitorues të shërbimti të pastrimit me urdhër nga AK.
- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

a. Operatori sipërmarrës merr në dorëzim kontenierët me proces-verbal midis palëve, në zbatim të procedurës standarte/rregullores. Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkese fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontenirëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës.

b. Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor për tu zëvëndësuar me një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kjo e fundit kur Bashkia të ketë të zbatueshme sistemin e barkodit. Deri atëherë kontenierët do të kenë numërin e tyre rendor për identifikim. Kontraktuesi dhe AK duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontenierët.

## 6.4. MJETET DHE PAJISJET NË SHËRBIMIN E GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE

Në shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Shkodër për tre zonat funksionale të shërbimti të pastrimit, përfshihen mjete teknologjike transportuese me të dhënat sa më poshtë:

Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 9-11 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo me I vjeter se viti 2008 , 2 (dy) copë;

Mjetet teknologjike duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", i ndryshuar, sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 6-8ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, viti i prodhimit jo me i vjeter se viti 2008 ,

Mjeti teknologjik 6-8 ton, duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete", i ndryshuar. sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

Ne llogaritjen e kostove operative ( per mjetet ) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre. ( siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirembajtje mekanike, parking) dhe kosto e amortizimit;

### 6.4.1. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre;

Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve;

Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezifektohen çdo ditë pas përfundimit të punës;

Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor,numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet te prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat;

Autoriteti Kontraktor në plan ka parashikuar një grafik të lëvizjes së mjeteve, por Kontraktuesi duhet të mundësojë një hartë të rrugës më eficente që duhet të ndjek mjeti për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe kalendarin përkatës;

Kontraktuesi do të realizojë instalimin e sistemit të GPS në të gjitha mjetet teknologjike e jo teknologjike. Autoritet kontraktor do lidhet me këtë system nga kontraktuesi. Kontraktuesi do mundësojë nëpermjet serverit qëndror të sistemit GPS realizimin e sistemit të monitorimit nga Autoriteti Kontraktor. Kjo do të mundësojë një monitorim të hollësishëm të lëvizjes të të gjitha

mjeteve, që Autoriteti Kontraktor mund ta perdorë për qëllime të ndryshme(kontroll nga njësia e monitorimit) . Autoriteti Kontraktor do të monitorojë të gjitha lëvizjet e mjeteve teknologjike në zonat përkatëse dhe do të ketë mundësi kontrolli më të mirë në lidhje me rrugën e mjeteve, ndalesave të tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazjen e kontenierëve dhe kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sistemi i GPS nuk duhet të shkëputet nga lidhja me Autoritetin Kontraktor për asnjë moment, si dhe nuk duhet të shkëputet nga lidhja me mjetin. Nëqoftëse rezulton sistemi i fikur tek Autoriteti Kontraktor ,apo dhe tek mjetet, kontraktuesi do penalizohet.

Kushtet teknike për mjetet e transportit.

Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar grumbullimin e mbeturinave. Duhet të të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në NjA;

Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e nje cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash. Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vete dhe nuk duhet që puntorët të ngrenë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.

Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë. Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.

Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10-11 dhe 5-6 ton)

Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situate nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.

Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjenik të mbetjeve.

Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenierëve të mbledhur.

Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasitë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.

Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.

Me nënshkrin e Kontratës, respektimi i kritereve të specifikimeve teknike për mjetet teknologjike që vihen në dispozicion të shërbimit të pastrimit në zonën perëndimore realizohet nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

## 6.5. PROCESE TË TJERA PUNË NË FUNKSION TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT

### 6.5.1 Dezifektimi i PGM

Duhet të bëhet dezifektimi i zonës përreth kontenierëve, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

Frekuenca e dezinfektimit është një herë në javë për periudhën 110 ditë ( cdo ditë premte në zonën e plazhit), ndërsa njësitë administrative një herë në dy javë për sezonin e verës dhe një herë në muaj për periudhën tjetër të vitit.

### 6.5.2 Menaxhim dhe mirembajtje kontanierësh.

Pronësia e kontenierëve është e Autoritetit Kontraktor, ndërsa Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për ruajtjen ,menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Inspektorët e monitorimit të shërbimit të pastrimit me detyrën e monitorimit të përditshëm të shërbimit të pastrimit, identifikojnë kontenierët që kanë nevojë për mirëmbajtje riparime nga dëmtime të ndryshme të kontenierit. Autoriteti Kontraktor i kërkon kontraktuesit të marrë masa sipas një grafiku të përcaktuar sipas nevojave dhe një grafiku respektiv. Operatori duhet të riparojë kontenierët brënda një afati të përcaktuar nga AK, me të gjitha sugjerimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme. Përsa kohë konteneirët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

- Grafikët e punimeve për riparimet e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi/monitoruesit dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.
- Zbatimi i detyrës të përcaktuar nga AK, monitorohet dhe raportohet nga inspektorët e njësive administrative caktuar si monitorues të shërbimti të pastrimit me urdhër nga AK.
- Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

a. Operatori sipërmarrës merr në dorëzim kontenierët me proces-verbal midis palëve, në zbatim të procedurës standarte/rregullores. Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkese fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e konteniréve janë të përfshirë në çmimin e kontratës.

b. Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor për tu zëvëndësuar me një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kjo e fundit kur Bashkia të ketë të zbatueshme sistemin e barkodit. Deri atëherë kontenierët do të kenë numërin e tyre rendor për identifikim. Kontraktuesi dhe AK duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontenierët.

# 7. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT

## 7.1. OFRIMI I SHËRBIMIT NË ZONAT TURISTIKE 12 MUAJ

Deri në vitet e fundit, zonat turistike malore dhe bregdetare në Shqipëri janë frekuentuar vetëm gjatë periudhës së verës. Kushtet klimatike të favorshme dhe shtimi i përgjithshëm i numrit të turistëve në vendin tonë, kanë bërë që këto zona të frekuentohen edhe gjatë muajve të tjerë të vitit, ndonëse jo në nivele të larta. Vizioni i Bashkisë Shkodër është të krijojë kushtet e favorshme për zhvillimin e turizmit gjatë 12 muajve të vitit, dhe për këtë arsyë në këtë moment ka lindur nevoja e shtrirjes së shërbimit të pastrimit gjatë gjithë vitit në Velipojë Plazh dhe Theth-Ndërlysaj.

### 7.1.1. Zona Velipojë Plazh

Zona e Plazhit të Velipojës, gjatë periudhë së verës merr shërbimin e evadimit të kontenierëve, fshirje rrugësh, mirëmbajtje e zonës së rërës, mirëmbajtje e PGM-ve, mirëmbajtje e tualeteve publike, me 17 puntorë, nga të cilët 6 punojnë me mjete dhe 11 realizojnë shërbime mirëmbajtje.

Gjatë periudhës së dimrit aktualisht evadimi i mbetjeve në Velipojë Plazh realizohet 2x/javë sipas grafikut të Njësisë Administrative Velipojë. Vetëm për plazhin propozohet të realizohet 1 frekuencë shtëse në fundjavë, ditën e dielë. Gjithashtu, për realizimin e shërbimeve të tjera, propozohet të ketë 2 punonjës të stacionuar në Velipojë gjatë gjithë vitit. Kostot shtesë që vijnë nga ky ndryshim janë përllogaritur si më poshtë:

| Zona Velipojë Plazh 12 Muaj Kosto shtesë | Lekë/Vit |
|---|---|
| **Evadimi i mbetjeve në Plazh në fundjavë** | 400,000 |

| | |
|---|---|
| **Shërbime të mirëmbajtjes së plazhit** | 1,600,000 |
| **TOTAL** | **2,000,000** |

## 7.1.2. Zona Theth- Ndërlysaj

Fshatrat turistik të Shalës si Thethi, Ndërlysaj, Okol, Gjecaj, etj, marrin 2x/javë shërbimin evadimit të mbetjeve gjatë periudhës së verës dhe 1x/javë shërbim gjatë periudhës Pranverë-Vjeshtë. Për të realizuar një shërbim më cilësor, në një periudhë të shkurtër (meqënëse akoma nuk është miratuar një stacion transferimi për Thethin) propozohet të realizohet evadimi i mbetjeve në këtë zonë gjatë muajve të dimrit 1x/javë, ndërsa në muajt Prill-Maj-Shtator-Tetor të shtohet 1 frekuence pastrimi, pra të realizohet evadimi i mbetjeve 2x/javë. Kostot shtesë që vijnë nga ky ndryshim janë përllogaritur të jenë **1,800,000 lekë/vit** .

## 7.2. SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT DERË MË DERË, ZONA E SHIROKËS

Bashkia Shkodër, sot praktikon mbledhjen derë më derë të mbetjeve urbane në nj.a Velipojë zona Plazh Velipojë gjatë sezonit turistik, kryesisht në qendër të Plazhit, dhe në të dyja pedonalet e qytetit. Me qëllim përmirësimin e shërbimit të pastrimit dhe mbajtjen pastër të ambienteve të përbashkëta kryesisht në territore me destinacion turizmin. Bashkia Shkodër ka një tjetër ambicje në të ardhmen në shtrirjen e zonës të ofrimit të shërbimti derë më derë edhe në zonën e Shirokës.

### PËRSE KËRKOHET TË OFROHET KY SHËRBIM?

- Pamundësia për vendosjen e kontenierëve (infrastuktura/mospranimi) në zona të caktuara, për shkak të gjerësisë së rrugëve apo planifikimit urban të zones. Në rastin e shirokës me destinacion turistik planifikimi urban se lejon vendosjen e kontenierëve pranë shëtitores;
- Dakordësi e komunitetit/bizneseve për t'u përfshirë në një shërbim të tillë për të larguar nga zona e tyre e banimit PGM'të;

## 7.1.1 HAPAT QË DUHET TË NDIQEN PËR SHËRBIMIN DERË MË DERË.

- Përcaktimi i rrugëtimit të makinave që do të kryjenë këtë shërbim (GIS analyze);
- Përcaktimi i orarit në bashkëpunim me bizneset dhe qytetarët, dhe respektimi I orarit, për dorëzimin e mbetjeve nga konsusmatorët jashtë banesës së tyre (pra në asnjë rast makina nuk duhet të kthehet për të marrë mbetje, të cilat depozitohen më vonë se ora e kalimit të makinës;
- Përcaktimi i llojit të mbetjeve që do të evadohet (të përjashtohen mbetjet voluminoze apo inerte).
- Përcaktimi nëse bashkia do të mundësojë kontenierë apo qese për komunitetin apo ato do të duhet të sigurohen nga vetë konsumatori (ndoshta për bizneset mund të mundësojë kosha për mbetjet e riciklueshme);

- Lënia e një PGM opsionale, (mbetjet nuk duhet të lihen jashtë banesave edhe nëse e humbin orarin e grumbullimit të mbetjeve (aplikimi i penaliteteve për mosrespektim të rregullave të përcaktuara bashkarisht);
- Makinat që kryjnë këtë shërbim të ndahen nga ato që tërheqin mbetjet nga kontenierët;
- Rekomandohet që këto makina të jenë të pajisura me një mjet fonie (jo bori), i cili të transmetojë një muzikë të caktuar që konsumatorët të kujtohen që është orari i nxjerrjes së mbetjeve.

### 7.1.2 TË DHËNA PËR SHIROKËN

- Popullsia ekuivalente – 900-1200 banorë;
- Nr. i BM (40) + BV (60) – 100;
- Norma e gjenerimit ekuvalent 0.8kg/banor/ ditë;
- Totali: 0.72 ton/ditë;
- Shërbimi kryhet me kompani private/ndërmarrje publike dhe mbetjet shkojnë në landfillin e Bushatit;
- Prezantimi i zonës së studimit për ofrimin e shërbimit derë më derë;
- Infrastruktura e grumbullimit të mbetjeve në zonë: 26 kontenierë 1.1 m3 (densitet 100 kg/kazan);
- Drejtimi.

Figure Nr. 29: Zona e shërbimit e propozuar për grumbullimin derë më derë




Harta e shërbimit të pastrimit

Propozohet skema me ndarjen e frekeunecave si më poshtë :

- Periudha Janar-Shkurt-Nëntor është e nevojshme të bëhet evadimi 4 herë në javë (mesatarisht rreth 1,5ton mbetje në ditë);

- Periudha Dhjetor-Mars deri në tetor: 9 muajt e tjerë të vitit shërbimit duhet të ofrohet 7 ditë/ javës:
- Në muajin Gusht (7 ditë/ javë dhe 2 herë/ ditë)
- Mesatarisht gjenerohen 2.6ton/ditë mbetjet

## 7.1.3. KËRKESAT PËR SHËRBIMIN E RI DERË MË DERË

- Popullsia ekuivalente 900-1200 banorë (100 biznese)

Zona I – 30% e popullsisë ekuivalente furnizohet me qese ;




Zona II – 70% e popullsisë ekuivalente furnizohet me kontenierë 220 litra ;

Mjeti teknologjik që parashikohet është 3 ton

- Modelet e rrugëtimit me GIS

Llogaritja e kostos:

Zona I (periudha 3 mujore dhe periudha 9 mujore sipas frekuencave);

Zona II (periudha 3 mujore dhe periudha 9 mujore sipas frekuencave);

Gate fee në landfill e Bushatit – 1,800 lek/ton (tarifa e vjeter)

Figure Nr. 29

## RRUGËTIMI - BM

Distanca e grumbullimit 8 km
Distanca për në landfill 19 km
Mjeti teknologjik 3 ton

Rrugetimi per konsumatorin BM zonen Shiroke



Figure Nr. 30

RRUGËTIMI BV + banorë

Distanca e grumbullimit 14 km
Distanca për në landfill 19 km
Mjeti teknologjik 3 km

Figure 31

Rrugetimi per konsumatorin BV+Banor zonen Shiroke




Figure 32:RRUGËTIMI BM + BV + banorë

Rrugetimi per te gjithe konsumatoret




RRUGËTIMI Landfillin e Bushatit

Distanca për në landfill 19 km

Rrugetimi per te gjithe konsumatoret



### 7.1.4. Llogaritja e Kostos

Zona I (30% e popullsisë ekuivalente )

30% e banorëve ekuivalentë (për 3 muaj -katër herë në javë dhe 9 muaj – 7 ditë në javë )

Tabela 21:

| Kosto Zona I | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zona 1 (3 muaj - 51 ditë) | O&M | | | 697,871.16 Lekë |
| Zona 1 (9 muaj) - 252 ditë) | O&M | | | 1,702,797.86 Lekë |
| | O&M totale | | | 2,400,669.02 Lekë |
| Zona 1 (3 muaj - 51 ditë) | Kosto investimi (kontenier+makina) | | | 780,115 Lekë |
| Zona 1 (9 muaj) - 252 ditë) | Kosto investimi (kontenier+makina) | | | 2,327,280 Lekë |
| | Kosto totale investimi | | | 3,107,395 Lekë |
| Zona e Shirokës | Kosto totale - vjetore | | | 5,508,064.22 Lekë |

| | Nr. kontenierësh | Nr. Makina | Tonazhi | Turnet | Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit) | Sasia ditore e mbetjeve (ton/ditë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zona 1 (3 muaj - 51 ditë) | 1,050 | 1 | 3 | 1 | 11 | 0.31 |
| Zona 1 (9 muaj) - 252 ditë) | 3,629 | 1 | 3 | 1 | 54 | 0.22 |
| Totali | 4,679 | | | | 65 | 0.52 |

**Kosto njësi Zona I**







| Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 120 Lek | [illegible] |
| Transport | 497 Lek | 4.74 € |
| Mirëmbajtje | 168 Lek | 1.60 € |
| Personel | 1,702 Lek | 16.21 € |
| Amortizim | 12 Lek | 0.12 € |
| Depozitim | [illegible] | [illegible] |
| Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative | 2,585 Lek | 24.62 € |

| Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 3,128 Lek | 29.79 € |
| Transport | 12,392 Lek | [illegible] |
| Mirëmbajtje | 4,129 Lek | 39.32 € |
| Personel | 41,713 Lek | 397.26 € |
| Amortizim | 300 Lek | 2.85 € |
| Depozitim | [illegible] | [illegible] |
| Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative | 63,351 Lek | [illegible] |

| Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 873 Lek | 8.32 € |
| Transport | 2,458 Lek | 23.41 € |
| Mirëmbajtje | 832 Lek | 7.93 € |
| Personel | 1,702 Lek | 16.21 € |
| Amortizim | 60 Lek | [illegible] |
| Depozitim | 381 Lek | 3.63 € |
| Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative | 6,307 Lek | 60.05 € |

| Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | [illegible] | 41.23 € |
| Transport | 12,192 Lek | 116.11 € |
| Mirëmbajtje | 4,129 Lek | 39.32 € |
| Personel | 8,442 Lek | 80.40 € |
| Amortizim | 300 Lek | 2.85 € |
| Depozitim | [illegible] | [illegible] |
| Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative | 35,283 Lek | 337.93 € |

- 30% e banorëve do të furnizohen me qese për aq ditë në javë sa ofrohet shërbimi
- 4 qese në javë për 3 muaj
- 7 qese në javë për 9 muaj
- Kosto e qeses;
- 21 qese në ditë për 3 muaj – 1,050 qese në total për 51 ditë.

# LLOGARITJA E KOSTOS – ZONA II (70% E POPULLSISË EKUIVALENTE)

Zona 2 - 70% e banorëve ekuivalentë (për 3 muaj – 4 herë në javë dhe 9 muaj – 7 ditë në javë)

| | | MBETJET DEPOZITOHEN NË LANDFILLIN E BUSHATIT |
|---|---|---|
| Zona 2 (3 muaj - 51 ditë) | O&M | 731,975.79 Lekë |
| Zona 2 (9 muaj) - 252 ditë) | O&M | 1,861,888.42 Lekë |
| | O&M totale | 2,593,864.22 Lekë |
| Zona 2 (3 muaj - 51 ditë) | Kosto investimi (kontenier+makina) | 438,288 Lekë |
| Zona 2 (9 muaj) - 252 ditë) | Kosto investimi (kontenier+makina) | 150,000 Lekë |
| | Kosto totale investimi | 588,288 Lekë |
| Zona e Shirokës - Bashkia Shkodër | Kosto totale | 3,182,152.22 Lekë |

| | Nr. kontenierësh | Nr. Makina | Tonazhi | Turnet | Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit) | Sasia ditore e mbetjeve (ton/ditë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zona 2 (3 muaj - 51 ditë) | | 1 | 3 | 1 | 26 | 0.72 |
| Zona 2 (9 muaj) - 252 ditë) | 48 | 1 | 3 | 1 | 127 | 0.50 |
| Totali | 48 | | | | 153 | 1.22 |

- 70% e banorëve do të furnizohen me kontenier 220 litra
- Kosto e kotenierit 220 litra qeses (6,000 lek/kontenier)
- 48 kontenierë në total për zonën
- Kosto e investimit për kontenierët – 288,288 lek

## Kosto njësi Zona 2

Zona e sherbimit Zona 1

Kostot totale të menaxhimit (LEK/vit) 725,631.48



| Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 55 Lek | 0.52 € |
| Transport | 213 Lek | 2.03 € |
| Mirëmbajtje | 72 Lek | 0.69 € |
| Personel | 729 Lek | 6.95 € |
| Amortizim | 3 Lek | 0.03 € |
| Depozitim | [illegible] | [illegible] |
| Total, përfshirë të ardhura neto dhe kosto administrative | 1,152 Lek | 10.97 € |

| Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 1,341 Lek | 12.77 € |
| Transport | 5,225 Lek | 49.76 € |
| Mirëmbajtje | 1,769 Lek | 16.85 € |
| Personel | 17,877 Lek | 170.26 € |
| Amortizim | 128 Lek | 1.22 € |
| Depozitim | 1,930 Lek | [illegible] |
| Total, përfshirë të ardhura neto dhe kosto administrative | 28,230 Lek | 268.85 € |

Zona e sherbimit Zona 2

Kostot totale të menaxhimit (LEK/vit) 1,833,306.50



| Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 374 Lek | 3.56 € |
| Transport | 1,053 Lek | 10.03 € |
| Mirëmbajtje | 357 Lek | 3.40 € |
| Personel | 729 Lek | 6.95 € |
| Amortizim | 26 Lek | 0.25 € |
| Depozitim | 381 Lek | 3.63 € |
| Total, përfshirë të ardhura neto dhe kosto administrative | 2,921 Lek | 27.82 € |

| Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit | | |
|---|---|---|
| Grumbullim | 1,854 Lek | 17.66 € |
| Transport | 5,225 Lek | 49.76 € |
| Mirëmbajtje | 1,759 Lek | 16.75 € |
| Personel | 3,613 Lek | 34.41 € |
| Amortizim | 128 Lek | 1.22 € |
| Depozitim | [illegible] | [illegible] |
| Total, përfshirë të ardhura neto dhe kosto administrative | 14,437 Lek | 137.97 € |




Figure 34 krahasimi i kostove shiroka

## 8. TRAJTIMI I MBETJEVE

Vendi i depozitimit të mbetjeve

Mbetjet urbane të evaduara nga i gjithë territori i Bashkisë Shkodër, depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit. Lendfilli i Bushatit është i vetmi lendfill i miratuar në zonën e mbetjeve Shkodër-Lezhë. Tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane në lendfillin e Bushatit për shërbimin e pastrimit Bashkia Shkodër Zona Qëndrore, mbulohet nga Institucioni i Bashkisë Shkodër sipas kontratës mes palëve. Lendfilli i Bushatit është përcaktuar nga Qeveria Shqipëtare si destinacioni për trajtimin përfundimtar të mbetjeve urbane për të gjithë rajonin e veriut, qarqet Shkodër & Lezhë.

Të dhëna teknike të lendfillit

| Nr. | Lendfill ekzistues/në projekt | Sipërfaqja | Kapaciteti (Ton ose m3) | Shënim |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bushat (Shkodër) | 12 ha | 1 000 000 m3 | Në veprim |

Kur mjetet teknologjike hyjnë në lendfill ato peshohen rregullisht dhe më pas depozitohen në landfill. Ndonëse impianti i trajtimit të mbetjeve në Bushatit ka infrastrukturën që mbetjet të ndahen mbetjet e riciklueshme, në fakt në impianti ndodh vetëm procesi i depozitmit dhe ngjeshjes së mbetjeve. Bashkia Shkodër ka punësuar një punonjësin e saj në landfill, i cili mban evidencat në lidhje me ngarkesat që vijnë nga njësitë administrative. Në këtë landfill, si në shumë vende të tjera depozitimi

mbetjesh në vend, sektori informal kryen aktivitet pothuajse të përditshëm në grumbullimin e mbetjeve plastike, ku grumbujt e tyre janë shumë evidente.

Firma private e cila ushtron aktivitetin teknologjik në impiant bën ngjeshjen dhe mbulimin me dhe të mbetjeve pasi ato depozitohen. Në këtë impiant është instaluar në hyrje të tij një linjë për ndarjen e mbetjeve, por rrallë vihet në punë. Vendepozitimi ka sistemin e kullimit të ujrave të shiut që mbledh ujrat sipërfaqësorë dhe i devijon ato nga venddepozitimi, impianti i pastrimit të tyre shpesh herë ka pasur probleme. Si pasojë shllami derdhet herë pas here në sistemin e gropave septike duke krijuar një rrezik potencial për mjedisin. Landfilli aktualisht ka hyrë në zonën e maturimit të sasisë të gazit të metanit (CH4), i cili ka filluar të japet nga dy puse dhe më pas realizohet djegia në natyrë.

Infrastruktura për në lendfill është shumë e degraduar dhe hyrja për në lendfill nuk ka një rrugë të ndërtuar duke bërë në të njëjtën kohë dëmtimin dhe amortizimin e shpeshte të mjeteve teknologjike.

Foto :3 Landfilli i Bushatit



## 9. MINIMIZIMI I MBETJEVE

Sipas indikatorëve të performancës edhe pse me anë të tentativave të shtuara për të incentivuar proceset e riciklimit dhe ndarjes në burim të mbetjeve, indikatorët flasin për një nivel jo të kënaqshëm të arritjes të objektivave në këtë proces këto pesë vite.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të integruar të mbetjeve janë përcaktuar indikatorë specifikë në lidhje me sasinë e mbetjeve që duhet të trajtohen në mënyrë të veçuar (riciklim, kompostim) sipas afateve kohore deri në vitin 2035[3] për të arritur objektivat si më poshtë :

Mbetjet nga paketimet: deri në vitin 2025 duhet të rikuperohen jo më pak se 10% e peshës totale të mbetjeve

Deri në vitin 2025 duhet të riciklohen:

---

[3] Këtu kemi hedhur objektivat kombëtare deri në vitin 2025 (harku kohor i zbatimit të planit)

- jo më pak se 10% e peshës totale të letrës dhe kartonit;
- Jo më pak se 6% e peshës totale të plastikës;
- Jo më pak se 10% e peshës totale të qelqit;
- Jo më pak se 5% e peshës totale të mbetjeve nga druri ;

Mbetjet e biodegradueshme deri në vitin 2025 duhet të reduktohen 75% e nivelit të vitit 2016;

Rekomandohet që për të arritur sa më sipër për Bashkinë propozojmë sistemet e ndarjes të mbetjeve në burim sa më poshtë:

- I gjithë sistemi i ndarjes përbëhet nga dy komponentë: sistemi parësor i ndarjes dhe sistemi dytësor i ndarjes.
    - **Sistemi parësor i ndarjes:** Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të ricikluesh me dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre.
    - **Sistemi dytësor i ndarjes**, nënkupton ndarjen e tyre në PGM publike të grumbullimit të tyre.

Lind pyetja si funksionojnë këto dy sisteme dhe a është e mundur zbatimi efikas I tyre?

- **Sistemi parësor – skemat individuale të ndarjes së mbetjeve:** Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet theksuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë. Nga këndvështrimi i angazhimit të drejtpërdrejtë të pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve, ky sistem siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.

Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme **për biznesin dhe industrinë**, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve. Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim do të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror, duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me 3 kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me 3 kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty. Ngjyrat duhet të përcaktohen qartësisht që në fillim:

Kodi i ngjyrave për tre kontenierët e vegjël nënkupton:

1. Në kontenierin me **ngjyrë blu** do të depozitohen mbetjet **si letër dhe karton;**

2. Në kontenierin me ngjyrë të **gjelbër** do të depozitohen kanaçet metalike dhe mbetjet plastike;

3. Në kontenierin me **ngjyrë të zezë/kafe** do të depozitohen **mbetje të tjera/mikse**.



Ky konfigurim i kontenierëve mund të aplikohet në biznese, ose në institucione publike, siç janë shkollat. Vendimi për ngjyrën dhe llojet e mbetjeve që shkojnë në koshat respektivë mund të rishikohet dhe vendoset përfundimisht dhe me një urdhër të veçantë të Bashkisë, sapo mundësitë teknike dhe njerëzore të jenë të arritshme.

- **Sistemi dytësor – skemat e përbashkëta për ndarjen e mbetjeve:** Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbetjeve urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë. Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbetjeve dhe aty ku blloqet e banimit janë kolektive.

Sektori informal, i cili është krahu kryesor i punës në sektorin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme nuk është plotësisht në vëmendje nga struktuarat shtetërore. Ky sektor sjell mjaft dobi në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, si:

i) ul mesatarisht deri 15-30% sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill/fushë depozitimi;
ii) ul koston e shërbimit të grumbullmit dhe transportit të mbetjeve;
iii) është burim të ardhurash për rreth 2% të popullsisë së zonave të varfra;
iv) sipas shifrave nga literatura e huaj llogaritet që çdo ton mbetje e riciklueshme e grumbulluar është e barabartë me një vend pune.

Ashtu si hierarkia e përgjithshme e menaxhimit të mbetjeve, edhe menaxhimi i mbetjeve të riciklueshme duhet të mbështetet në një hierarki të ngjashme, ku objektivi kryesor është parandalimi sa më shumë i gjenerimit të mbetjeve:

i) Riprodhimi i mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më shumë);
ii) Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme nga tregtarët;
iii) Mbledhësit formalë të mbetjeve të riciklueshme;
iv) Grumbulluesit fillestarë të mbetjeve të ricikleshëm;
v) Mbledhësit informalë të mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më pak);

Një skemë e tillë ndarjesh në burim në mbetje të thata dhe të njoma është parashikuar për komunën Velipojë sot Nj.a Velipojë.

**Skemat e grumbullimit dhe të ndarjes në burim, parashikuar për Komunën Velipojë (Co-PLAN, 2011)**

**Grupet e synuara:** 100 ndërtesa në zonën e plazhit; 100 pika individuale të grumbullimit (kontenierë 2–ngjyrësh me kapacitet 50 litra).

**Shërbimi:** 3 herë në javë për mbetjet organike dhe 1-2 herë në javë për mbetjet e ricikluara;

**Përfitimet:** Ofrohet shërbim i grumbullimit të mbetjeve në një zonë me rrugë të ngushta; përgatiten për riciklimin rreth 20% të rrjedhës aktuale të mbetjeve;

**Kufizimet:** Rritja me 4.5% e kostos totale vjetore; Mungesa e njohurive dhe sensibilizimit; skema funksionon vetëm një pjesë të vitit, gjatë verës.



**Zona veriore e vilave në zonën e plazhit të Komunës së Velipojës**



**rruga e kalimit të kamionit**



**pikë grumbullimi në burim**

## 10 NDARJA E MBETJEVE NË BURIM

Bashkia Shkodër jo rrallë herë është ndeshur me situata të vendimarrjes të rritjes së tarifës të depozitimit të mbetjeve urbane ne lendfillin e Bushatit. Meqenëse lendfilli i Bushatit ka kërkuar nga Bashkia Shkodër herë pas here rritjen e tarifës të depozitimit të mbetjeve të kësaj Bashkie në lendfill, dhe nga proceset gjyqësore ende nuk është gjendur një zgjidhje me drejtuesit e këtij lendfilli edhe pse në nisje të operimit të këtij lendfilli është marrë vendimi i një menaxhimi Rajonal sot menaxhohet vetëm nga Bashkia e Vau Dejës dhe me kërkesë të koncesionarit dhe Asamblesë të përgjithshme merren vendime për të rritur tarifën e depozitimit të mbetjeve në këtë lendfill. Për cfarë cituar më sipër Bashkisë Shkodër i del nevojë imediate të ulë volumin e depozitimit depozitimin e mbetjeve në këtë lendfill duke ndërmarrë masa që nga ndarja në burim, kompostimi, riciklimi dhe rekuperimi i mbetjeve para se këto mbetje të depozitohen ne lendfill. Një element i rëndësishëm për t'u marrë parasysh gjatë planifikimit të sistemit të grumbullimit të mbetjeve është planifikimi i skemave për ndarjen e mbetjeve, të cilat duhet të ndërthuren me skemat ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve dhe të jenë pjesë e sistemit të përgjithshëm të MMU. Edhe pse si fillim këto skema shihen si faktorë që rrisin koston në skemat ekzistuese apo si programe të ndërlikuara për ofruesin e shërbimeve dhe për publikun për t'i zbatuar, ato duhet të shihen si detyrime të së ardhmes dhe si masa thelbësore për t'u përqafuar nga autoritetet vendore në përputhje me politikat kombëtare për menaxhimin e mbetjeve. Zbatimi i praktikave më të mira për ndarjen në burim dhe grumbullimin e mbetjeve të ricikluеshme do të cojë jo vetëm në zbutjen e barrës financiare të Bashkisë Shkodër me rritjen e tarifës të depozitimit të mbetjeve por edhe do të jenë hapa konkretë në përmirësimin e cilësisë të mjedisit drejt një zhvillimi urban të qëndrueshëm të territorit.

Planifikimi dhe zhvillimi i skemave për ndarjen e mbetjeve duhet të marrë në konsideratë dhe të bazohet në çështjet e mëposhtme;

i) Sa e rëndëshme është ndarja e mbetjeve për prioritetet vendore?
ii) Çfarë mbetjesh, sa mbetje, cila është përbërja e tyre, apo ku mund të gjendet sasia e duhur e fraksioneve të dëshiruara të mbetjeve?

Cilat janë skemat më të përshtatshme dhe efektive që përshtaten me realitetin vendor?

Bashkia Shkodër duhet të ketë informacion fillimisht se cfarë lloj mbetjesh duhet të ndahen, a ka interes për to dhe për më tepër duhet studiohet tregu i shitjes të mbetjeve që do të grumbullohen në pikat e grumbullimit. Ndarja e mbetjeve në burim do të thotë që Bashkia duhet të përqëndrohet tek materialet e riciklueshme kryesore si (plastika, letra, kartoni, metalet, qelqi etj), sikur edhe tek materialet e kompostueshme (organike). Më pas, bashkia duhet që me zbatimin e kësaj nisme të vendosi objektiva për ndarjen e rrymave të caktuara të mbetjeve ose në funksion të arritjes së objektivit të përgjithshëm për të ulur sasinë e mbetjeve që depozitohet në landfill. Paraprakisht Bashkia duhet të mbledhë informacion sa është sasia e mbetjeve të riciklueshme dhe organike.

Në vitin 2021 është realizuar studimi i fundit i raportit "vlerësimi bazë" të përgatitur nga Projekti CirculaMare mbështetur nga aleanca kundër mbetjeve të plastikës zbatuar nga GIZ. CircoMare ka llogaritur që nga totali i mbetjeve të grumbulluara në Bashkinë Shkodër vetëm organike të thata janë 62.52% të mbetjeve totale për vitin 2023 llogariten 21287 Ton. Ndërsa mbetjet e riciklueshme si më poshtë vijon:

| | % | Ton/Vit |
|---|---|---|
| leter | 3 | 1021 |
| karton, | 5.46 | 1859 |
| qelq | 5.55 | 1890 |
| plastike totale, | 12.92 | 4399 |
| alumin | 0.6 | 204 |
| kanace | 1 | 340 |
| TOTAL | | 9713 |

**Bashkia para vendimarrjes duhet të hartojë studimin e fizibilitetit dhe të studiojë tregun e riciklimit.** Për momentin në territorin e qytetit të shkodrës nuk ka firma që merren drejt për drejtë me riciklimin e mbetjeve të riciklueshme . Pas kësaj në pamundësi, Bashkia duhet të studiojë tregun në rang Qarku, gjithashtu të krijojë hartëzimin e territoreve brenda bashkisë të gjenerimit të mbetjeve të riciklueshme është shumë e rëndësishme. Duhet të evidentohen prodhuesit më të mëdhenj të këtyre mbetjeve specifike dhe lloji i mbetjeve që ata prodhojnë.

Në tabelën e mëposhtme jepen prodhuesit kryesorë të llojeve të caktuara të mbetjeve (për riciklim dhe kompostim).

| Prodhuesit dhe vendet e duhura | Llojet e mbetjeve të synuara |
|---|---|
| Tregjet | Karton, plastikë |

| | |
|---|---|
| Zonat tregtare | Karton, letër, plastikë mbetjet organike |
| Restorantet, zonat turistike | Mbetjet organike, qelqi |
| Veprimtaritë administrative | Letra |
| Qendra e qytetit | Letra, kartoni, plastika |
| Periferitë, komunat, kopshtet bimore | Mbetjet organike |
| Industria | Mbetje specifike sipas prodhimit specifik |

## 10.1. RICIKLIMI DHE KOMPOSTIMI

Industria e riciklimit elementi më thelbësor dhe forma më e njohur për zvogëlimin e mbetjeve që zhvillohet nëpërmjet një zinxhiri procesesh duke përfshirë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin, që çon në zvogëlimin e një sasie të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në lendfill.

Sipas strategjisë Kombëtare sic raportohet nga SHRSH, për shkak të mungesës së lëndës së parë, kjo industri ka angazhuar vetëm 26.8 % të kapacitetit prodhues ose 133,592 ton/ vit, e cila përbën rreth 10% të totalit të mbetjeve të ngurta urbane (përfshirë dhe ato jo urbane që shoqërojnë mbetjet e ngurta shtëpiake (familjare dhe të tjera të ngjashme) që raportohet nga INSTAT.

Në vitin 2018, INSTAT raporton se në Shqipëri janë ricikluar rreth 245,040 ton/vit, ose sa 18.5 % e totalit të mbetjeve të ngurta urbane (përfshirë dhe ato jo urbane që shoqërojnë mbetjet e ngurta shtëpiake (familjare dhe të tjera të ngjashme). SHRSH raporton se niveli i riciklimit në Shqipëri është në masën 10 %. Në territorin e Bashkisë Shkodër nuk regjistrohen aktivitete në lidhje me riciklimin dhe kompostimin në asnjë nga njësitë administrative. Qyteti i Shkodrës vite më parë ka testuar vendosjen e sistemit me tre kosha në rrugët kryesore të qytetit, por kjo skeme nuk funksionoi dhe bashkia përsëri ka aplikuar sistemin e grumbullimit të mbetjeve vetëm më një kosh.

Në të shkuarën për pjesën e qytetit ka patur përpjekje për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga sektori i bisnesit, por përsëri këto përpjekje nuk kanë mundur të kenë sukses të mëtejshëm.

Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend, dhe në rajonin e Shkodrës do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me aktorët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimit. Skema aktuale e grumbullimit të mbetjeve është klasike, ku mbetjet mblidhen dhe transportohen të përzier, pa ndjekur procesin e ndarjes, për në landfillin e Bushatit. Aktualisht, ndonëse në bashkinë Shkodër mund të ketë patur kërkesa nga aktorë të rajoneve të tjera për të mbledhur disa fraksione të caktuara të mbetjeve të riciklueshme, popullsia Rome është ajo që kryen një aktivitet të përditshëm informal në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga PGM apo në depozitimet ilegale në territor.

Detyra kryesore e Bashkisë Shkodër është të nxisë dhe krijojë një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të riciklimit, duke ngritur një skemë efektive dhe efikase për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme si plastikë, letër&karton, metal, qelq apo produkte të tjera të cilat kanë interes të lartë në tregun shqiptar ashtu dhe në rajon. Afrimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit për të mbështetur skemat lokale të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve në zonat urbane të bashkisë do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe do të ulë barrën financiare të bashkisë.

Përfshirja e sektorit privat, me anë të konçesionit apo PPP do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Identifikimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit që është aktiv në rajon apo jashtë kufirit shtetëror do të jetë një nga detyrat kryesore të bashkisë për të mbështetur riciklimin në qytet. Skemat e partneritetit publik-privat mbeten zgjidhjet më të mundshme për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori.

Bazuar në praktika të ngjashme dhe studime të realizuara, përllogaritet që nëse do të realizohet vecmas pa u lidhur me asnjë nga skemat që aktualisht zbatohen në territor, kostoja e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të rritet me 25-30%, vetëm duke kaluar nga një sistem i zakonshëm, në atë me 3 kosha por është e rëndësishme të theksohet se ky system do të ulë volumin e mbetjeve që dërgohen në lendfill duke ulur nga viti në vit barrën financiare që vjen si pasojë e rritjes të tarifës të depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane në lendfillin e Bushatit. Bashkia SHkodër është Bashkia që dërgon më shumë mbetje në lendfilline Bushatit nga të gjitha bashkitë e tjera në rajonin SHkodër-Lezhë.Opsioni më I mundshëm për tu realizuar nga Bashkia Shkodër është ofrimi i këtij skenari në zona dhe territore që sot realizohet mbledhja derë më derë . Këtu Bashkia Shkodër bën të mundur pilotimin e procesit me një kosto të ulët ose rasti më i mirë në kontratat aktuale të zbatimit të shërbimit të pastrimit, realizuar nga operatorët sipërmarrës. Por këtu Bashkia duhet të jetë e kujdesshme në monitorim që mbetjet mos të përfundojnë në të njëjtin mjet por të dorëzohen në pikën e grumbullimit të mbetjeve të ricikueshme që do të sigurojë Bashkia Shkodër.

Sot Bashkia Shkodër ka një Ndërmarrje të Shërbimeve Publike e cila merr përsipër të veprojë direkt me mjetet e veta për shërbime të ndryshme publike, për të ulur koston e shërbimit. Shihet një mundësi e mirë përfshirja e mjeteve dhe fuqisë punëtore të ndërmarrjes publike në grumbullimin dhe transportin e mbetjeve potenciale për riciklim.

Riciklimi nuk është një proces ku autoritetet vendore mund të veprojnë vetë në mënyrë të pavarur; por ka nevojë për përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të industrisë së riciklimit dhe të komunitetit vendor. Detyra e autoriteteve vendore është të krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e këtij sektori në nivel vendor; të krijojnë dhe zbatojnë skema të ndarjes së mbetjeve; të nxisin investimet e biznesit të riciklimit dhe pjesëmarrjen aktive të tij. Është gjithashtu përgjegjësia e autoriteteve vendore të rrisin ndërgjegjësimin publik dhe edukimin e komunitetit për parandalimin e mbetjeve, ripërdorimin, riciklimin, kompostimin e tyre etj. Ideja nuk është vetëm të prezantohen këto skema të ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve si një detyrim ndaj politikës kombëtare në këtë sektor, dhe që më pas mund të kthehen në një barrë organizative dhe financiare për administratën vendore.

Qëllimi është që të planifikohen dhe zbatohen skema me kosto efektive, do të cilat do të mund të gjenerojnë materiale cilësore në një sasi të konsiderueshme, në përgjigje të kërkesave të industrisë së riciklimit.Hapat e mëposhtëm jepen si rekomandime për t'u marrë në konsideratë në fazën e planifikimit të skemave të riciklimit, për arritjen e objektivave në këtë sektor. Për përmbushjen e këtyre hapave dhe për realizimin e veprimtarive të domosdoshme mund të jetë e nevojshme një ekspertizë e jashtme.




## 15. KOMPOSTIMI I MBETJEVE

Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se pothuajse të 10 NJA të Bashkisë Shkodër, duke përjashtuar qytetin e Shkodrës, i cili ka karakter urban, pjesa tjetër ka karakter suburban dhe kryesisht rural, dhe sasia e mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, bujqësia apo blegtoria në zonë, përbëjnë një sasi të konsiderueshme për zhvillimin e kompostimit familjar (individual) dhe kolektiv. Nj.a Shkodër vetë edhe pse me karakter urban ka në territorin e qytetit shtepia me oborre shkodrane të pasura me pemë kur krasitja dy herë në vit, shkakton probleme me pikat e grumbullimti të shpërndara në qytet. Bashkia mund ta përdorë produktin e kompostit në bujqësinë e zonës, apo për lulishtet e qytetit.

**Kompostimi në nivel individual** (në shtëpi) paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat suburbane apo rurale. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme sesa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas transportimi i tyre në landfill, ku përfshihen edhe depozitimi si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese. Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbetjeve që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston transportit dhe të trajtimit final të mbetjeve. Në rastin e mbetjeve drusore, të cilat në zonat sub-urbane/rurale janë të shumta, bashkia mund të ofrojë shërbimin e copëtimit (grirjes) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar mbetjet drusore, disa herë në vit.



Foto nr.4 Modeli i kompostimit individual

[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

Përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat më të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë **kompostimi në mjedis të hapur (kolektiv)**. Kjo metodë nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e një sasie të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga bashkia për qëllime publike.



Foto nr.5 Skemat e kompostimit në mjedis të hapur

[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

# 15. RICIKLIMI I MBETJEVE

## 15.1 METODOLOGJIA DHE OPSIONET E NDARJES NË BURIM

Metodologjia për hartimin e opsioneve të ndarjes në burim të mbetjeve të riciklueshme me zbatimin e skenarëve të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, element të rëndësishëm të studimit fizibilitetit për Bashkinë Shkodër, gjen zbatim në rast se Bashkia Shkodër e ka të ngritur një qendër grumbullimi mbetjesh të riciklueshme dhe të testuar paraprakisht skemën e grumbullimit të mbetjeve të ndara në burim. Zbatimi i metodologjisë përllogarit koston e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve të riciklueshme dhe llogariten të ardhurat e pritshme nga shitja e materialeve të riciklueshme të mbledhura.

Në fillesat e punës duhet të përllogaritet kosto për zbatimin e skemave që duhe te implementohen me qëllim grumbullimin e materialeve të riciklueshme si pjesë integrale e skemës së përgjithshme (Opsioni1) e fokusuar në qytetin e Shkodrës me synim shtrirjen e mëtejshme. Ky skenar jep fillesat e futjes së një shërbimi modern për bashkinë dhe integron skemën e ndarjes në burim për njësitë e caktuara dhe Qendrën e Grumbullimit të Materialit të Riciklueshëm.

Analiza e sistemit të ndarjes në burim dhe përgatitjes për treg të materialeve të riciklueshme në zonë pilot duhet të përgatitet brenda kornizës së financimit të sistemit nga projekte të financuar nga donatorë që operojnë në Shqipëri në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Një nga fokuset kryesore të

- Hotelet dhe restorantet në Theth.

| Të dhëna për turistët | Njësi |
|---|---|
| Vizitorë total | Nr |
| Vizitorë në Qytet (+shirokën) | Nr |
| Vizitorë në Velipojë | Nr |
| Vizitorë në Theth | Nr |
| Netë qëndrimet, mesatarisht në Qytet (+shirokën) | netë |
| Netë qëndrimet, mesatarisht në Velipojë | netë |
| Netë qëndrimet, mesatarisht në Theth | netë |
| Gjithsej netë qëndrimet në Qytet (+shirokën) | Nr |
| Gjithsej netë qëndrimet në Velipojë | Nr |
| Gjithsej netë qëndrimet në Theth | Nr |
| Qytet (+shirokën) netë qëndrimet | % e totalit |
| Velipojë netë qëndrimet | % e totalit |
| Theth netë qëndrimet | % e totalit |
| Netë qëndrimet në hotele (Qytet+Theth+Velipojë ) | % e totalit |
| Netë qëndrimet në hotele në Qytet (+shirokën) | % e totalit |
| Netë qëndrimet në Velipojë | % e totalit |
| Netë qëndrimet në Theth | % e totalit |

Koncepti për ndarjen në burim të plastikës dhe metaleve mbështetet tek bizneset për të ruajtur shishet plastike dhe kanaçet në qese plastike para se t'i vendosni ato në kontenierët me rrjetë teli. Kjo është e domosdoshme nga fakti që kamioni i furnizuar nuk ka mekanizëm ngarkimi. Parandarja e materialeve do të rezultojë në kohë të optimizuar për mbledhjen dhe trajtimin pasues në strukturën e riciklimit. Me numrin e disponueshëm të kontenierëve dhe kapacitetin e kamionit, vlerësohet se frekuenca mesatare e grumbullimit do të jetë një herë në çdo 3 ditë gjatë sezonit turistik.

- Përcaktohet kosto për njësi për grumbullimin e ndarë të mbetjeve opsioni 1;
- Përllogaritet potenciali i të rardhurave ;
- Përllogariten kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) ku përfshihen kostot për personelin, karburantin, vajin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Kostot vjetore përfshijnë kostot O&M dhe kostot për amortizimin vjetor të kontenierëve dhe automjeteve.

**Për OPSIONIN 1. LLogariten të ardhurat e pritshme nga shitja e materialeve të riciklueshme të mbledhura.**

## 15.1.2. OPSIONI 2. MBETJET E GJENERUARA NGA RESTORANTET DHE TREGJET

Ky opsion synon mbledhjen e kartonit nga tregjet dhe mbledhjen e plastikës (shishe PET kryesisht) dhe kanaçet e aluminit nga restorantet dhe baret në zonat më poshtë:

- Shkodër qendër (pedonale), Tregu Rus, Blv.Bujar Bishanaku + Zdrale, dhe Shirokë.
- Theth;
- Velipojë;

Nga të dhënat kombëtare, 75% e kartonit gjenerohet nga supermarketet, nga të cilat 20% gjenerohen nga tregjet e identifikuara tashmë. Lidhur me plastikën dhe kuti prej kallaji, supozohet se rreth 30% e sasive totale gjenerohen nga bare dhe restorante, nga të cilat 10% nga institucionet e identifikuara në zonë.

Ashtu si Opsioni 1, edhe ky opsion mbështetet nga bizneset për të ruajtur shishet plastike dhe kanaçet në qese plastike nga bizneset përpara se t'i vendosin ato në kontenierë me rrjetë teli.

Me numrin e disponueshëm të kontenierëve dhe kapacitetin e kamionit, vlerësohet se frekuenca mesatare e mbledhjes do të jetë:

- Një herë në tre ditë për plastikën dhe metalet;
- Një herë në 4 ditë për kartonin.

<u>Për Opsionin 2 përcaktohen dhe përllogariten:</u>

- Numri dhe vendndodhja e kontenierëve;
- sasitë e mbetjeve të synuara për grumbullim të ndarë, bazuar në vendodhjet sa më sipër:
- Supozimet për gjenerimin e mbetjeve;
- sasitë vjetore dhe ditore të mbetjeve të synuara për ndarjen në burim;
- Supozimet e kostove O&M;
- Të ardhurat e pritshme nga shitja e materialeve të riciklueshme të mbledhura;
- Vlerësimi i kostos dhe potenciali i të ardhurave.

Duhet te mbahet parasysh përllogaritja e Kostos të funksionimit dhe mirëmbajtjes (O&M) . Kjo kosto përfshin kostot për personelin, karburantin, vajin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Kostot vjetore përfshijnë kostot O&M dhe kostot për amortizimin vjetor të kontenierëve dhe automjeteve. Amortizimi për kontenierët vlerësohet në 7 vjet; amortizimi vjetor i kamionëve për mbledhjen e mbetjeve vlerësohet në 10 vjet.

### 15.1.3. OPSIONI 3. MBETJET E GJENERUARA NGA TË GJITHA BURIMET

Siç u përmend më parë, Opsioni 3 shqyrton mundësinë për të siguruar shërbim të veçantë për grumbullimin e mbetjeve për të gjitha familjet, institucionet dhe bizneset në bashki. Opsioni 3, ka një shtrirje më të gjërë të burimit të mbetjeve jo vetëm nga njësi shërbimi dhe akomoduese por edhe nga familjarë.

Konsiderata teknike për tu pasur parasysh gjatë përllogaritjes të Kostos.

Parametrat e mëposhtëme janë përdorur për dizenjimin e shërbimit të ndarjes në burim dhe për vlerësimin e kostove që lidhen me shërbimin:

- Grumbullimi i plastikës dhe metalit do të organizohet në një kontenier të veçantë me kapacitet prej 1.1 $m^3$;
- Mbledhja e letrës dhe kartonit do të organizohet në një kontenier të veçantë me kapacitet prej 1.1 $m^3$;
- Do të nevojiten automjete të reja me mekanizëm ngarkimi dhe ngjeshje dhe kapacitet ngarkese prej 7.2 ton;

projekteve është futja e metodave të modernizuara për menaxhimin e mbetjeve bashkiake në bashkitë partnere dhe posaçërisht për zhvillimin dhe zbatimin e masave për ndarjen në burim.

Analiza aktuale shqyrton opsionet për futjen e ndarjes në burim të materialeve të thata të riciklueshme dhe trajtimin pasues në qendrën bashkiake të riciklimit.

Qendra e grumbullimit të materialit të riciklueshëm do të pranojë vetëm materiale të ndara në burim, të cilat përfshijnë:

- Plastikë (shishe PET, HDPE dhe LDPE)
- Karton dhe letër
- Metal (kanaçe)

Në këtë fazë, qelqi nuk do të ndahet në burim për shkak të mungesës së kërkesës dhe mungesës së një njësie për trajtimin e qelqit në vend. Sapo ky treg të jetë gati, qelqi mund të fillojë të mblidhet në burim dhe të ruhet në Qendër për përdorim të mëtejshëm. Analiza duhet të marrë në konsideratë një infrastrukturë pilot për tu ngritur në qytet ose njësi administrative në varësi të territorit që do caktohet pilot me mbështetje financiare përkatëse, me mjete: një kamion të posaçëm për mbledhjen e materialeve të ndara në burim dhe koshat 240litra, koshat 120litra, kontenierë rrjeta teli për shishet e plastikës, dhe koshat rrugorë 30-50 litra.

Metodologjia për hartimin e opsioneve të ndarjes në burim është e bazuar në supozimet e mëposhtme :

- Sasitë e mbetjeve të krijuara nga Bashkia Shkodër;
- Përbërja e mbetjeve në Bashkinë Shkodër;
- Ndryshimet sezonale të gjenerimit të mbetjeve për shkak të turizmit;
- Madhësia dhe numri i kontenierëve për ruajtjen e mbetjeve të planifikuara për territorin;
- Madhësia dhe lloji i automjetit grumbullues ;
- Vendndodhja e Qendrës të materialeve të riciklueshme.

Propozohen tre opsione si mëposhtë për ndarjen në burim të materialeve të thata të riciklueshme:

- **Opsioni 1**. Mbledhja e materialeve të riciklueshme nga hotelet dhe restorantet;
- **Opsioni 2**. Mbledhja e materialeve të riciklueshme nga restorantet dhe tregjet;
- **Opsioni 3**. Mbledhja e materialeve të riciklueshme nga të gjitha burimet;

*<u>Opsioni 1</u>* synon mbledhjen e veçantë të materialeve të riciklueshme të thata nga hotelet dhe restorantet gjatë muajve të pikut turistik (Qershor - Shtator). Dhomat, apartamentet dhe shtëpitë me qira përjashtohen për shkak të disa konsideratave:

- Dhoma dhe apartamente me qira janë në mënyrë tipike në ndërtesa/pallate dhe për rrjedhojë i nxjerrin mbetjet në kazanët publik që çon në ndotjen e materialit të thatë;
- Hotelet zakonisht akomodojnë një numër të madh turistësh dhe gjenerojnë mbetje mjaft të pastra të riciklueshme;
- Shtëpitë e marra me qira zakonisht akomodojnë një numër të vogël turistësh dhe do të kërkojnë një lloj mbledhje të veçantë derë më derë, e cila do të rrisë kostot e shërbimit.

*Opsioni 2* synon ndarjen në burim nga tregjet që veprojnë gjatë gjithë vitit dhe baret / restorantet.

*Opsioni 3* shqyrton mundësinë për të siguruar shërbim të veçantë për grumbullimin e mbetjeve gjatë gjithë vitit. Shërbimi do të synojë të gjitha familjet, institucionet dhe bizneset në Bashki.

Bashkia me anë të studimit të fizibilitetit duhet të analizojë të treja opsionet e mbledhjes të mbetjeve të ricikluershme duke përllogaritur koston dhe potencialin e të ardhurave.

TË DHËNA TEKNIKE

Parametrat e mëposhtëm janë përdorur për konceptimin e shërbimit të ndarjes në burim dhe për vlerësimin e kostove që lidhen me shërbimin:

- Numri i kontenierëve dhe automjeteve bazohet në pajisjet e siguruara tashmë dhe të parashikuara për t'u furnizuar;
- Dendësia e materialeve në kontenierët për mbledhjen e letrës dhe kartonit supozohet të jetë 0.075 ton / $m^3$;
- Dendësia e plastikës dhe kanaçeve në kontenierë supozohet të jetë 0.030 ton / $m^3$;
- Kontenierët prej 240 l dhe 120 l do të përdoren vetëm për ndarjen në burim të plastikës dhe metalit. Densiteti i materialeve në këto kontejnerë është 0.020 dhe 0.015ton / $m^3$ përkatësisht;
- Mbushjen mesatare e kontenierit është supozuar të jetë 85%;
- Mbushja mesatare e kamionëve të grumbullimit supozohet të jetë 75%;
- Koha për ngarkimin është vlerësuar në 0.5 minutë mesatarisht për njësi;
- Shpejtësia e udhëtimit të kamionëve të grumbullimit për në objekt riciklimi supozohet të jetë 25 km / orë;
- Shpenzimet e mirëmbajtjes të kamionit janë vlerësuar në 5% të kostove të tyre të investimeve;
- Kostot e mirëmbajtjes për kontenierët vlerësohen në 1% të kostove të tyre të investimit.

Si një ide e përgjithshme për hapat që duhet të ndërmerrjen në studim dhe në përzgjedhjen e opsionit më optimal, ndajmë me ju shembullin sa më poshte:

### 15.1.1. OPSIONI 1. MBETJET E GJENERUARA NGA TURISTËT NË HOTELE DHE RESTORANTE

Bashkia Shkodër, si i gjithë vendi ynë po përson një bum turistik me rritjen nga viti në vit të vizitorëve nga Thethi në Velipojë. Studimet dhe strategjia Kombëtare e turizmit shprehet me shifra positive në numrin e pushuesve që Shkodra do të ketë këto pesë vite dhe me rritjen e kapaciteteve akomoduese do të vihet re edhe një gjenerim më i shtuar i mbetjeve . Kjo bën që të detyrojë NJQV për të ndërmarre masa që mos të kthehet një problem pastërtia e gjithë territorit të Bashkisë por të synojmë që të trajtojmë sa më shumë mbetjet e gjeneruara.

Bashkia ndërton të dhëna mbi numërin e vizitave dhe qëndrimeve turistike sipas një metodologjie pjesë e studimit të fizibilitetit, për të matur koston e zbatimit të mbledhjes të mbetjeve të ricikluershme nga burimi në zonat me destinacion turizmin si më poshtë :

- Hotelet dhe Restorantet në Shirokë +hotelet dhe restorantet në dy pedonalet e qytetit;
- Hotelet dhe restorantete në Velipojë;

- Dendësia e materialeve në kontejnerët 1.1m$^3$ për mbledhjen e kanaçeve plastike dhe metalike supozohet të jetë 0.1 ton / m$^3$ ;
- Dendësia e materialeve në 1.1 m$^3$ për mbledhjen e letrës dhe kartonit supozohet të jetë 0.15 ton / m$^3$ ;
- Mbushja mesatare e kontenier është supozuar të jetë 85% ;
- Mbushja mesatare e kamionëve të grumbullimit supozohet të jetë 90% ;
- Koha për ngarkimin e kontenierëve të ndryshëm është vlerësuar në 0.5 minuta për kontenier mesatarisht ;
- Shpejtësia e udhëtimit të kamionëve të grumbullimit në Qendër supozohet të jetë 25 km / orë;
- Shpenzimet e mirëmbajtjes për kamionin janë vlerësuar në 5% të kostove të investimit;
- Kostot e mirëmbajtjes për kontejnerët vlerësohen në 1% të kostove të investimit;
- 

**<u>Për këtë opsion përcaktohen dhe përllogariten:</u>**

- NumrI I kontenierëve dhe automjeteve të nevojshme për mbledhjen e mbetjeve të ndara;
- Numri i kontenierëve të nevojshme është vlerësuar në bazë të frekuencës së grumbullimit në një herë në javë, ose 52 herë në vit;
- ngarkesën e punës së kamionit mbledhës;
- kosto për njësi për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve supozuar për këtë opsion;
- Kostot për njësi për mjetet për grumbullimin e vecuar të mbetjeve;
- Vlerësohet kosto dhe potenciali i të ardhurave;

Kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes (O&M) përfshijnë kostot për personelin, karburantin, vajin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Kostot vjetore përfshijnë kostot O&M dhe kostot për amortizimin vjetor të kontenierëve dhe automjeteve. Amortizimi për kontenierët vlerësohet në 7 vjet; amortizimi vjetor i kamionëve për mbledhjen e mbetjeve vlerësohet në 10 vjet.

Opsioni 3 parashikon pajisje shtesë, kamion shtesë dhe kontenierë, të cilët supozohet se do të prokurohen nga Bashkia. Prandaj, kostot e amortizimit për pajisjet janë përfshirë në strukturën e përgjithshme të kostove.

Duhet të theksohet se llogaritja e materialeve riciklueshme nga familjet dhe bizneset e tjera (p.sh. përveç hoteleve) bazohet në supozimin se vetëm 30% e materialeve të riciklueshme të disponueshme do të mblidhen. Kjo është për shkak të faktit se "sistemet e dorëzimit të materialit", megjithëse më pak të kushtueshme se "sistemet derë më derë", zakonisht çojnë në sasi relativisht të ulëta të materialeve të mbledhura veçmas.Për këtë është më efikase të mblidhen mbetjet e ndara në burim në zona ku aplikohet mbledhja derë më derë.

Në fund bëhet krahasimi i kostove dhe tre opsioneve të analizuara.

Do të jetë detyrë e Bashkisë Shkodër në vijim për të përllogaritur kostot e tre opsioneve dhe potencialin për të ardhurat e pritshme të shitjeve të mbetjeve të riciklueshme nga Bashkia Shkodër. Jemi në fazen ku Bashkia do të përzgjedhë një vendodhje për instalimin e Pikës të rekuperimit të materialeve të riciklueshme. Këto do të përfshihen në objektivat afatshkurtër dhe afatmesme të Bashkisë, ndërsa ndër objektivat afat gjatë Bashkia do të duhet ta ketë të ngritur qendrën e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme dhe do të duhet të ketë ngritur skemën e shitjes të materialeve riciklueshe.

## 16. SKEMAT E PROPOZUARA PËR PILOTIMIN E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME

**Situata e përgjithshme**

Bashkia Shkodër është në një situatë që pikat e grumbullimit të mbetjeve të shpërndara nëpër qytet, ngarkohen me mbetjet letër dhe karton, mbledhësit informalë ndërhyjnë në pikat e grumbullimit dhe ndotin zonat përreth duke nxjerë nga PGM'të mbetje metali kanace alumin etj.

Foto Nr.5 Mbetje të kartonit në pikat e grumbullimit




Foto Nr.6

Studimi i fizibilitetit për zbatimin e tre opsioneve te riciklimit sa më sipër kërkon kohën e vet, dhe cfarë mund të bëjë Bashkia Shkodër për ta realizuar sa më parë?!

- Në radhë të parë duhet të përcaktojë një pikë për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe të nisi procedurat për lejet përkatëse nga Institucionet qëndrore.
- Së dyti është e rëndësishme që pilotimin e grumbullimit të mbetjeve ta realizojë menjëherë në zona ku realizohet nga Bashkia/Operatori grumbullimi derë më derë. Kjo skemë është testuar dhe po vazhdon të zbatohet suksesshëm, dhe grumbullimi i mbetjeve të ricikluara nuk do të bëjë gje tjetër vecse me të njëjtin fond të realizojë mbetjen e ndarë në burim nga njësitë akomoduese dhe njësitë e shërbimit duke alternuar oraret e mbledhjes të mbetjeve organike dhe të riciklueshme.
- Si më poshtë përcaktojmë kostot e realizimit të mbetjeve të riciklueshme për zonat ku mblidhen mbetjet derë më derë:

  1.Plazh Velipojë ( qendër );
  2.Dy pedonalet e qytetit të Shkodrës;
  3.Skema e propozuar për mbledhje derë më derë në Shirokë.

Bashkia Shkodër në këtë proces ka një avantazh më shumë për arsye të realizimit aktual të mbledhjes derë më derë të mbetjeve në dy zona me destinacion turizmin, plani propozon një zonë të re që në pa mundësi të jetë zë i kontratës aktuale për dy vite, realizohet me anë të Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike . Këto zona i shërbejnë Bashkisë Shkdoër për të pilotuar sistemin e mbledhjes të mbetjeve të riciklueshme, do të kursejë në depozitimin e mbetjeve në lendfill dhe për më tepër zbaton Rregulloren e miratur të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe nis ndërgjegjësimin e biznesit

dhe popullatës për domosdoshmërinë e ndarjes në burim të mbetjeve me anë të strategjisë të komunikimit të ndërtuar dhe zbatuar tashmë suksesshmën nga struktura e medias në Bashkinë Shkodër.

- Zona e mbledhjes derë më derë në Nj.a Velipojë ( Plazh, zona e qendrës);
- Zona e mbledhjes derë më derë në të dyja pedonalet e qytetit;
- Zona e propozuar për skemën e mbledhjes derë më derë në Shirokë,nja. Shkodër.

## 16.1. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË NJA VELIPOJË

Në kuadër të përmirësimit të Shërbimit të Menaxhimit të Mbetjeve në NJA Velipojë, Bashkia Shkodër me mbështetjen e projektit BtF, Helvetas dhe asistencës së ekspertizës nga EcoDES Consultancy, u angazhua për riorganizimin e skemës të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në NJA Velipojë, të ndjekur nga një fushatë ndërgjegjësimi me komunitetin e bizneseve në qendrën e Velipojës, si dhe promovimin e grumbullimit të veçantë të shisheve plastike në koshat metalike të shpërndarë në zonën e qendrës.

Fushata e ndërgjegjesimit kërkoi ti paraprijë procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës dhe kartonit në të gjithë territorin duke realizuar mbledhjen e plastikës përgjatë gjithë pedonales nga pushues të zonës vecanërisht nga ata që frekuentojnë beach baret dhe plazhet private-e publike. Me realizimine ndarjes te plastikës dhe kartonit edh enë njësitë tregëtare të mëdha në të gjithë territorin e plazhit do të bëjë të mundur uljen e tonazhit të mbetjeve që depozitohen në lendfilline Bushatit si edhe uljen e ngarkesës në pikat e grumbullimit. Kërkohet që me përzgjedhjen e një nga skenarëve të zvoglohen deri në reduktim pikat e grumbullimit në qendër të plazhit, pika të cilat gjatë gjithë kohës kanë qenë të mbytura me mbeturina duke shkatuar kështu ndotje të plazhit dhe një ambient aspak të këndshëm për turistët që frekunetojnë plazhin e velipojës.

Kjo iniciativë filloi në muajin Korrik dhe zgjati deri në muajin Shtator. Si fillim, u organizuan disa takime me Kryetarin e Bashkisë Shkodër dhe specialistët e shërbimeve publike, ku u përcaktua nevoja për ndërhyrjen në skemën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në NJA Velipojë. Më pas grupi i punës i EcoDES Consultancy, specialistët e shërbimit të Bashkisë Shkodër dhe administratori i NJA Velipojë zhvilluan takime në terren, ku u hodhen në sistemin GIS të gjitha pikat ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve (PGM). Puna më pas u kanalizua në dy momente të ndryshme:

i) si fillim u zhvilluan skenarët e mundshëm për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në territorin e NJA Velipojë, duke i kushtuar rëndësi pjesës turistike, të cilët u kostuan;

ii) u hartua dhe u zhvillua fushata e ndërgjegjësimit, e cila konsistoi në hartimin dhe zhvillimin e një pyetësori me bizneset në qendrën e Velipojës dhe shpërndarja e materialeve informuese.

Foto Nr.7 : Koshat për mbetjet plastike në plazhin e Velipojës



VELIPOJA RICIKLON

Të dhëna nga grumbullimi i plastikës :

Për një muaj, në muajin gusht, 8 koshat e mbledhjes të plasikës të shpërndarë nëpër pedonale u mbushën me 440 kg. Koshat u vendosën në pedonale pranë stacioneve të plazhit me qëllim jo vetëm ndarjen e plastikës dhe mbledhjen e disiplinuar, por edhe uljen e volumeve të koshave të rërës duke mbajtur pastër stacionet e plazhit të vijës bregdetare. U vu re një ndërgjegjësim i shtuar i frekuentuesve të plazhit të velipojës për arsye se koshat kishin vetëm shishe plastike sic edhe kërkohej nga materialet promovuese të fushatës të ndërgjegjësimit. Mbetet të studiohet tregu për të parë nëse në të ardhmen është e mundur të motivohen iniciativa të tilla riciklimi për plastikën/kartonat ose alumini, për njësitë tregtare ddhe stacionet e plazhit.

Nga të dhënat e disponueshme, për zonën e plazhit në velipojë, parashikohet një normë gjenerimi mbetjesh prej 16.9 ton /ditë në 110 diteshin e sezonit dhe 1856 ton në total gjatë gjithë sezonit. Sic edhe cituam më sipër do të marrim parasysh zonën 3 të territorit që merr shërbim në plazhin velipojë sipas kontratës, duke marrë parasysh që ka një përqendrim të lartë tregëtar dhe shërbimin e grumbullimit të mbetjeve me metodën derë më derë.

Duke marrë parasysh tonazhin e mbetjeve të grumbulluara në zonën 3, sipas studimit 25% janë të llogaritur si mbetje të riciklueshme , vetëm në këtë zonë mbidhen deri në 450 ton mbetje të riciklueshme për 110 ditë. Nëse nga Bashkia do të merret përsipër edhe zona 2 atëherë do të kemi mbledhur rreth 1000 ton mbetje të riciklueshme.

| Zona Përendimore (Velipojë Plazh) | Ton/110 ditë Zona 3 | |
|---|---|---|
| plastike | 119 | 122 |
| leter/karton | 78 | 81 |
| kanace | 34 | 37 |
| TOTALI | 231 | 240 |

Parashikimi i volumeve ka marrë në konsideratë koeficientit për banor 0.8 meqënëse është zonë tursitike .

Zona 3 është caktuar zonë pa kontenierë sepse do të aplikohet sistemi i mbledhjes derë më derë i mbetjeve urbane.Ne zonën Velipojë-Plazh, distanca e përshkuar për grumbullimin e mbetjeve për grumbullimin e mbetjeve derë më derë është 5 km.

Meqenëse është caktuar që në këtë zonë me sherbimin derë më derë, frekuenca do jetë dy herë në ditë, turni parë rreth orës 06.00-9.00 dhe turni dytë rreth orës 15.00-18.00, mund të shihet mundësia që të caktohet një orar për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe një për mbetjet organike, të gjitha me qese, për të dorëzuar mbetjet tek punëtorët e shërbimit që shoqërojnë mjetin teknologjik 5 ton. Totali i volumit ditor të gjeneruar përkon me totalin e volumit të përllogaritur për tu mbledur në dy oraret e caktuar për grumbullimin derë më derë. Oraret e turneve mund të ndryshohen me kërkesë dhe me miratim dypalësh, për t'ju përshtatur sa më mirë banorëve të cilëve do t'i ofrohet shërbimi. Koha qe i duhet mjetit për të kryer një grumbullim plotësisht derë më derë është 2 orë. Është shumë e rëndësishme që meqenëse ky system i ri i grumbullimit vjen si risi për zonën e plazhit të Velipojës, edhe mbas një fushate ndërgjegjësimi, mjetit teknologjik qe do te realizojë skemën e mbledhjes derë më derë i nevojitet një gramafon për njoftimin e ardhjes të mjetit për marrjen e mbetjeve në rrugët e caktuara nga Bashkia. Eshte llogaritur qe njësitë të cilave do i ofrohet shërbimi do pajisen me qese plastike 120L, të parashikuara për cdo muaj të parë të nisjes të sezonit. Kjo do të shërbejë edhe si ndërgjegjësim për gjeneruesit e mbetjeve se si duhet të veprojnë me dorëzimin e mbetjeve në orar sipas një rregulli të caktuar. Në përllogaritjen e kostos është llogaritur një fond i vecantë për ndërgjegjësimin dhe stafin e operatorit që do të duhet të ndjekë me rigorozitet këtë proces.

Një punonjës monitorues i zonës do të jetë përgjegjës për gjithcka ndodh në terren në këto 110 ditë sezoni turistik. Punonjësi do të duhet të japë kontaktet bashkisë Shkodër dhe administratës të njësisë administrative Velipojë në formën e nje shkrese sipas përcaktive në kontratën dy palëshe. Monitorimi nga ana e Bashkisë do të realizohet me anë të administratës të njësisë administrative Velipojë dhe Monitoruesit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, përcaktuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, me detyrat përcaktuar në PSV e administrimit të shërbimit të pastrimit.

## 16.2. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË ZONËN QËNDRORË – PEDONALE

Në Nj.A Shkodër praktikohet susksesshëm grumbullimi dërë më derë në të dyja pedonalet e qytetit. Kjo metode sherbimi do vazhdoje te perdoret ne zonat me fluks turistesh dhe në pa mundësi të pozicionohen kontenierë për shkak të zhvillimit që ka zona.

Në të dyja pedonalet e qendrës, sherbimi i grumbullimit të mbetjeve realizohet dere-me-dere me kamioncine vetshkarkuese 3-5 ton, 1 here ne dite, per 365 dite ne vit.

| Zona Qendrore pedonalet | Ton/vit |
|---|---|
| plastike | 36.6 |
| leter/karton | 23.9 |
| kanace | 10.2 |
| TOTAL | 70.7 |

Eshte parashikuar qe shërbimi të kyhet me mjet tip kamioncin. Mjeti kamioncin do te jete ne levizje per 6 ore, duke ecur perpara me nje shpejtesi jo me te shume se 2km/h. Rekomandohet të përzgjidhet

edhe kjo zonë për grumbullimin e mbetjeve të ricikluesħme për shkak së te gjithe bizneset dhe familjaret te cilet perfitojne nga ky sherbim jane te instruktuar nga Bashkia Shkoder për mënyrën se si dhe kur duhet të dorëzojnë mbetjete tek mjeti dhe punëotrët e shërbimit. Keto qese do merren nga dy punetoret e sherbimit dhe hidhen ne kamioncine, pa ndalesa. Sherbimi i mbledhjes dere-me-dere do realizohet gjate oreve 10:00-18:00, duke variuar sipas stines.

Meqenëse ky mjet do jetë në qarkullim për gjashtë orë dhe kosto është llogaritur në këtë mënyrë atëherë do të merret parasysh që mjeti të përdoret edhe për grumbullimin e mbetjeve të ricikluesħme. Rekomandohen tre herë në jave të mblidhen mbetjete e ricikluesħme dhe katër herë në javë të mblidhen mbetjet organike. Në kontratën aktuale që Bashkia shkodër e ka me operatorin privat shërbimin e pastrimti të nj.a Shkodër zona qëndrore ka parashikuar edhe këtë skemë grumbullimi, sipas kapitullit **1.3 frekuencat e grumbullimit pika d:** *Kjo menyre e mbledhjes se mbetjeve i sherben Bashkise Shkoder, si pikenisje per te nisur ne nje moment te dyte (me krijimin e qendres se multigrumbullimit) edhe ndarjen/mbledhjen ne burim te mbetjeve te ricikluesħme. Mbledhja e mbetjeve me qese dere-me-dere pasqyron nje performance te larte te menaxhimit te mbetjeve pasi reduktohen PGM-te e ndotura ne zonat qendrore dhe turistike te qytetit.*

## 16.3. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE TË RICIKLUESHME NË ZONËN E SHIROKËS

...

---

## 16.4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Mbi grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ricikluesħme në tre zonat e propozuara :

Rekomandojmë që Bashkia Shkodër ta realizojë brënda dy vitesh pilotimin e grumbullimit të mbetjeve të ndara në zonën 3 të zonës perëndimore ku realizohet skema e grumbullimit derë më derë.

- Nëse kjo skemë zbatohet vecmas jo e përfshirë në kontratë ( në përfundim të kontratës), ose nëse numëri i turistëve kalon 20% dhe gjenerimi I mbetjeve kalon parashikimet, kosto e grumbullimit dhe transportit me anë të ndërmarrjes publike/operator privat llogaritet si më poshtë :

| Kosto: Riciklimi ne Zonen Perendimore | | Kosto me TVSH |
|---|---|---|
| Zona 3 ( riciklimi) | O&M | 2,398,849 Lek |
| | O&M totale | 2,398,849 Lek |
| Zona 3 ( riciklimi) | Kosto investimi (makina) | 3,969,600 Lek |
| | Kosto totale investimi | 3,969,600 Lek |
| Zona Perendimore | Kosto totale - vjetore | 5,307,041 Lek |

| | Nr. Makina | Tonazhi | Turnet | Qese | Sasia vjetore e mbetjeve (ton/sezon) | Sasia ditore e mbetjeve (ton/ditë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zona 3 ( riciklimi) 110 dite | 1.0 | 5 | 1 | 8800 | 231 | 2.10 |
| Totali | | | | | 231 | 2.10 |

Kosto e investimit shkon nëse Bashkia do të ketë nevojë të blejë mjetin 5 ton. Ndërkohë në kontratë janë përcaktuar edh eblerjet e qeseve për të mbuluar grumbullimin derë më derë në mënyrë efikase dhe për ti ndërgjegjësuar banorët dhe turistët mbi mënyrën se si duhet të dorëzojnë mbetjet tek punëtorët e shërbimit. Nëse Bashkia e bën vetë shërbimin jashtë periudhës të kontratës do ti kushtojë për grumbullimin dhe transportin 1,759,155.75.

Me realizimin e skemës të grumbullimit të mbetjevetë riciklueshme Bashkia Shkodër kursen nga pagesa e lendfillit të Bushatit, minimalisht 415,800 lekë me tvsh dhe nëse për dy vite zbaton grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme barra financiare që I ulet është min 831,600 lekë me tvsh.

Nëse për Bashkinë Shkodër mbas dy viteve do të jetë realizuar edhe ndërtimi I qendrës të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme me shitjen e mbetjeve të riciklueshme.

Zona Qëndrore

| Kosto: Riciklimi ne Zonen Qendrore (Pedonalet 13 dhjetori dhe Kol Idromeno) | | Lekë me Tvsh |
|---|---|---|
| Zona 3 ( riciklimi) | O&M | 1,583,052 |
| | O&M totale | 1,583,052 |
| Realizuar nga Bashkia | | 1,160,905 |
| Zona 3 ( riciklimi) | Kosto investimi (makina) | 1,100,000 |
| | Kosto totale investimi | 1,100,000 |
| ZonaQëndrore /operatori | Kosto totale - vjetore | 2,683,052 |

| | | |
|---|---|---|
| ZonaQëndrore /Bashkia | Kosto totale - vjetore | 2,260,905 |

| | Nr. Makin a | Tonazhi | Turnet | Qese | Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit) | Sasia ditore e mbetjeve (ton/ditë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Zona 3 ( riciklimi) 182 dite | 1 | 3-5 ton | 1 | 3900 | 70 | 0.38 |
| Totali | | | | | 70 | 0.38 |

Me skemën e grumbullimit derë më derë në pedonale, Bashkia nuk ka kosto shtesë pasi sic thamë edh emë sipër për gjashtë orë që është përllogaritur kjo kosto operatori ka kohën e mjaftueshme që të zbatojë frekuencat e grumbullimit edhe të mbetjeve të ricikueshme nga të dy pedonalet,sipas planit të miratuar nga AK Bashkia Shkodër . Tabela përmbledhëse paraqet edhe masën e uljes të barrës financiare nga ulja e volumit të mbetjeve të riciklueshme në këtë zonë.

Kosto e investimit është llogaritur nëse shërbimi realizohet nga Bashkia me një mjet 3 ton vetëm për mbetjet e riciklueshme. Kosto më sipër është llogaritur nëse realizohet nga operatori dhe nga Bashkia.

Meqenëse kemi edhe një skem ëtjetër Grumbullimi që e propozojmë për zbatim atë të grumbullimkit të mbetjeve me metodën derë më derë në Shirokë, mund të bëjmë bashkë të dy zonat shirokën dhe pedonalet me mjetin 5 ton. Edhe për shirokën duhet të përcaktohet mbledhja derë më derë tre herë në javë sic është përcaktuar edh epër pedonalen . Frekuencat duhet të dakordsohen me grupet e interesit të miratohen nga AK dhe të kalojnë ëpr miratim si amendament të Rregullores të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane për Bashkinë Shkodër.

Kemi marrë parasysh nga të dy skenarët e propozuar për shirokën skenarin e 2 me grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme derë më derë 70% të banorëve dhe 100 bizneseve në zonë. Por nëse do të realizohet skenari me të dy skemat mbledhjen derë me derë të mbetjeve organike dhe të ricikluar, me qëllim realizimin e duhur të iniciativës të ndërmarrë nga bashkia propozojmë që nga katër herë në javë për tre muaj grumbullimi I mbetjeve të realizohet cdo ditë në shirokë edhe për muajt janar shkurt dhe nëntor dhe jo katër herë në javë por gjatë shërbimit vetëm tre herë në javë do të realizohet grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme.

**Zon Qendrore / Shiroke**

| | Ton/Year |
|---|---|
| plastike | 36.8 |
| leter/karton | 19.2 |
| kanace | 10 |
| TOTAL | 66 |

Kosto ndryson si më poshtë llogaritur :

Zona I (30% e popullsisë ekuivalente )

30% e banorëve ekuivalentë (frekuenca e grumbullimit cdo dite/ mbetjet organike katër herë në javë dhe mbetjet e ricikIueshme tre herë në javë )

| Kosto Zona I | | Me TVSH |
|---|---|---|
| Zona 1 | O&M | 2,696,173.20 lekë |
| | O&M totale | 2,696,173.20 lekë |
| Zona 1 (grumbullim mbetje organike+mbetje te ricikIueshme) | Kosto investimi (kontenier 240 liter +makina) | 266,400.0 Lekë |
| | Kosto totale investimi | 266,400.0 Lekë |
| Zona e Shirokës | Kosto totale - vjetore | 2,962,573.2 Lekë |

| | Nr. Qesesh | Nr. Makina | Tonazhi | Sasia ditore e mbetjeve (ton/ditë) |
|---|---|---|---|---|
| Zona I (9 muaj) - 252 ditë) | 3,629 | 1 | 3 | 0.2 |
| Totali | | | | 0.2 |

Rekomandohet që të përdoret mjeti 5 ton nëse për dy vite do të realizohet nga operatori sipërmarrës dhe nëse do të realizohet nga bashkia mjeti 3 ton .

| Mbetjet e riciklueshme | Zona 3 | Zona qendrore | TOTAL |
|---|---|---|---|
| plastike | 119 ton | 73.4 ton | 192.4 ton |
| leter/karton | 78 ton | 43.1 ton | 121.1 ton |
| kanace | 34 ton | 20.2 ton | 54.2 ton |
| TOTALI | 231 ton | 136.7 ton | 367.7 ton |
| Shmangia e pagesës në lendfill | 415,800 lekë me tvsh | 246,060 lekë me tvsh | 661,860 lekë me tvsh |
| Të ardhurat e pritshme nga shitja e materialeve | 3,459,391 lekë me tvsh | 2,091,963 lekë me tvsh | 5,551,354 lekë me tvsh |
| TOTAL | 3,875,191 lekë me tvsh | 2,338,023 lekë me tvsh | 6,213,214 lekë me tvsh |
| Kosto e shërbimit | 2,398,849 lekë me tvsh | 4,279,225.20 lekë me tvsh | 6,678,074 lekë me tvsh |

Me analizën kosto-përfitim, llogariten kostot e shërbimit për grumbullimin transportin dhe trajtimin e mbetjeve të riciklueshme, dhe përfitimet jo vetëm ekonomike por edhe sociale dhe mjedisore me realizimin dhe ndërmarrjen e iniciativës të ndarjes në burim të mbetjeve te riciklueshme dhe trajtimin e tyre. Ndërkohë që llogaritjes të shpenzimit të munguar (kursimit ) që bashkia do ët ketë mbas mbledhjes të mbetjeve të riciklueshme i shtohet edhe llogaritja e të ardhurave të pritshme nga shitja e materialeve të riciklueshme, sipas studimit të tregut për cdo material.

Për të gjitha opsionet, të ardhurat e pritshme nga shitja e materialeve të riciklueshme nuk do të jenë në gjendje të mbulojnë kostot operacionale për ndarjen e burimit. Sidoqoftë, kostot për ndarjen e burimit do të mund të rikuperohen, në një masë të madhe, përmes:

- Kursimet nga tarifat e depozitimit;
- Kosto të reduktuara për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve të mbetura.

Duke llogaritur tonazhin të parashikuar të mbetjeve që nuk shkojnë në lendfill me ndërmarrjen e hapave sa më sipër Bashkia Shkodër kursen 661,860 lekë me tvsh/vit.

Pasi Bashkia ka testuar skemën e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme në një periudhë afat shkurtër 1 deri në 2 vite, që përkojnë edhe me kontratat aktuale, dhe Qëndra e grumbullimit është plotësisht funksionale, bashkia në një periudhë afatmesme 3- 5 vite punë përllogarit koston, buxheton dhe parashikon realizimin e një nga tre opsionet e paraqitur sa më sipër.

Opsioni 2 i përmendur më lart është më i realizueshëm për Bashkinë, i cili ka të bëjë me futjen e ndarjes në burim të 3 rrymave të materialit të riciklueshëm (plastikë, letër / karton dhe metale) nga restorantet / baret dhe supermarketet e mëdhenj. Kur ky sistem të ngrihet dhe Qendra të jetë plotësisht funksionale (parashikohet në një periudhë afat mesme si një fazë e dytë), Bashkia Shkodër mbas 5 viteve mund të zgjerojë sistemin për të mbuluar më shumë tregje dhe restorante dhe për të përfshirë hotele, ose me fjalë të tjera të mund të kalohet në Opsionin 1. Kjo do të kërkojë investime shtesë në pajisjet e grumbullimit të mbetjeve, gjithmonë në vartësi të buxhetit që Bashkia Shkodër ka në dispozicion.

Opsioni 3 nuk rekomandohet në këtë fazë edhe për shkak të një faktori tjetër madhor, një pjesë nga të qenit opsionin më i shtrenjtë dhe më shumë nevoja kapitale. Kontenierët do të përmbajnë mbetje të përziera bashkiake, të cilat do të duhet të klasifikohen paraprakisht nga fraksionet e ricikluesshme të synuara. Për më tepër, Opsioni 3 do të kërkojë një program të gjerë të ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së publikut për të siguruar pjesëmarrjen e banorëve.

## 17. QENDRA E GRUMBULLIMIT TË MATERIALEVE TË RICIKLUESHME

Për përcaktimin e qendrës të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme duhe të përzgjidhet opsioni më i mirë dhe optimal nga 3-5 opsione që Bashkia Shkodër ka, në pronë të Bashkisë Shkodër ose në process të kalimit të pronësisë për shërbime në dobi të komunitetit dhe mjedisit. Qendra duhet të ndodhet jo larg zonave funksionale në një terriotr të përshtatshëm ku të jetë I aksesueshëm më të gjitha zonat ku do të tentohet te ketë grumbullim të mbeturinave të riciklueshme. Opsioni më I mirë mund të jetë në zonën perëndimore pranë njësisë administrative Velipojë dhe në njësinë administrative Rrethina për zonën funksionale lindore ku ka më shumë akses edhe me qytetin e Shkodrës duke qenë se jemi duke parashikuar mbledhje të mbetjeve të riciklueshme në Tregje/Restorante në Qytet dhe Shirokë.

Sipërfaqja do të variojë nga 1000-3000 metra katror nëse do të ketë gumbullim mix të alternuar edhe me kompostim të mbetjeve të gjelbërta. Përndrsyhe nëse kemi të bëjmë vetëm me qendër të grumbullimit të mbetjeve 700 m2 është minimum duke pasur parasysh që Bashkia SHkodër gjeneron një volum të kosniderueshëm mbetjesh në vit. Qendra duhet të ketë sipërfae të mbuluar për të ruajtur mbetjet e letrës dhe kartonit nga 400-1000 m2 në vartësi të sasisë të mbetjeve dhe opsionit të përzgjedhur. Dizajni i qendrës parashikon pranimin e materialeve të pastra të ndara në burim.

Qendra është projektuar të pajiset me një presë, e cila do të kompaktojë materialet për transportin në objektet e riciklimit dhe një ngarkues pirun për ngritjen dhe vendosjen e materialit të paketuar, si dhe për ngarkimin e tyre në një kamion transporti.

Është e rëndësishme të theksojmë qëmeqënëse Bashkitë nuk I kanë burimet financiare të financojnë ndërtimin e qëndrave të këtij niveli në këtë plan për Bashkinë kemi përcaktuar skemën për të përllogaritur vetëm kostot Operative dhe mirmbajtes nga ana e Bashkisë O&M.

### 17.1 KOSTO INVESTIMI

Për informacion të grupeve të interesit, dhe strukturave drejtuese dhe ekzekutive të Bashkisë kemi marrë si shembull sa ka kushtuar një pikë riciklimi mbetjesh në Sarandë me një sipërfaqe 620m2:

| [illegible] | [illegible] | [illegible] |
|---|---|---|
| Kosto Ndertimi | 55,500 | 6,600,000 |
| Kosto pajisje | 135,000 | 16,200,000 |
| Kosto Administrative | 16,700 | 2,000,000 |
| Kosto O&M gjate ndertimit | 9,500 | 1,130,000 |
| Kosto Totale Investimi | 216,700 | 25,930,000 |

Për modelin e miksuar të një fushe kompostimi dhe riciklimi kosto e ndërtimit për një sipërfaqe të vogël është 4 **mln lekë** .

Ndërsa kosto e një fushe kompostimi më sipërfaqen 300m2 në Belsh ka kushtuar **6.1 mln lekë**.

### 17.1.1. KOSTO SHTESË E INVESTIMIT

Me ngritjen dhe ndërtimin e pikës të grumbullimit të mbetjeve të ricklueshme, Investimet e mëposhtme janë të rëndësishme për ngritjen dhe funksionimin e zyrës përkatëse për punëtorët si dhe mjeteve të mbrojtjes.

Kostot shtesë të investimeve

| [illegible] | [illegible] | [illegible] |
|---|---|---|
| Kontejner zyre | 10,000 | 1,230,000 |
| Mobilje | 1,000 | 12,000 |
| Seti i mbrojtjes nga zjarri | 500 | 61,500 |
| Totali shtesë i CAPEX | 11,500 | 1,414,500 |

## 17.2. KOSTO OPERIMI

Kostot e funksionimit vlerësohen bazuar në supozimet e mëposhtme:

- Personeli: Një punëtor i aftë do të mjaftojë për funksionimin e qendrës. Përgjegjësia e tij do të përfshijë operimin e presës dhe funksionimin e pirunit. Do të nevojiten dy staf shtesë për trajtimin e materialeve dhe për ruajtjen e Qendrës.
- Mirëmbajtja dhe riparimi. Kjo përfshin mirëmbajtjen e pajisjeve, vlerësuar në 10% të kostos së investimit.
- Të konsumueshme: Ky zë i kostos përfshin karburantin për pajisjet dhe kostot e ndryshme.
- Administrimi. Është vlerësuar si 5% e të gjithë zërave të tjerë të kostos dhe përfshin taksat dhe sigurimet.

Kostot operative të Qendrës /Vit

| Zërat Kostove | Vlera EUR | Vlera Lekë |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Personeli | 11,483 | 1,412,443 |
| Mirëmbajtja dhe riparimi | 1,130 | 138,990 |
| Të konsumueshme | 675 | 82,974 |
| Administrata | 995 | 122,417 |
| Kostot totale të O&M | 14,283 | 1,756,825 |

## 17.3. PËRMBLEDHJA E KOSTOVE

Skenari i rekomanduar përfshin:

- Zbatimi i ndarjes në burim në 3 rryma të riciklueshme (plastikë, letër / karton dhe metale) nga restorantet baret dhe supermarketet në territore me destinacion turizmin Velipojë) ;
- dhe dyqanet e mëdha në Qytetin e Shkodrës Shirokë Velipojë dhe opsionale Thethi, me fokus kyesor në sezonin Maj-Nëntor.
- Transporti në Qendër për përgatitje për shitje.

Kostot totale të zbatimit të skemës të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme në Bashkinë Sarandë ku destinacioni i këtij territori është turistik  janë paraqitur në tabelën më poshtë:

| Kostot totale të zbatimit | Vlera Euro | Vlera Lekë |
|---|---|---|
| O&M mbledhje të veçantë | 17,569 | 2,160,930 |
| Personeli | 2,279 | 280,348 |
| Mirëmbajtja | 3,515 | 432,345 |
| Të konsumueshme | 11,774 | 1,448,237 |
| Kostot O&M të Qendrës | 14,283 | 1,756,825 |
| Personeli | 11,483 | 1,412,443 |
| Mirëmbajtja | 1,130 | 138,990 |
| Të konsumueshme | 675 | 82,974 |
| Administrative | 995 | 122,417 |
| Kostot totale të O&M | 31,852 | 3,917,755 |
| Personeli | 13,763 | 1,692,791 |
| Mirëmbajtja | 4,645 | 571,335 |
| Të konsumueshme | 12,449 | 1,531,212 |
| Administrative | 995 | 122,417 |
| Kostot e investimit | 11,500 | 1,414,500 |
| Furnizime për mbledhje të veçantë | 0 | 0 |
| Furnizime për Qendrën | 11,500 | 1,414,500 |

Në rast të kostove sa më sipër dhe llogaritjes të ardhurave nga shitja e mbetjeve të ricikluueshme, me këto të dhëna dhe cmime kostot e zbatimit arrijnë në rreth **320 euro/ton** të materialeve të ricikluueshme të mbledhura. Të ardhurat e pritshme nga shitja e materialeve të ricikluueshme dhe kursimet nga tarifa e depozitimit në lendfillin e Bushatit, do të jenë në gjendje të mbulojnë **154 euro/ton** të ricikluueshëm, ose rreth **48%** të kostove.

Optimizimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve është një faktor vendimtar për të rritur rikuperimin e kostove të shërbimit të ndarjes në burim.

## 18. POLITIKAT E MBULIMIT TË KOSTOS NGA TË ARDHURAT DHE TARIFAT E PASTRIMIT

**Politika e mbulimit të kostos:** 'Mbulimi i kostos' përfshin një sistem tarifash dhe taksash, të cilat kanë si qëllim specifikisht të mbulojnë disa ose të gjitha kostot e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga përdoruesit e këtij shërbimi, në përputhje me principin "ndotësi – paguan". Avantazhet e sistemit të mbulimit të kostos qëndrojnë në faktin se të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbimit njihen me koston e plotë të tij, janë të përfshirë në mënyrë më të drejtëpërdrejtë me problemet e cilësisë së shërbimit, vlerësojnë peshën që merr pagesa e tarifës së tyre në mbledhjen e të ardhurave si dhe mundësitë reale të bashkive për t'i ofuar konsumatorëve këtë shërbim. Hartimi i politikave të mbulimit të kostos është përgjegjësi e bashkive dhe synon të përcaktojë nivelin e rikuperimit të kostos që duhet të arrihet për një periudhë të caktuar kohore, duke përcaktuar më parë:

- Llogaritjen e kostos së plotë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake;
- Planifikimin e buxhetit të bashkisë mbi këtë kosto;
- Përcaktimin e tarifave për kategoritë e ndryshme që përfitojnë shërbimin bazuar mbi nivelin e rikuperimit të kostos të përcaktuar;
- Procedurat e zbatimit dhe monitorimit.

Konkretisht bashkia duke analizuar gjendjen e saj mund të kuptojë se në cilat nga këto opsione ajo është aktualisht dhe ku ajo kërkon të shkojë, në sajë të objektivave që ajo do të vendosë:

- Kosto të pambuluara, kur të ardhurat janë më të ulta se shpenzimet direkte operative
- Parashikon vetëm mbulimin e kostove operative direkte dhe të mirëmbajtjes (KODM)
- Parashikon vetëm mbulimin e Kostos operative të depozitimit dhe mirëmbajtjes si dhe të interesit të kredisë së marrë për të përmirësuar shërbimin
- Parashikon të mbulojë KODM si dhe pagesën e kredisë dhe të interesave të marrë
- Parashikon mbulimin e KODM, interesin e kredisë, shpenzimet për amortizimin si dhe parashikimet për investime në periudhën afatgjatë
- Parashikon mbulimin e KODM të amortizimit (kosto kapitale dhe kthimin e investimeve) si dhe parashikimin e investimeve në periudhën afatgjatë (ose kosto marxhinale në terma afatgjatë) • Parashikon mbulimin e kostos marxhinale në terma afatgjatë plus kostot mjedisore (eksternalitetet) të shprehura mundësisht përmes taksës së asgjësimit në Landfill.

Megjithatë për të ndërtuar një politikë të qëndrueshme dhe mbi të gjitha të zbatueshme të rikuperimit apo mbulimit të plotë të kostos, bashkia ka nevojë për një bashkëpunim me nivelin qëndror të politikë bërjes. Kështu në nivelin qëndror duhet të zhvillohen standartet e ofrimit të shërbimit për të pasur një kuptim të përbashkët për të gjitha bashkitë për nivelin e ofrimit të shërbimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi procedura të standartizuara për monitorimin e shërbimit si dhe nivele të standartizuara

(klasa) të krahasueshme në ofrimin e tij. Gjithashtu duhet të hartohen guidat e reja të përgatitjes së buxhetit sipas "qëndrave të buxhetimit apo të kostos" për elemente të veçantë të shërbimit të mbetjeve (grumbullim, transport, riciklim, programe ndërgjegjësimi etj). Vetëm në këtë mënyrë bashkia do të ketë mundësi të njohë koston e plotë të shërbimit që ajo ofron.




Figure….. Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos

**Strategjia për vjeljen e tarifave:** Bazat për qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve të mbetjeve mund të arrihen nëpërmjet sigurimit të shërbimeve efektive dhe me kosto eficiente, si dhe me sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar të bazuar në një politikë të drejtë dhe efektive të rikuperimit të kostos. Aspektet financiare janë thelbësore për shërbimet dhe për qëndrueshmërinë. Performanca financiare është e lidhur me përmbushjen e objektivave mbi çështjet financiare dhe matet nëpërmjet disa treguesve financiarë që shqyrtohen përmes pyetjeve të mëposhtme:

- Sa i mbulon buxheti vjetor shpenzimet që rezultojnë nga nevojat (përkatësisht kostot kapitale, kostot operative, apo kostot e amortizimit)?
- Sa të ndryshme janë tarifat e miratuara në krahasim me ato që janë parashikuar në procesin e planifikimit?
- Sa mblidhen të ardhurat kundrejt planifikimit të tyre?
- Sa nga buxheti në përqindje mbulohet nga të ardhurat?
- Cili është raporti i mbulimit të shpenzimeve nga tarifat e mbetjeve dhe të ardhurave specifike të bashkisë?
- Sa të gatshëm janë konsumatorët (familjet, bizneset etj.) për të paguar për një shërbim më të mirë?

Bazuar në konstatimet teorike dhe praktike për strategjinë e vjeljes së tarifës dhe politikës për mbulimin e kostos së shërbimit, në figurën më poshtë jepet skematikisht struktura që duhet të ngrihet dhe konsolidohet nga bashkia për grumbullimin e tarifës dhe rritjen e nivelit të grumbullimit:

## 18.1. FINANCIMI

Është e ditur që financimi i projekteve të ndarjes në burim të mbetjeve për incentivimin e metaodave të kompostimit riciklimit apo rekuperimit të materialeve, për më tepër zbatimin e politikave të Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve duke ndërmarrë iniciativa me qëllim kalimin nga ekonomi linerare në ekononinë qarkulluese të përdorimit të mbetjeve si nëj e mirë materiale për Bashkitë kërkon financime që e kalon mundësitë e Bashkisë Shkodër për financim.

Me qëllim përfitimin e mundësive të financimit të projekteve të tilla që ndihmojnë në uljen e barrës financiare të Bashkisë për grumbullimin transportin dhe depozitimin e mbetjeve, duke përmirësuar cilësinë e pastëritisë të qytetit dhe njësive administrative duke shpëtuar një heër e mirë nga mbetjet e vëllimshme në pikat e grumbullimit nga kartonat pa fund dhe të gjelbërtat nga kopshtet dhe oborret publike dhe private, duhet të hartohet mekanizmi I financimit të projekteve të tilla të aplikohet në donatorë dhe në projektet Ndërkufitare për mbështetje financiare.

Në objektivat e Bashkisë Shkodër paraqiten si më poshtë hapat :

- Ngritja e një skeme të grumbullimit të veçuar të mbetjeve në qytetin e Shkodrës dhe terriotret me destinancion turizmin ( Velipojë,Theth,Shirokë ), e ndërtuar me kosha të veçuar në biznese, hapësira publike dhe shkolla. Grumbullimi i këtyre mbetjeve bëhet me anë të një skeme fuksionale dhe grumbullimin e përgatitjen e tyre për treg në Qendrën e Grumbullimit të Materialit të Riciklueshëm të propozuar nga Bashkia Shkodër;
- Mbështetja e vazhdueshme e kësaj skeme dhe shtrirja e saj në një territor gjithnjë e më të madh me qëllim uljen uljen e volumit të mbetjeve dhe shitjen e mbetjeve të riciklueshme në tregun e riciklimit. Kjo do të krijojë një kulturë të re të menaxhimit të mbetjeve sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese, do të angazhojë më shumë bizneset dhe qytetarët në menaxhim më modern të mbetjeve, të mbajë pastër qytetin, të edukojë qytetarët dhe turistët dhe të krijojë një imazh shumë të mirë turistik për Bashkinë.

# 19. MENAXHIMI I MBETJEVE VOLUMINOZE DHE NDERTIMORE

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve (VKM nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte") është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet), ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga bashkia për këtë qëllim. I vetmi vendgrumbullim në Rajon për mbetjet inerte është Vendgrumbullimi në lendfillin e Bushatit në Bushat të Bashkisë Vau dejës.

Bashkia e Vau të Dejës ka të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 26.10.2020, "Për krijimin e landfillit të ri për mbetjet inerte dhe çështje të tjera lidhur me depozitimin, administrimin, përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane", është miratuar lendfilli për mbetjete inerte.

## 20. MENAXHIMI I MBETJEVE TË TJERA

Ashtu siç është cituar edhe në kapitujt më sipër, bashkia ka si detyrim ligjor të grumbullojë, transportojë dhe trajtim final të mbetjeve bashkiake të gjeneruara nga familjet dhe kryesisht bizneset e vogla me të njëjtën tipologji. Ndërkohë rrymat e tjera të mbetjeve, ndonëse nuk janë objekt dhe detyrim i bashkisë që të sigurojë menaxhimin e tyre, bashkia duhet të jetë e informuar në lidhje me mënyrën sesi menaxhohen rrymat e tjera dhe ku shkojnë për trajtim final. Sipas ligjeve sektoriale, bashkitë kanë si detyrim ligjor, për rastin e mbetjeve inerte, të caktojnë një vend, ku gjeneruesit e tyre kanë përgjegjësi për t'i dërguar atje.

Nga ana tjetër bashkitë, sipas VKM nr. 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", kanë si detyrim ligjor që të raportojnë të dhëna për këtë listë të mbetjeve që gjenerohet potencialisht në bashkinë e tyre:

Sasia e mbetjeve plastike kg ose ton /vit 17 02 03/ 15 01 02 – mbetje plastike dhe mbetje ambalazhi plastike

Sasia e mbetjeve të qelqit kg ose ton /vit 15 01 07 – mbetje ambalazhi nga qelqi

Sasia e mbetjeve metalike kg ose ton /vit 17 04 07/ 15 01 04 – Metale të përziera dhe mbetje ambalzhi metalike

Sasia e mbetjeve të drurit ton/m3 17 02 01/ 15 01 03 – dru dhe mbetje ambalazhi druri

Sasia e mbetjeve të letrës dhe kartonit kg ose ton /vit 15 01 01/ 03 03 08 – mbetje ambalazhi letre dhe kartoni dhe mbetje që dalin nga seleksionimi i letrave dhe kartonit për riciklim

Sasia e mbetjeve të baterive të dala jashtë përdorimit 16 06/ 16 06 01*/ 16 06 06* - bateri plumbi dhe elektrolite të ndara të mbeldhura nga bateri dhe akumulatorë

Sasia e mbetjeve të gomave të dala jashtë përdorimit kg ose ton /vit 16 01 03– goma jashtë përdorimit

Sasia e mbetjeve të vajrave të përdorura kg ose ton /vit 12 01 06*/ 12 01 10* - Vajrat minerale të makinerive që përmbajnë halogjene (përveç emulsioneve dhe solucioneve) dhe vajrat sintetik të makinerive

Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg ose ton /vit 02 01 02 – mbetjet nga indet e kafshëve

Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstilit kg ose ton /vit 04/ 15 01 09 – mbetjet që dalin nga industria e lëkurëve, peliceritë dhe tekstili dhe mbetje ambalzhi tekstil

Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektronike kg ose ton /vit 16 02/ 20 01 36 – mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike dhe pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike (mbetje të tubave fluorishente dhe mbetje të tjera që përmbajnë mërkur, pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone)

Duke qënë që bashkia Shkodër nuk aplikon sistemin për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, gjenerimi i këtyre të dhënave bëhet akoma më i vështirë, nisur edhe nga fakti që një pjesë e mbetjeve të listuara më lart nuk janë kompetencë ligjore e bashkisë për t'u menaxhuar.

Megjithatë mënyrat që bashkia mund të aplikojë për gjenerimin e këtyre të dhënave ndahen në tre kategori, të cilat nuk mund të vlerësohen me shkallën e saktësisë, por janë alternativa që bashkia mund të zgjedhë dhe t'i zbatojë në varësi të kushteve dhe potencialit financiar dhe njerëzor që ka në dispozicion.

A. Të gjitha bizneset që operojnë në territorin e bashkisë dhe merren me prodhimin, pëpunimin, grumbullimin apo trajtimin e rrymave speficike të mbetjeve duhet të raportojnë çdo vit në bashki, sipas detyrimit ligjor të legjislacionit në fuqi për këto rryma. Bashkia mund të zgjedhë të dërgojë kërkesa specifike të gjithë bizneseve për mundësim informacioni.

B. Bashkia vendos të ngrejë qendra grumbullimi të mbetjeve specifike, të cilat operohen nga operatorë privatë. Sipas legjislacionit për rrymat specifike të mbetjeve, këto biznese duhet të raportojnë një herë në vit në bashki, për sasinë e mbetjeve që grumbullojnë apo trajtojnë. Bashkia zgjedh të bëjë kërkesa gjatë vitit për këta operatorë për raportrim të dhënash.

C. Bashkia **vendos të ngrejë qendra grumbullimi të mbetjeve specifike**, të cilat operohen nga vetë ajo. Në këto kushte bashkia duhet të ngrejë një sistem për monitorimin dhe mbajtjen e të dhënave për mbetjet që hyjnë në qëndër (pra për ato që ajo grumbullon) dhe që dalin për trajtim final sipas kategorive specifike. Në këto qendra, Bashkia, apo operatori privat mund të zgjedhë të bëjë rekuperim të produkteve apo materialeve nga përpunimi i produkteve/mbetjeve që hyjnë në qendër.

Bashkia mund të sigurojë këtë informacion përmes rrugëve të mëposhtme:

a) Raportimit të çdo kompanie e cila ushtron aktivitet në territorin e bashkisë për grumbullimin e fraksioneve të veçanta të mbetjeve. Bashkitë të duhet të kenë informacion për të gjitha bizneset që operojnë në territorin e tyre, të cilat grumbullojnë apo trajtojnë mbetje të kategorive të ndryshme, si për shembull, fraksione të rrymës të mbetjeve bashkiake, si organike, plastika, letra&karton, qelqi, metalet, druri, tekstili.

Të gjitha njësitë vendore kanë një regjistër të bizneseve private që operojnë në territorin e tyre, pasi atyre u kërkohet të paguajnë taksat dhe tarifat çdo vit. Ndërkohë të gjitha bizneset që operojnë në territorin e bashkisë bazuar në VKM-të për prodhimin e rrymave specifike duhet të raportojnë çdo vit në njësitë vendore, sasinë e mbetjeve që ato prodhojnë dhe menaxhojnë. Bashkia duhet të kërkojë raportime të rregullta nga këto kompani, në sajë të një formati të caktuar, i cili duhet të specifikojë, burimin e fraksionit të mbetjes, sasinë që grumbullohet dhe trajtohet dhe sasinë e mbetjeve fundore të cilat dalin pas procesit të trajtimit. Është shumë e rëndësishme të specifikohet nga kompanitë burimi i lëndës së parë që ato do të hedhin në proces, apo vetëm do të grumbullojnë, për të kuptuar realisht përqindjen e mbetjeve bashkiake që trajtohen veçantë, dhe në përgjithësi sasinë e fraksioneve specifike, si plastika, qelqi, letër&karton, metale që riciklohen. Ndërkohë, sipas *VKM nr. 177, datë 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"* në Aneksin II të kësaj metodologjie mundësohen dy formate, të cilat bashkia mund t'ia bashkangjisë kërkesës vjetore që ajo i drejtohet bizneseve që merren me prodhimin, pëprpunimin, trajtimin, importin apo eksportin e mbetjeve nga ambalazhet: i) formulari për të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg; ii) formulari për të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe çuar në përpunim, riciklim.

b) Raportim të rregullt ditor nga çdo impiant për riciklimin/kompostimin e mbetjeve – Sipas akteve nënligjore për rrymat specifike, të gjitha bizneset të cilat prodhojnë, përpunojnë, importojnë, eksportojnë dhe trajtojnë rryma specifike të mbetjeve duhet të raportojnë rregullisht çdo fund Janari për vitin paraardhës tek njësitë vendore ku ato operojnë. Bashkitë, nisur nga

kuadri ligjor në fuqi, për të informuar biznesin dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të drejtë dhe reciproke raportimi, mund të dërgojnë njoftime vjetore përpara afatit të dorëzimit të raportimeve tek bizneset përkatëse në territorin e saj. Pjesë e ndërtimit të kësaj marrëdhënie të ndërsjelltë të bashkisë me bizneset janë edhe takimet vjetore që mund të organizohen si iniciativë e bashkisë me bizneset për të sqaruar procedurën e raportimit dhe rëndësinë e tyre.

c) Vlerësimeve në terren përmes intervistave me sektorin informal / kompanitë e riciklimit që operojnë në territorin e bashkisë. Fakt është që në të gjitha bashkitë ekziston sektori informal, i cili grumbullon rregulisht nga Pikat e grumbullimit të Mbetjeve apo venddepozitimeve të hapura, kryesisht mbetje të ricikluеshme, të cilat hyjnë në linjën e përpunimit, pasi i blen sektori i bizneseve të riciklimit. Në këto kushte bashkitë mund të ngrenë ekipe për evidentimin e tyre dhe zhvillimin e intervistave për të kuptuar sasinë e mbetjeve të riciklueshme që ata grumbullojnë dhe që shkon për industrinë e riciklimit. Bashkia mund të zgjedhë që të kryejë intervista apo anketa

## 21. EDUKIMI PUBLIK MJEDISOR

Në termin "Edukim Publik", do të nënkuptohet aktiviteti publicitar i Autoritetit Kontraktor/Kontraktorit për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes,largimit, trajtimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve ne burim, etj, gjate periudhës së kontratës.

Autoriteti Kontraktor/ Kontraktori duhet të krijojë një kontakt të vazhdueshëm me komunitetin e zonës i cili luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në mbarëvajtjen e punës së Kontraktorit por edhe në minimizimin e ndotjes së ambjentit. Autoriteti Kontraktor/ Kontraktori duhet të mundësojë shpërndarjen e materialeve informative një herë në 3-muaj, ose sipas nevojave te Autoritetit Kontraktor ne rast sesionesh informuese te planifikuara nga Bashkia. Materialet informative duhet të jenë në formën e fletëpalosjeve si dhe broshurave duke përfshirë në to informacione mbi shkaqet dhe shkaktarët e kësaj ndotje, parandalimin e saj si dhe masat që mund të merren për minimizimin e ndotjes. Materialet sensibilizuese duhet të jenë të tilla që të ftojnë banoret për tu bërë pjesë aktive e një shoqërie të emancipuar dhe me një edukatë mjedisore.

Kontraktori duhet te pajise te gjitha mjetet teknologjike dhe jo-teknologjike me postera me logon e Bashkise Shkoder, operatorit sipermarres, nr. Telefoni i kontaktit te operatorit, dhe elemente te tjere te Rregullores per Menaxhimin e Mbetjeve, sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

Te gjithe kontenieret publike te perdorur per sherbimin e pastrimit, duhe te pajisen vazhdimisht me adeziv identifikues dhe informues.

Programi i edukimit mjedisor që do të bëjë operatori i shërbimit duhet të konfirmohet nga Autoriteti kontratues.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në NJA Velipojë në zonën e plazhit përgjatë 110 ditëve të sezonit turistik, Bashkia Shkodër vjen me një risi në procesin e grumbullimit të mbetjeve në mënyrë sa më eficiente dhe në përmirësimin e standartit të shërbimit. Në vitin 2022 u pilotua skenari i mbledhjes derë më derë i mbetjeve urbane në plazhin e velipojës duke e parë këtë skemë shumë të domosdoshme për këtë territor me destinacion turizmin për vetë fluksin e mbetjeve që gjeneronte që kishte kjo zonë veçanërisht zona e qendrës të të plazhit të Velipojës. Me përzgjedhjen e një prej skenarëve, realizohet minimizimi i pikave e grumbullimit në qendër të plazhit, pika të cilat gjatë gjithë kohës kanë qenë të mbi ngarkuara me mbetje, duke shkatuar kështu ndotje të

plazhit dhe një ambient aspak të këndshëm për turistët që frekunetojnë plazhin e Velipojës. Në vitin 2022,u ndoq një fushatë ndërgjegjsimi dhe u organizuan anketime për njesitë tregëtare dhe ato akomoduese. Gjithashtu me qëllim incentivimin e politikave të riciklimit u shpërndanë nëpër pedonalen e Velipojës kosha që mblidhnin vetëm shishet e plastikës nga turistët që më së shumti frekuentojnë stacionet e plazhit të zonës bregdetare me qëllim edhe zvoglimin e volumit të mbetjeve që shkon në pikat e grumbullimit, dhe për rrjedhojë uljen e tonazhit që shkon në lendfillin e Bushatit. Me realizimin e ndarjes të plastikës dhe kartonit edhe në njësitë tregtare të mëdha, në të gjithë territorin e plazhit, do të vijojë të bëjë të mundur uljen e tonazhit të mbetjeve që depozitohen në lendfillin e Bushatit si edhe uljen e ngarkesës në pikat e grumbullimit. Fushata e ndërgjegjesimit kërkoi ti paraprijë procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës dhe kartonit në të gjithë territorin duke realizuar mbledhjen e plastikës përgjatë gjithë pedonales nga pushues të zonës veçanërisht nga ata që frekuentojnë stacionet e plazhit, dhe plazhet private e publike. E njëta fushatë do të realizohet në vitet në vijim në muajt maj-Qershor, para përgatitjes për sezonin turistik. Vlen të theksohet që për fushtaën e ndërgjegjësimit është caktuar një kosto e vecantë në përllogaritjen e fondit limit, për operatorin sipërmarrës. Kjo fushatë do të realizohet cdo nisje të sezonit duke informuar turistët e Velipojës, njësitë tregëtare dhe ato akomoduese mbi rregulloren e menaxhimit të mbetjeve gjatë sezonit turistik, orarin, ndarjen e mbeturinave në burim etj. Kjo do të shoqërohet me një aktivitet publicitar i Kontraktorit, për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve ne burim, gjatë sezonit turistik sipas një rregulloreje të miratuar paraprakisht nga AK. Plani i punës i organizimit të fushatës ndërgjegjësuese që do të zbatohet nga ana e operatorit sipërmarrës, paraprakisht do të hartohet nga Dr.e shërbimeve publike miratohet nga Kryetari I Bashkisë dhe monitorohet nga nj.a/nj.m (sipas procedurës standarte).

Me nisjen e zbatimit të skemave të ndarjes të mbetjeve ne burim dhe grumbullimin e mbetjeve të ricikueshme, Bashkisë shkodër i del një detyrë e re në procesin e informimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit duke ndërtuar kështu një strategji komunikimi, duke I komunikuar grupeve të interest të përzgjedhur për projektin pilit si duhet te veprojnë në vijim me ditën dhe orarine përcaktuar për grumbullimin e fraksioneve të mbetjeve për riciklim ose për kompostim.

## 21.1 ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I FUSHATËS NDËRGJEGJËSUESE NË NJA VELIPOJË

Hartimi dhe rezultatet e pyetësorit

Pyetësori (Aneksi II) u hartua në 7 pyetje, qëllimi i të cilave ishte të kuptohej njohja e banorëve me procesin e grumbullimit të mbetjeve derë më derë dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në këtë skemë.

Gjithsej u zhvilluan 50 pyetësorë në bizneset kryesore përgjatë Rrugës nr.9, Kompleksit „Fishta" dhe zonës së plazhit (pedonalja). Kategoria mbizotëruese e bizneseve i përkiste bareve, restoranteve dhe marketeve të zonës.

Nga bizneset të cilët plotësuan pyetësorin, vetëm 8/50 prej tyre nuk zotëronin pika personale të përkohshme të grumbullimit të mbetjeve dhe i depozitonin ato në pikat më të afërta të vendosura nga bashkia në anë të rrugëve. Bizneset me kosha personale në ambientet e tyre, i kishin kryesisht të kapacitetit 40 l dhe 120 l.

**Rryma dominante e mbetjeve të gjeneruara nga çdo biznes** i përkiste llojit a dhe b të alternativave të pyëtësorit, përkatësisht **mbetjet organike dhe mbetjeve të ricikIueshme të thata.** Kjo gjë tregon se ka hapësirë dhe për ndarje në burim të mbetjeve kryesisht në supermarkete dhe dyqane të zonës.

Përsa u përket opinioneve të administratorëve/punonjësve të bizneseve të pyetura në lidhje me problematikat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe mënyrave konkrete për përmirësimin e tij, **17/50 biznese cilësuan grumbullimin me orar si opsionin më të përshtatshëm.** Përgjigje të tjera, kryesisht nga bizneset e vendosura në pjesën qendrore të Velipojës (Rruga nr.9) kërkuan dezinfektimin dhe frekuencën më të lartë të grumbullimit të mbetjeve, pasi një shqetësim i madh për ta është aroma e pakëndshme, ndotja e madhe nga mbingarkesa e mbetjeve dhe kanalet në afërsi të koshave. Bizneset në afërsi të plazhit e shihnin si më të nevojshëm shërbimin e grumbullimit derë më derë pasi do t'i ndihmonte shumë në periudhën me më shumë fluks pune.

Më shumë se gjysma e bizneseve që plotësuan pyetësorin (**28/50 biznese) vlerësuan grumbullimin të paktën 2 herë në ditë të mbetjeve nga ambientet e tyre.** Mëngjesi dhe darka janë periudhat e ditës që u përzgjodhën nga individët e pyetur. Mëngjesi dhe dreka ishin më në favor të restoranteve dhe gjellëtoreve. **Për bizneset përgjatë vijës bregdetare (kryesisht beach bars, hotele dhe markete), orari më i përshtatshëm do të ishte ndërmjet intervalit 22:00 - 24:00.**

Të pyetur në lidhje me tarifën e pastrimit, bizneset e vogla paguanin 8,000 ALL në vit, ndërsa bizneset e mëdha (numër shumë i pakët) 30,000 ALL në vit. Për bizneset përgjatë vijës së bregdetit tarifa është sezonale me vlerë 1,300 ALL për sezon. Përsa i përket gatishmërisë për të paguar më shumë për shërbimin e mbetjeve, pjesa më e madhe e përgjigjeve ishin negative, megjithatë 8 prej tyre u shprehën të gatshëm në lidhje me këtë pyetje, nëse do të ketë vërtet përmirësim të shërbimit.

## 21.2. FUSHATA E NDËRGJEGJËSIMIT

Bazuar në përgjigjet e marra nga pyetësori dhe pas diskutimit me specialistët e bashkisë, u hartua materiali informues për t'u shpërndarë në bizneset e NJA Velipojë.

Broshura e hartuar konsiston në dy faqe, ku faqja e parë paraqet oraret e përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve urbane në Kompleksin „Fishta" dhe Rrugën nr.9. Në zonën e parë, grumbullimi i mbetjeve do të bëhet derë më derë në tre oraret kryesore të ditës, ndërsa në zonën e dytë në mëngjes dhe pasdite. Faqja e dytë e fletpalosjes ka karakter informues dhe ndërgjegjësues. Bashkia Shkodër ka shpërndarë në qendrën e saj koshat metalike për grumbullimin e shisheve plastike, duke ftuar të gjithë pushuesit dhe bizneset e zonës që të mund të respektojnë dhe ta nxisin këtë iniciativë për një ambient më të pastër. Ky është një hap promovues për procesin e riciklimit dhe ndërgjegjësimin e banorëve mbi praktika me karakter miqësor me mjedisin, pasi këto kosha do të reduktojnë sadopak volumin e mbetjeve në pikat e grumbullimit, duke u bërë shembull për të gjitha njësitë tregtare që të vendosin pranë subjekteve të tyre kosha për plastikën dhe kartonin. Pjesa përmbyllëse e broshurës përmban fakte mbi plastikën dhe efektin e saj negativ në ndotjen e planetit, duke vënë theksin mbi rëndësinë dhe emergjencën e nismave riciklues.

Në datë 3 gusht pjesë e stafit të bashkisë dhe ekspertët e EcoDES Consultancy, të pajisur me veshjet për fushatën, u angazhuan me shpërndarjen e materialit informues në NJA Velipojë, në dy zonat e përcaktuara (Kompleksi „Fishta" dhe Rruga nr.9). Fletpalosjet u shpërndanë në të gjitha bizneset e targetuara, të cilët morën informacionin e nevojshëm mbi nismën dhe i gjithë stafi u tregua shumë i

gatshëm për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve të bizneseve në lidhje me pikat e parashtruara në material (Aneksi III).

## ANEKSI II - PYETËSORI

Pyetësori (Door-to-door Campaign Velipojë)

**Subjekti i Bisnesit:**

**Lloji i aktivitetit:**

1. A keni pikë depozitimi të përkohshme në ambientet e biznesit tuaj?
   a.) Po b.) Jo

   1.1. Nëse po, çfarë kapaciteti ka?
   a.) 1.1 $m^3$ b.) 240 litra c.) 120 litra

   1.2. Nëse jo, ku i dërgoni mbetjet?
   ________________________________________

2. Çfarë lloj mbetjesh prodhoni?

   a.) Mbeturina organike
   b.) Mbetje të riciklueshme të thata
   c.) Të tjera
   d.) Të gjitha

3. Çfarë mendoni ju se mund të përmirësonte sistemin e grumbullimit të mbetjeve për biznesin tuaj?
   a.) Grumbullimi me orar
   b.) Frekuencë më e lartë e grumbullimit
   c.) Sistem i diferencuar i mbledhjes/grumbullimit
   d.) Tjetër

4. Kur dëshironi ju të nxirrni mbetjet tek dera e biznesit tuaj?
   a.) 20:00 – 21:00
   b.) 21:00 – 22:00
   c.) 22:00 – 24:00
   d.) Tjetër

5. Sa herë në ditë mendoni se duhen grumbulluar mbetjet në biznesin tuaj?
   ____________________________

6. Sa është tarifa e pastrimit që ju paguani?
   ____________________________

7. A jeni të gatshëm të paguani më shumë për sistemin e grumbullimit të mbetjeve?

   a.) Po b.) Jo

FOTO TË REALIZUARA GJATË PLOTËSIMIT TË PYETËSORËVE



ANEKSI III - PËRMBAJTJA E FLETPALOSJES



BASHKIA SHKODËR VELIPOJA RICIKLON!

Të mbajmë plazhin pastër!

BASHKIA SHKODËR informon qytetarët dhe bizneset në NJA Velipojë – zona e plazhit për oraret e grumbullimit të mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit të mbetjeve të përcaktuara nga bashkia:

- Në Kompleksin Fishta, mbetjet urbane do të grumbullohen në këto oraret:
  - Orari i mëngjesit - Mëngjes 08:00-09:00
  - Orari i drekës - 16:00-17:00
  - Orari i darkës - 00:00 - 01:00 (grumbullimi derë me derë në këtë kompleks)
- Në Zonën 2, në Rrugën 9 dhe përballë lulishtes, mbetjet urbane do të grumbullohen në këto orare.
  - Orari i mëngjesit - përpara orës 08:00
  - Orari i mbasditës - pas orës 17:00





BASHKIA SHKODËR VELIPOJA RICIKLON!

BASHKIA SHKODËR fton qytetarët, bizneset dhe turistët që të hedhin SHISHET PLASTIKE në kontenierët e shpërndarë nga bashkia përgjatë pedonales në zonën e qendrës në VELIPOJË!

A E DINI SE!

- Plastika, si një material me prejardhje nga njeriu, u shpik për herë të parë në vitin 1907
- Shishet plastike duan deri në 450 vite për t'u shpërbërë
- 90% e kostos të shisheve të ujit është vetë shishja plastike
- 1/3 e mbetjeve të plastikës në dete dhe oqeane përbëhet nga shishet plastike
- Rreth 40% e plastikës sot përdoret vetëm 1 herë dhe më pas hidhet
- Rreth 5 trilion copa plastike gjenden sot në oqeane dhe dete

FOTO NGA SHPËRNDARJA E FLETPALOSJEVE





## 21.3. MODELI PËR HARTIMIN E FUSHATËS SË INFORMIMIT PËR ZBATIMIN E SKEMAVE TË MINIMIZIMIT TË MBETJEVE DHE NDARJEN NË BURIM

Ky model, do t'i vijë në ndidhmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të riciklimit dhe kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për t'u njohur me skemat e menaxhimit të mbetjeve dhe do të jenë pjesë e procesit të riciklimit dhe kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambjentet e shkollave.

Objektivat potencialë të një fushate ndërgjëgjesimi dhe informimi mund të formulohen nga bashkia si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimi dhe informimi i qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Ndërgjëgjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të riciklimit dhe kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. të nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e e minimizimit të mbetjeve (riciklim apo kompostim) dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për riciklimin e mbetjeve, si plastika, alumini, letra apo fillimin e skemave të kompostimit në zonat rurale;
5. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet riciklimi dhe kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave;
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të minimizimit të mbetjeve për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;
7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të riciklimit dhe kompostimit të mbetjeve;
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e minimizimit të mbetjeve;
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Fushata ndërgjegjësuese dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të bashkisë, ku ajo do të marrë përsipër zbatimin e saj në të gjithë territorin e saj. Me anë të këtij programi bashkia duhet të synojë që periodikisht (ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifikisht për nxënësit e shkollave.

Bashkia duhet të sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program. Në lidhje me burimet financiare bashkia duhet të parashikojnë si fillim në buxhetin e saj një zë të veçantë për programin e ndërgjesimit dhe informimit, ku duhet të merret në konsideratë elementet si më poshtë:




Figure Nr….. Elementet e fushatës të ndërgjegjësimit dhe informimit

[Burimi: zhvilluar nga autori]

# 22. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

## 22.1. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

Bashkia Shkodër është një bashki me territor të madh e shtrirje të gjerë nga Alpet në Bregdet, nga Velipoja deri në Theth. Vizioni i Planit lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane në Bashkinë Shkodër u konkretizua mbas një procesi të vazhdueshëm konsultimi me grupet e interesit ndërmarrë në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, nga Thethi deri në Velipojë. Analiza e gjëndjes ekzistuese dhe përfshirja e organizatave dhe strukturave përgjegjëse të mbrojtjes të mjedisit në takimet e vazhdueshme të Kryetarit të Bashkisë, përqendrohen në nevojën që territori i Bashkisë Shkodër ka në ndërmarrjen e politikave lokale për përmirësimin e shërbimit të pastrimit, incentivat e riciklimit të mbetjeve të fraksioneve të ndryshme dhe kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme.

PLMIMU është një dokument strategjik që do të shërbejë si mekanizëm për drejtimin e punëve të Bashkisë me qëllim, incentivimin e praktikave ricikluese për zvoglimin e volumit të mbetjeve që

shkon në lendfill duke menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet në zbatim të Planit Kombëtar strategjik. Zhvillimi i politikave mjedisore do të përqëndrohen më së shumti në zhvillimin e qëndrueshëm, zhvillim i cili do të promovojë ekonominë qarkulluese do të nxisë ekonominë e mbetjeve duke zbatuar skemat ë ndarjes në burim duke replikuar praktikat më të mira të riciklimit për një Shkodër të pastër dhe atraktive për turistët vendas dhe të huaj.

## 22.1.1.VIZIONI

BASHKIA SHKODËR, NJË BASHKI SHEMBULL NË ZBATIMIN E POLITIKAVE TË QËNDRUESHME, MIQËSORE ME MJEDISIN, BASHKI QË PUNON ME PËRGJEGJËSI "PËR NJË SHKODËR TË PASTËR", PËR NJË QYTET EUROPIAN, ME JETESË CILËSORE DHE MIKPRITËS PËR TURISTËT VENDAS DHE TË HUAJ.

## 22.1.2.OBJEKTIVAT

Bazuar në në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035, është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të NJQV për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal, i prezantuar në ligjin e vetëqeverisjes vendore (139/2015) për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo metodologji propozon 4 hapa në shkallë, duke filluar nga më baziku deri tek ai më optimali, të cilët përcaktojnë standardin minimal të ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve:

i) Mbulimi i 100% të territorit urban me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
ii) Depozitimi i mbetjeve në një venddepozitim të kontrolluar të pajisur me lejen përkatëse nga AKM-ja apo në një impiant inxhinierik.
iii) Mbulimi i 90% të territorit rural të bashkisë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
iv) Ndarja në burim e mbetjeve dhe riciklimi i mbetjeve Në përcaktimin e objektivave të planit 5 vjeçar, gjatë konsultimeve me bashkinë, u ra dakord që objektivat do të përcaktohen mbi bazën e vlerësimit të performancës së shërbimit sipas indikatorëve, duke synuar hartimin e skenarëvë për të përmbushur standardin minimal të ofrimit të shërbimit.

Strategjia Kombëtare e MIMU përcakton edhe detyrimin e Bashkive për funksionimin e grumbullimit e diferencuar të mbetjeve në burim dhe riciklimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve.

Skema në vijim do të jetë bazë e zgjedhjes së opsioneve teknologjike për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Kjo skemë nuk është detyruese dhe duhet rishikuar dhe përshtatur bazuar në nevojat vendore/rajonale.

**Figure 5** Opsionet e trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake




Ndarja e mbetjeve në burim dhe mbledhja e diferencuar të MNU realizohet gradualisht nëpërmjet sistemeve të mbledhjes së ndarë (përfshirë sistemet derë më derë dhe kontenierëve publikë rrugorë, qese ose pajisje të tjera). Më tej, masat do të përfshijnë nxitjen e grumbullimit të ndarë të materialeve të riciklueshme në zonat urbane dhe menaxhimin e ndarë të mbetjeve organike në zonat rurale. Do të nxitet kompostimi i decentralizuar dhe kompostimi në kushtet e shtëpisë në zonat rurale. Grumbullimi i ndarë i mbetjeve organike në zonat urbane do të përfshihet si pjesë e sistemit sapo të vendosen pajisjet e nevojshme për menaxhimin e këtyre rrymave të mbetjeve.Objektet për grumbullimin e ndare të mbetjeve të vëllimshme dhe inerte (që shoqërojnë mbetjet bashkiake) do të ngrihen në vende të caktuara të nivelit vendor/ rajonal, ose në nivelin e Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve. Do të ngrihen edhe sistemet e grumbullimit për rryma të veçanta të mbetjeve (përfshirë edhe mbetjet e rrezikshme)

Të gjitha masat që do ta bëjnë këtë dokument të zbatueshem do të synojnë që të arrihet 40-50% e rikuperimit të rrymave bazë të mbetjeve shtëpiake; letër/karton, plastikë, metale dhe qelq nëpërmjet riciklimit deri në fund të periudhës kohore që mbulohet nga Dokumenti i Politikave Strategjike.

Bashkia Shkodër do duhet të hartojë politika, dhe të ndërmarrin veprime konkrete në arritjen e objektivave për rekuperimin e rrymave të riciklueshme të mbetjeve në vitin 2025 nga 17% deri në max 20%, deri në vitin 2030 deri në 30% dhe deri në vitin në 2035 të arrihet rekuperimi me 40-50%.

Bashkia Shkodër gjatë pesë vjecarit të kaluar me planin lokal të viteve 2018-2022 ka punuar për të konsoliduar shërbimin në zonat ku nuk kishte shërbim pastrimi, të përdorë në mënyrë eficente buxhetin dhe të mbulonte koston e shërbimit për ato njësi administrative ku me reformën e bashkimit të njësive territorial me Bashkinë Shkodër mungonte shërbimi ose shërbimi nuk ishte cilësor. Në 5 vitet në vijim Bashkia Shkodër do të përqëndrohet në realizimin e vizionit "Për një Shkodër të pastër", për një Shkodër mikpritëse për turistët vendas dhe të huaj. Ndërkohë që me zbatimin planit do të kërkohet të përmirësohet cilësia e shërbimit të ndërmerren hapa të mëtejshme duke nxitur ndarjen në burim, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve.

Më tej ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky plan ka parashikuar hartimin e objektivava emergjente dhe objektiva afat gjatë sipas tabelës bashkëlidhur.

1. **Objektivat emergjente:**
   - Miratimi i planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
   - Hartimi i Rregullores për Përllogaritjen e Kostos dhe tarifave;
   - Azhornimin me të dhëna të data basës ;

2. **Objektiva afat-shkurtër**
   - Përmirësimi i shërbimit në njësitë administrative ku ofrohet shërbimi dhe zgjerimi i shërbimit në njësitë administrative (Pult dhe Shosh) ku aktualisht nuk ofrohet shërbim me përmirësimine infratrukturës rrugore;
   - Në NJA-ve ku aktualisht ofrohet shërbimi, bashkia do të rrisë standardin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;
   - Reduktimi depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze.
   - Rishikimi dhe miratimi i planit lokal per menaxhimin e mbetjeve 2024-2029,
   - Reduktimi i depozitimeve ilegale te mbetjeve urbane,
   - Konsolidimi i sherbimit te pastrimit ne zonat ku ofrohet aktualisht:
   - permiresim i standardit te shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;
   - zgjerim i zones ku ofrohet sherbimi dere-me-dere duke perfshire zonen qendrore te Shirokes;
   - Ri-organizim i pjesshem i sherbimit te pastrimit :fshirje/mirembajtje ditore - nga sherbim me operator privat ne sherbim me operator publik.
   - Rishikimi i tarifave per familjaret dhe bizneset;

3. **Objektiva afatgjatë:**
   - Nxitja e iniciativave për minimizimin e mbetjeve përmes stimulimit të grumbullimit të ndarë dhe kompostimit. Objektivi i planit që I ka përfunduar afati 2017-2022 për minimizimin e mbetjeve urbane që shkojnë në landfill është realizuar nga vitet 2020-2023 me nga 22%-25% duke krahasuar vitin 2019 me vitin 2022, pork jo nuk është arritur me grumbullimin në burim të mbetjeve të ndara.
   - Promovimi i ndarjes në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Shkodrës;
   - Shtrirja e e skemës në dy rryma në lagje të tjera të qytetit, deri në mbulimin e plotë e tij;
   - Promovimi i skemave të kompostimit të mbetjeve në NJA Rretinat dhe në NJA Dajç; □ Shtrirja e skemave të kompostimit edhe në njëstë e tjera administrative me karakter rural.
   - Rritja e nivelit të të ardhurave nga tarifat nga njësitë, të cilat marrin shërbim me 40% gjatë periudhës 2017 – 2022
   - Informimi i qytetarëve në lidhje me shërbimet e pastrimit që do të mbulohen nga tarifa;
   - Aplikimi i fushatave ndërgjegjësuese në lidhje me pagesën e tarifës së pastrimit dhe rritjet progresive në sajë të përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve për mbetjet: dëgjesa publike në të gjithë territorin e bashkisë me grupe të ndryshme interesi.

- Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, duke konsoliduar mekanizimin e hartimit të buxhetit për shërbimet e mbetjeve dhe hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave bazuar në standardet e paracaktuara në rregulloret përkatëse të shërbimit.
- Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve.
- Reduktimi i volumit te mbetjeve te cilat dergohen ne landfill (-20%);
- Krijimi i skemes se multigrumbullimit (per riciklim dhe kompostim) (1 qender);
- Reduktim i numrit te grumbulluesve ilegal (-30%);
- Ndergjegjesimi i banoreve (+ 30%) per te mbajtur qytetin paster nepermjet informimit intensiv per rregulloren e menaxhimit te mbetjeve dhe marrjes se masave ndeshkuese;
- Krijimi i skemes lehtesuese per transportin e mbetjeve nga zonat e thella (Fshatrat turistike te Shales), prsh. krijimi i 1 pike te perkohshme transferimi.

## 23. PLANI I VEPRIMIT

### 23.1.KOMPONENTI: QËNDRUESHMËRIA INSTITUCIONALE 4

| | Objektivi Strategjik | Nr | Veprimet e detajuara | Indikatori matës i performancës | Përgjegjësia/ Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë bashkëpunëtorë | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | 1.1.1 | Miratimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Ngurta Bashkiake 2024-2029 | PLMMNU I miratuar | **Bashkia Shkodër;** Drejtoria e Mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike/ **Këshilli Bashkiak** | Viti 2024 |
| | | 1.1.2 | Përditësimi i Rregullores Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve me Planin e miratuar dhe kontratat në fuqi | Rregullore e MMNU e përditësuar | Drejtoria e Mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike/ **Këshilli Bashkiak** | Viti 2025 |
| | | 1.1.3 | Aplikimi i instrumentave të komunikimit dhe informimit të komunitetit rreth rregullave dhe penaliteteve; | Hartimi dhe zbatimi I një startegjie komunikimi | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e Mjedisit dhe Drejtoria e komunikimit dhe Mediave | Viti 2025-2029 |
| | | 1.1.4 | Realizimi i procedurave te prokurimit sipas shërbimeve që kërkohen të zgjerohen ose skemat e reja të grumbullimit te mbetjeve | Procedurat e prokurimit me shërbime të përmirësuar , skema të reja organizimi drejt ekonomisë qarkulluese | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e Sherbimit të pastrimit/Ndërmarrja e shërbimeve dhe | Viti 2025-2029 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Punëve Publike dhe Drejtoria e Mjedisit | |
| | 1.1.5 Miratimi I Rregullores të përllogaritjes të Kostos të ofrimti të shërbimit të pastrimit dhe tarifave të shërbimit të pastrimit për të tre zonat funksionale sipas VKM për llogaritjen ekostos dhe tarifave . | Rregullore e miratuar | **Bashkia Shkodër**; Drejtoria e Mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike/ **Këshilli Bashkiak** | 2025 |
| | 1.1.6 Plotësimi dhe azhornimi në kohë i data basës të menaxhimit të mbetjeve sipas formatit përgatitur nga asistenca e projektit BtF | Database e plotësuar cdo vit | **Bashkia Shkodër**; Drejtoria e Mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike | 2024-2029 |
| Parandalimi i ndotjes nga depozitimi pa kriter i mbetjeve dhe pastrimi i hotspoteve | 1.2.1 Identifikimi i hotspoteve dhe përditësimi i hartës të hotspoteve me vendodhjet volumet dhe tipologjinë e mbetjeve. | Një hartë hotspotesh e përditsuar | **Bashkia Shkodër**, (Administratorët e NJA, Drejtoria e shërbimeve dhe monitorimit në ndërmarrjen publike), Drejtoria e mjedisit , Ministria e Mjedisit dh eTurizmit,Prefektura, Ministria e mbrojtjes, donatorët dhe organizatat jo qeveritare | Viti 2024-2029 |
| | 1.2.2 Projekt zbatimi I rehabilitimit t ëish vendgrumbullimeve të vjetra të mbetjeve urbane; | Deri në vitin 2026 rehabilitimi I një ish-vendgrumbullimi mbetjesh | **Bashkia Shkodër**, (Administratorët e NJA, | Viti 2024-2029 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Deri në fund të 2029 të ketë marrë udhë procesi I rehabilitimit të ish vendgrumbullimit të mbetjeve në varrezat e dëshmorëve. | Drejtoria e shërbimeve dhe monitorimit në ndërmarrjen publike), Drejtoria e mjedisit , Ministria e Mjedisit dh eTurizmit,Prefektura, Ministria e mbrojtjes<br>Donatorët dhe organizatat - joqeveritare | |
| 1.2.3 Pastrimi i hotspoteve sipas planit të përcaktuar. Rehabilitimi i hotspoteve nga mbetjet oa kriter. | Ulja e numërit të hotspoteve me 30 % në vitin 2025, 50% në 2026 dhe eleminim I plotë deri në fund të 2029. | **Bashkia Shkodër,** (Administratorët e NJA,<br>Drejtoria e shërbimeve dhe monitorimit në ndërmarrjen publike), Drejtoria e mjedisit , Ministria e Mjedisit dh eTurizmit,Prefektura, Ministria e mbrojtjes<br>Donatorët dhe organizatat - joqeveritare | Viti 2024-2029 |
| 1.3.1 Hartimi I project-zbatimit /miratimi i një vendepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore brenda standarteve kombëtare | Projekti / rishikimi I Planit Rregullues | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e Mjedisit/Drejtoria e Planifikimit Urban/ Strukturat shtetërore përgjegjëse për lejet | Viti 2025 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1.3.2 Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve/ekonomia qarkulluese. | Takime dhe Ëorkshope | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e pastrimit de monitorimit/Drejtoria e Mjedisit / Donatorë | Viti 2025-2029 |
| 1.4.1 Forcimi i strukturave ligjzbatuese në zbatim të Legjislacionit dhe Rregullores përkatëse, mbi penalizimin e kundravajtësve administrative me ndotjen e ambienteve të përbashkëta publike. | Numëri I gjobave për cdo vit<br>Vitin e parë rritja e gjobave me 10 %<br>Vitin e dytë 20<br>Tre vitet e tjera ulje e nivelit të gjobave për shkak të ndërgjegjësimit qytetar | **Bashkia Shkodër,** (Njësitë administrative)<br>Policia Bashkiake e Bashkisë Shkodër<br>Në support Drejtoria Vendore e Policisë së shtetit Policia e Shtetit në raste të konstatimit të krimit mjedisor. | 2024-2029 |
| 1.4.2 Koordinimi në nivel rajonal dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimin apo përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve; | Bashkëpunimi me Bashkitë fqinje mbi ndalimin e ndotjes nëper lumenj dh vija ujore, në kufijtë tokësore dhe ujorë. | **Bashkia Shkodër;** Qarku i Shkodrës, si dhe njësitë e tjera lokale kufitare. | Viti 2024-2029 |
| 1.4.3 Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj. | 2-3 spote të reja publicitare<br>transmetimi në 4 media lokale | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e mjedisit /drejtoria e medias dhe komunikimit | Viti 2024-2029 |

## 23.2 KOMPONENTI : CILËSIA E SHËRBIMIT

| 2 | Objektivi Strategjik | Nr | Veprimet e detajuara | Indikatori matës i performancës | Përgjegjësia/ Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë bashkëpunëtorë | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.1.1 | Shtrirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohej shërbimi i mbetjeve (NJA Pult, NJA Shosh, NJA Shalë) dhe konsolidimi i shërbimit në NJA të cilat kanë patur shërbim. Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në sajë të nevoja të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenierë dhe mjete teknologjike; | Shtrirja e shërbimit në 100% të territorit urban në zonën urbane<br>Shtrirja e shërbimit në 100% të territorit rural<br>Mbulimi I I popullatës me 100 % me shërbim | **Bashkia Shkodër;** Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike / Këshilli Bashkiak | Viti 2026-2029 |
| | | 2.1.2 | Në NJA-ve ku aktualisht ofrohet shërbimi, bashkia do të rrisë standardin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; | Ulja e numërit të kontenierëve të dëmtuar<br>Uja e numrit te masave ndaj operatorëve<br>Përmirësimi I shërbimit të dezinfektimit, mirmabjtjes të pgm've | **Bashkia Shkodër;** Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike / Operatorët sipërmarrës të shërbimti të pastrimit | 2024-2029 |
| | | 2.1.3 | Pilotimin e grumbullimit derë më derë me ndërmarrjen/opertaorin sipërmarrës | Grumbullimi I mbetjeve në shirokë derë më derë duke | **Bashkia Shkodër;** Ndërmarrja e | 2026-2029 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Implementimin e skemës të grumbullimit derë më derë për zonën e shirokës si territory me destinacion turizmin dhe përgatitja për kontratën e re të nj.a shkodër zona qëndrore | zbatuar skenarin e grumbullimti të mbetjeve të riciklueshme<br><br>Zvglimi I volumeve të mbetjeve të dërguar në lendfillin e Bushatit | shërbimeve dhe punëve publike / Operatorët sipërmarrës të shërbimti të pastrimit | |
| 2.2 | | | | | |
| | 2.2.1 | Prezantimi i skemave të ndarjes në burim dhe grumbullimi I mbetjeve të riciklueshme në zonat ku realizohet mbledhja derë më derë ( plazh velipojë dhe pedonalet e qytetit ) | Ulja e volumit të mbetjeve që shkojnë në landfill cdo vit me 10%<br><br>PGM më të pastra nga eleminimi I ndotjes nga kartoni dhe plastika<br><br>PGM më të pastra nga eleminimi I grumbulluesve ilegalë të aluminit | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e pastrimit dhe monitorimit /Drejtoria e Mjedisit | Viti 2024-2029 |
| | 2.2.2 | Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjev të riciklueshme. Investim në kontenierë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve; | Kontenierë 240 lira dhe 120 litra për tu shpërndarë në bizneset e velipojës<br><br>Kosha prej rrjete për mbledhjen e plastikës 100 copë | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e pastrimit dhe monitorimit /Drejtoria e Mjedisit | Viti 2024-2029 |
| | 2.2.3 | Projektimi dhe ndërtimi i një pike grumbullimi për mbetjet e riciklueshme, e cila do të shërbejë për të pritur dhe paketuar mbetjet që vijnë nga zonat pilot të grumbullimit të ndarë të mbetjeve në qytetin e Shkodrës; | Projekti për ndërtimin e pikës të grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme deri në vitin 2025<br><br>Parashikimi në Planin Rregullues Viti 2025<br><br>Gjetja e mundësisë të financimit viti 2027 | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e pastrimit dhe monitorimit /Drejtoria e Mjedisit/ Drejtoria e përgjithshme e zhvillimit të qëndrueshëm | Viti 2024-2029 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Ekonomik / Donatorë në vend /IPA/ Qeveria Shqipëtare | |
| 2.2.4 | Dy fusha kompostimi për Bashkinë SHkodër | Prezantimi i skemave të financimit të dy fushave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme në dy njësi admisnitrative sipas zonave funksionale lindore dhe perëndimore<br>Projekt -zbatimi I fushës të kompostimit<br>Prezantimi në Planin rregullues të rishikuar<br>Ndërtimi I fushës së kompostimit me gjetjen e mundësisë të financimit | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e pastrimit dhe monitorimit /Drejtoria e Mjedisit/ Drejtoria e përgjithshme e zhvillimit të qëndrueshëm Ekonomik / Donatorë në vend /IPA/ Qeveria Shqipëtare | Viti 2024-2029 |
| 2.2.5 | Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjev të të biodegradueshme. Investim në kontenierë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve; | Financimi I mjeteve të pikave të kompostimit dhe mjeteve të transportit<br>Ndërtimi I skemës të OM ( operimit dhe mirmbajtjes të impianteve ) | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e pastrimit dhe monitorimit /Drejtoria e Mjedisit | Viti 2024-2029 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme. | Ndarja e koshave me ngjyra sipasë tipit të mbetjeve qe shkojnë për riciklim. Investim në kontenierë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve. | | |
| 3.1.6 | Monitorimi i zbatimit të skemave të ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe kompostimit: efektivitetit dhe cilësisë së funksionimit ashtu dhe sasisë së mbetjeve që ndahet dhe përpunohet; Mbajtja e një regjistri javor për këto të dhëna dhe relatimi çdo muaj pranë grupit mbikqyrës në bashki; | Version i ri i PSV me ndryshimet përkatëse, miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë | **BashkiaShkodër**, Ndërmarrja e shërbimeve publike/Drejtoria e mjedisit/monitoruesit në njësi administrative dhe lagje të qytetit/administratorët në nj.a. | 2024-2029 |
| 3.1.7 | Organizimi i takimeve me grupet e interesit ne rajon dhe me gjerë. Reklamimi i faciliteteve ricikluese si dhe skemave të grumbullimit të diferencuar, skemave të kompostimit. | Takim me cdo grup interesi<br>Bizneset (Hotele dhe Restorante )<br>Banorë të zonave pilot ku do zbatohet skema e grumbullimit të diferencuar | **Bashkia Shkodër**, Njësitë administrative dhe lagjet e qytetit Ekspertë &<br>Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Shoqata e Bashkive/donatorë etj | 2024-2029 |



| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | /Bizneset e riciklimit, OJQ-të etj | |
| 2.3.5 | Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët. | Broshura, leafleats dhe mjete te tjera komunikim, rrjete sociale media lokale etj | **Bashkia Shkodër**; Drejtoria e mjedisit /drejtoria e medias | Viti 2024-2029 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3.1.8 | Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal. | Një studim fizibiliteti mbi vlerësimin e mundësisë të realizimit të skemës me zgjerimin e territorit të ndarjes në burim të mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjeve të gjelbërta për kompostim deri në fund të vitit 2025,sipas tre skenarëve të ndarjes në burim.<br>Zbatimi i një skenari të përzgjedhur 2026-2027 .<br>Hartimi i një plani operimi i pikës RC. 4.<br>Nisja e operimit të qendrës kompostim/mbetje të riciklueshme 2028-2029 | BashkiaShkodër, Ekspertë &<br>Konsulentë të jashtëm/Donatorë | 2024-2029 |
| 3.3 | 3.3.1 | Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve në NJA; | Studimi i fizibilitetit<br>Project zbatimi<br>Project rehabilitimi | **Bashkia Shkodër** ; Drejtoria e Mjedisit/ Ndërmarrja e shërbimeve dhe Punëve Publike/ Drejtoria e Planifikimit Urban.<br>MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm | 2025 |
| | 3.3.2 | Sigurimi i financimit për zbatimin e projektit të rehabilitimit; | Hartimi I fishprojektit<br>Miratimi në Këshill Bashkiak | **Bashkia Shkodër** ; Drejtoria e Mjedisit/ Ndërmarrja e shërbimeve dhe Punëve | 2026-2027 |

| Objektivi Strategjik | Nr | Veprimet e detajuara | Indikatorët e performancës | Përgjegjësia/ Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë bashkëpunëtorë | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Aplikimi në donatorë të huaj / qeveria Shqipëtare | Publike/ Drejtoria e Planifikimit Urban.<br>MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm | |
| | 3.3.3 | Rehabilitimi i venddepozitimeve në NJA (sipas projektit); | Dy ish vendgrumbullime kthyer në hotspote të rehabilituara | **Bashkia Shkodër** ; Drejtoria e Mjedisit/ Ndërmarrja e shërbimeve dhe Punëve Publike/ Drejtoria e Planifikimit Urban.<br>MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm | 2024-2029 |
| | 3.3.4 | Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes. | Një plan rehabilitimi për të dy ish -vendgrumbullimet | **Bashkia Shkodër** ; Drejtoria e Mjedisit/ Ndërmarrja e shërbimeve dhe Punëve Publike/ Drejtoria e Planifikimit Urban.<br>MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm | 2024-2029 |

## 23.4. KOMPONENTI: QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

| 4 | Objektivi Strategjik | Nr | Veprimet e detajuara | Indikatorët e performancës | Përgjegjësia/ Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë bashkëpunëtorë | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1 | Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, marrëveshjeve dhe kontratave. Llogaritja vjetore e kostos sipas modelit të miratuar me VKM dhe rishikimi i nivelit të tarifave, bazuar në koston reale të shërbimit. Rifreskimi i databazës së klientëve për planifikimin e saktë të grumbullimit të tarifës | 4.1.1 | Zbatimi i rregullores të përllogaritjes të kostos dhe tarifave të shërbimti të pastrimit | Zbatimi I rregullores në procedurat e prokurimit për zonat funksionale<br>Zbatimi i rregullores për llogaritjen e tarifave sipas VKM deri në fund të vitit 2027 | **Bashkia Shkodër,** Drejtoria e Sherbimit të pastrimit/Ndërmarrja e shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtoria e Mjedisit, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës. | 2024-2029 |
| | | 4.1.2 | Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim ineficient të tarifave; | Numëri I familjeve që përfitojnë nga skema e rimbursimit | **Bashkia Shkodër** (Përgj Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak | 2024-2029 |
| | | 4.1.3 | Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohet mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka; | Rritja e numërit të projekteve që aplikohen për grantet konkuruese ose Donatorë të EU | Bashkia Shkodër, Drejtoria e Mjedisit , Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimti të Qëndrueshëm Ekonomik /Këshilli Bashkiak | 2024-2029 |
| | | 4.1.4 | Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total; | Rritja e pagesës të tarifës të pastrimit nga tatimpaguesit familjarë deri në rritjen e bazës, me 30% deri në vitin 2026 dhe mbi 50% deri në 2029 | **Bashkia Shkodër/** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave | 2024-2029 |
| | | 4.1.5 | Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve; | Si më sipër 4.1.4 | **Bashkia Shkodër/** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave/ administratorët e nj.a've dhe lagjeve të qytetit | 2024-2029 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.1.6 | Propozim për të vendosur stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit të mbetjeve ; | Numri I bizneseve që mbështesin iniciativën e Bashkisë për ndarjen e mbetjeve në burim, rritet me 10% nga viti në vit<br><br>Pajisjen me infrastrukturën përkatëse kosha për fraksionet e mbetjeve të ndara në burim. | **Bashkia Shkodër;** drejtoria e mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve publike/ Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore/Këshilli Bashkiak | 2024-2029 |
| 4.1.7 | Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan"; | Paketë e re tarifimi për dëgjesat publike dhe miratim në KB | **Bashkia Shkodër;** , drejtoria e dhe mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve publike/ Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore/Këshilli Bashkiak | 2024-2029 |
| 4.1.8 | Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektivave si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan; | Paketë e re tarifimi për dëgjesat publike dhe miratim në KB | **Bashkia Shkodër;** Insp drejtoria e mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve publike/ Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore/Këshilli Bashkiak | 2024-2029 |
| 4.1.9 | Transparenca dhe komunikimi: Procesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke | Procesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur | **Bashkia Shkodër;** drejtoria e mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve publike/ Drejtoria e taksave dhe | 2024-2029 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë". | metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë". | tarifave vendore/Këshilli Bashkiak | |
| Transparenca në sistemin e faturimit | 4.1.10 | Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për informimin e komunitetit | Aplikimi i një sistemi faturimi transparent për komunitetin | **Bashkia Shkodër;** drejtoria e mjedisit/Ndërmarrja e shërbimeve publike/ Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore/Këshilli Bashkiak | 2024-2029 |
| | | Zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit të komunitetit në lidhje me nivelin e tarifave të pastrimit dhe detyrimin e tyre për pagesën e tyre | 50% më shumë nga komuniteti/bizneset të informuar në lidhje me sistemin e faturimit të tarifës së pastrimit | | |
| | | Bërjen transparente të tarifave për çdo grup që përfiton shërbimin në mënyrë të personalizuar | Pyetsorë mbi kënaqësinë e qytetarëve nga ofrimi I shërbimit dhe mundësitë e informimit mbi tarifën e pastrimit | | |
| | | Përditësimi dhe përmirësimi i mekanizimit që mundëson faturimin e të gjithë klientëve që marrin shërbimin e grumbullimit dhe të transportit të mbetjeve | | | |

## 24. RISHIKIMI I PLANIT

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e menaxhimit të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballet me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri. Përgjatë zbatimin të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

### 24.1. MONITORIMI

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportimin tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoritetet përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritjet e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilat do të matet ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

- Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
- Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
- Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
- Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e proçesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

1) Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshtaten kontekstit real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve;
2) Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet;

3) Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar;
4) Dokumentimi i konkluzioneve
5) Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimmarrësit.

Kryetari i bashkisë duhet të ngarkojë një grup pune përgjegjës apo zyrtarë të caktuar, brenda stafit të bashkisë, me përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit të planit. Grupi i punës duhet të përfshijë zyrtarë të administrimit të mbetjeve, administrimi financiar, struktura të mjedisit dhe kontrollit të territorit dhe konsulentëve të jashtëm.



Formati I Raportimit
Aneksi 4.4 L.3 Zona Veriore

Fshirja dhe larja e rrugeve — Ora 22.00 - 06.00

| Raportim date | Zona | Emri Insp/ Administratori | Muaji | Ora |
|---|---|---|---|---|
| | Jugore 4 | Gazmor Dosti | Mars 2020 | 8.00 |

| | Emertimi i rruges / Fshirja manuale | Siperfaqja e rruges (m²) | Frekuenca e fshirjes | Ora e vezhgimit | E Hene | Ora e vezhgimit | E Marte | Ora e vezhgimit | E Merkure | Ora e vezhgimit | E Enjte | Ora e vezhgimit | E Premte | Ora e vezhgimit | E Shtune | Ora e vezhgimit | E Djele | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rr. Acron | 10.331 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | Nga Inspektorat e larjeve Raportohet cdo dite ora 10.00 prane NJMSHP, Monitoruesi e NJMSHP raportojne zbatimin e PSV sipas formateve perkatese dhe procedurave miratuar ne PSV |
| 2 | Rr. E Pazarit | 22.704 | 5 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | Rr. Gent | 6 973 | 5 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | Rr. Kalase | 5 600 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | Rr. Zogu i Pare | 17 626 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Rr. M. Pashe Plaku | 19 250 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 7 | Rr. Studenti | 9 254 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 8 | Rr Edison | 2 200 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 9 | Rr. 13 Dhjetori | 3 500 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 10 | Rr. 28 Nentori | 2.000 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | Rr. Besnik Sykja | 1 520 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 12 | Rr. Daut Boriçi | 6 565 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 13 | Rr. Dom Bosko | 2 500 | 4 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 14 | Rr. Edith Durham | 8 620 | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 15 | Rr. Jubeveçeve | 2 380 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 16 | Rr. E Kopliku | 2 470 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 17 | Rr. Kole Dema | 1.510 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 18 | Rr. Tepes | 10 500 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 19 | Rr. Unaza Lindore | 13 045 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 20 | Rr. Barje Vegjl | 2 200 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 21 | Rr. Arkadi Sinani | 1 150 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 22 | Rr. Bardhosh Gani | 1 200 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | |
| 23 | Total | 161.715 | | | | | | | | | | | | | | | | |

Fq. 3 — INSPEKTOR/ADMINISTRATOR

[Burimi: zhvilluar nga autori]

Monitorimi i planit do të bëhet sipas indikatorëve të performancës të përcaktuar në tabelën e mëposhtme që do të shërbejë:

i) Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit mbi statusin e zbatimit të planit;

ii) Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;

iii) Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo më të efektshme.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Shkodër | | | |
| Indikatorët e performancës | | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 |
| | C1 Mbulimi i zonës me shërbim (të dhënat e bashkisë) | 99% | 97% | 95% | 98% |
| | C2 Pastërtia e bashkisë | 68% | 84% | 84% | 84% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | C3 Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat | 100% | 100% | 100% | 100% |
| | D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] |
| | D2 Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave | 100% | 100% | 100% | 100% |
| | E1 Mbulimi i kostos **(shpenzimet faktike)** | 113% | 130% | 100% | 98% |
| | E1' Mbulimi i kostos **(buxheti plan)** | 73% | 54% | [illegible] | 63% |
| | E2 Niveli i grumbullimit të të ardhurave | 99% | 93% | 107% | 107% |
| | E2.1 Kosto njësi (lek/ton) | 5,554 | 8,694 | 11,678 | 8,556 |
| | E2.2 Kosto për banorë (lek/banorë) | 1,299 | 1,842 | 2,424 | 1,833 |
| | E3 Transparenca në sistemin e faturimit | 60% | 80% | 80% | 80% |
| Qëndrues hmëria | F1 Transparenca në aspektet institucionale | 92% | 92% | 92% | 92% |

Figure Nr….Indikatorët e performancës [Burimi: zhvilluar nga autori]

Figure . Hartat e vendodhjes të konteneirëve në nj.a shkodër/zonat perëndimore&lindore











Të gjitha pikat e grumbullimit për nja.Shkodër dhe nja zonat rurale janë të hedhura në harta me system GIS dhe azhornohen me të dhënat e fundit për cdo vendimarrje. Gjithashtu Bashkia Shkodër ka të azhornuar edhe hartën e vendodhjes të hotspoteve të krijuara në kohë të ndryshme duke I përditësuar me gjëndjen aktuale.

Bashkia Skodër ka të miratuar me versionin e parë në shkurt të vitit 2020, rishikuar në versionin nr.2 në gusht të vitit 2023 me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Shkodër me Nr.994 datë 30.08.2023, Procedurën standarte të Veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Në NJA Shkodër dhe nj.a e tjera të zonave funksionale perëndimore dhe lindore monitorimi i shërbimit të pastrimit realizohet nga monitoruesit e njësive dhe inspektorët e pesë lagjeve të Nj.A Shkodër. Inspektorët e qytetit dhe monitoruesit e njësive zbatojnë procedurën standarte të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimti të pastrimit për Bashkinë shkodër, duke dorëzuar me protokoll formatin përkatës të monitorimit. Dy specialistët (sipas zonave të ndara) marrin formatet dhe hedhin të dhënat e tyre në situacionin paraprak me shërbimin e kryer dhe të pakryer. Përgjegjësi i sektorit së bashku me specialistin e sektorit, nën varësi të Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të Shërbimeve të Infrastrukturës, koordinojnë sistemin e menaxhimit të mbetjeve që nga hartimi i preventivave për kontratat, evidentimin e gjendjes ekzsituese të infrastrukturës dhe hartimin e raporteve përfundimtare të gjendjes së shërbimit. Bashkia në landfillin e Bushatit ka një supërvizorin e saj, i cili bën raportime të rregullta javore/mujore në lidhje me ngarkesat e mbetjeve që vijnë në landfill nga e gjithë bashkia. Përgjegjësi i sektorit raporton tek Drejtori i Drejtorisë për situatën e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë, i cili më pas raporton në instancat vendim-marrëse të bashkisë (Kryetari/ja e Bashkisë).

Stafi i Bashkisë Shkodër është I trajnuar që të rishikojë PLMIMNU, monitorimin e planit matjen e indikatorëve të performancës etj.

Plani lokal I MIMNU do të kërkojë Miratimin e Këshillit Bashkiak, paraprakisht do ti nënshtrohet dëgjesave dhe konsultimit me publikun gjithashtu Legjislacioni e kërkon që të realizojë procedurat për pajisje me Vlerësimin Strategjik Mjedisor, nga instancat përkatëse.